

Rruga e Arbërit



www.rrugearberit.com

GAZETË E PAVARUR.

NR. 3-4 (166) / MARS - PRILL 2020.

ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË.

BUJQËSI

Pandemia Covid-19, Sfidat e fermerëve në bujqësi e blegtori

Nga **OSMAN XHILI**

— Faqe 5

JETË

Xhetan Prençi, burri shekullor i Muhurrit e i gjithë Dibrës

Nga **HALIL RAMA**

— Faqe 10

PROFIL

Jonuz Ndreu, aktivist i njohur i mërgatës politike shqiptare

Nga **BEQIR SINA**

— Faqe 26

HOMAZH

Hekuran Vladi-Lura, një profesionist me integritet

— Faqe 30

Ura e Vashës përfundoi, por Tuneli i Murrizit nuk do të mbarojë në afat

By pass-i panoramik, një zgjidhje që rruga të hapet në maj 2021

Nga **BUJAR KAROSHI**

“Ura e Vashës përfundoi, por Tuneli i Murrizit duket se nuk do të mbarojë në afat. Ndaj lind nevoja e ndërtimit të një by-passi, i cili nuk është parashikuar në kontratë, gjë e cila do të bëjë të mundur që rruga të hapet për trafikun në pranverën e vitit 2021”.

Në fund të prillit kryeministri Edi Rama dhe ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku, të shoqëruar nga presidenti i kompanisë “Gjoka Konstruksion”, Rrok Gjoka, dhe inxhinierë të autoritetit rrugor shqiptar, zhvilluan një vizitë në Klos, nga ku panë nga afër urën e re të Vashës të përfunduar. Në kronikën e transmetuar më 28 prill në faqen e Facebook-ut të kryeministrit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë tregohet ecuria e punimeve të deritanishme, por edhe problematikat e shfaqura, si rezultat edhe të pandemisë, por që nuk do ta rrezikojë hapjen e rrugës për lëvizjen e trafikut.

“Tashmë, nga 70 kilometra rrugë gjatësi që ka Rruga e Arbrit dhe nga 6 tunele janë përfunduar 5 nga këto tunele dhe më shumë se 54 kilometra tashmë janë të përfundueshme”, tha ministria Balluku.

(Vijon në faqen 3)

OPINION

Disa pikëpyetje pas vizitës së Kryeministrit te Ura e Vashës

Nga **BUJAR KAROSHI**

— Faqe 2

OPINION

Konspirancion dhe diversion ndaj rrugës së Dibrës

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

— Faqe 4

OPINION

Koronavirusi: ardhja dhe përhapja janë faje njerëzore

Nga **AHMET ÇAUSHI**

— Faqe 7



Ura e Vashës.
Foto: MIE

NË BRENDËSI: ■ Gripi i vitit 1957 dhe një refleksion për gripin e sotëm ■ Pesë anëtarë të familjes **Poliçi**, pesë intelektualë të përkushtuar ■ Eh ç’më kujtove teze Shahren, or mecl! ■ **Xhevat Dani** i Podgorcës së Dibrës ■ **Arjan Cara** i Bulqizës dhe Selanikut ■ **Kampioni** i sfidave të jetës... ■ **Epoka e Gjergj Kastriotit**, bazament i vetëdijes kombëtare shqiptare ■ **Velo Cfarku**, kryeredaktori më jetëgjatë që i dha jetë “Ushtimës së maleve” ■ **Molla Vebi Ferati**, enciklopedist i rrallë, figurë popullore ■ **Sheh Sula i Zërqanit**, kleriku patriot, pjesëmarrës në të gjitha lëvizjet kombëtare të kohës ■ **Artan Gj. Hasani**: Kënga e mjekut ■ **Agron Tufa**: Poezi ■ **Ramiz Gjini**: Rrëfimi i bariut ■ **Hazis Ndreu**, mjeshtri i alegorisë ■ Drini i Zi ■ Për misionin e **Enver Kaloshit**, arketipin Llan Kaloshi dhe Irfanin - një Kalosh ■ **Hekuran Vladi-Lura**: A janë të pastra paratë e shqiptarëve?! ■ Mall dhe krenari për mësuesin tim **Xhelal Meta** ■ **Lulzim Methasani**, një ikje e pamerituar



Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.



Gazetë e pavarur.
Nr. 3-4 (166), Mars-Prill 2020
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit Maj 2020.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtorët e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se mermi përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.
Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më datë 20 të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.
Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.
GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.
JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.
Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:

Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Abdurahim ASHIKU
Artan Gj. HASANI
Agro TUFA
Ramiz GJINI
Ahmet ÇAUSHI
Xhafer MARTINI
Defrim METHASANI
Bajram XHAFA
Selman MEZIU
Enver HALILI
Halil RAMA
Beqir SINA

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email në adresën <rrugaearberit@gmail.com> ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit www.rrugaearberit.com.
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohej riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Disa pikëpyetje pas vizitës së Kryeministrit te Ura e Vashës

Nga **BUJAR KAROSHI**

Me shumë vëmendje dhe interes ndoqa disa herë kronikën e vizitës së kryeministrit dhe ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë te Ura e re e Vashës, me dëshirën e mirë për të mësuar ndonjë të re për ecurinë e punimeve në Rrugën e Arbrit. Dhe në këtë kronikë ka shumë të reja. Nuk dua t’i përmend të gjitha, por do të mjaftohem me disa çështje, për të cilat mendoj se duhet më shumë informacion.

Sipas meje, të rejat e kronikës janë:

1. Rruga do të ketë një by-pass panoramik. Kjo do ta zgjasë rrugën 5 km.
2. Ura e Vashës është sot ura më e lartë në Ballkan, 152 metra. Kur të mbarojë ura e fshatit Fshat, do të jetë ajo më e larta në Ballkan, me 157 metra, 5 metra më shumë. Pra, Rruga e Arbërit do të ketë dy urat më të larta në Ballkan!
3. Janë hapur deri më tani 5 nga 6 tunelet e rrugës. Por problemet kanë dalë te tuneli i 6-shtë, që për koencidencë është edhe kryesori. Problemet kanë të bëjnë me formacionet gjeologjike.

Tri të rejat e kronikës, në fakt, nuk janë të reja. Janë tre shqetësime të cilat i kanë ngritur me kohë ata që janë marrë me propogandimin e kësaj rruge që prej 25 vitesh, por së paku nga viti 2008 kur nisën punimet në Fushë-Bulqizë. Dhe shqetësimet janë ngritur për t’u paraprirë problematikave gjatë punimeve.

Së pari, problematikat kanë të bëjnë me tunelin e Murrizit, të cilat kanë shumë hije dyshimi pas. Ju kujtohet ajo koha që thuhej se “nuk bëhet tuneli se ka ujë?” Pastaj u tha që nuk ka problem gjeologjike, as hidrogjeologjike, por është thjesht çështje dëshire. Filluan punimet në tunel dhe, ndërsa propogandohej se gjithçka shkon mirë, tuneli u shemb. Nuk u fol për arsyet e shembjes, por dolën në pah problematikat e vështirësive të paparashikuara, projektme të reja, ristudime, rinisje punimesh etj., ku shtesa e fondeve për këtë edhe sot e kësaj dite nuk janë bërë publike. Kjo mungesë transparencë të bën të besosh se shembja nuk ndodhi për asnjë lloj problematike gjeologjike, por për faktin e mungesës së specialistëve që drejtojnë punimet. Pse jo, edhe për teori konspirative për ca shtesa fondesh gjatë rrugës.

Së dyti, propozimi për një by-pass është një propozim i vjetër i ing. Faruk Kabës. Arsyet që ai e propozoi, duke qenë edhe partizan i ndërtimit fillimisht të by-pass-it, lidheshin me argumentin e kursimit të fondeve. Meqë tuneli i Murrizit merr një përqindje të madhe nga fondet e rrugës, propozimi i tij ishte që të kalohej rruga me by-pass dhe në një moment tjetër, kur qeveria të kishte fonde të mjaftueshme, të investonte në ndërtimin e tunelit. Kjo rrugë, sipas tij, përfundonte për



Kryeministri Edi Rama dhe Rrok Gjoka, presidenti i Kompanisë “Gjoka Konstruksion”, gjatë inspektimit të ura e re e Vashës. Prill, 2010. Foto: MIE

- **Një rrugë me by-pass për Dibër nuk ka për të qenë Rruga e Arbrit.**
- **Qeveria dhe kompania duhet periodikisht të bëjnë publike ecurinë e punimeve. Sepse deri më sot të gjitha lajmet për devijime, vonesa, shembje, problematika e gjithçka tjetër i kemi marrë vesh në fillim si thashetheme dhe pastaj kanë dalë të vërteta.**

18 muaj. Ky propozim është kundërshtuar nga shoqëria civile që e ka propaganduar këtë rrugë prej 25 vitesh. Duke parë mungesën e dëshirës së qeveritarëve për të çuar përpara procesin e ndërtimit të rrugës, kemi qenë të bindur dhe vazhdojmë të jemi se një rrugë me by-pass është e mirë vetëm për dibranët. Tuneli nuk do të ndërtohej më, së paku edhe në 50 vitet e ardhshme. Ndaj e kemi kundërshtuar fort dhe mes kundërshtarëve kam qenë edhe unë. Dhe jam edhe sot kundër. By-passi mund të zbukurohet me lloj-lloj fjalësh, si “panoramike”, “e bukur”, “turistike” etj., por në qoftë se ndërpritet puna në hapjen e tunelit të Murrizit, atëherë ai është vetëm një justifikim për të kaluar radhën.

Për ata që mendojnë se ne nuk e kemi pasur shqetësimin e gjetjes së fondeve, së bashku me një grup inxhinierësh nga shoqëria civile kemi pas propozuar një version tjetër për rrugën, i cili ka qenë ndërtimi i një ure shumë të vogël mbi Urën e vjetër të Vashës (madje aty ka qenë propozuar edhe një HEC, por kjo është temë tjetër) si dhe ndërtimin e



Hyrja e tunelit të Murrizit. Prill, 2020.

një tuneli tjetër poshtë fshatit Guri i Bardhë. Ky version do të kishte kosto më të ulët, por ndërtimi i dy urave mori përparësi, pasi ato do të ishin “më të lartat në Ballkan”. Sigurisht, kërkonin më shumë fonde, por kur vjen fjala për “mburje” fondet nuk janë problem.

Por, ja, që erdhi një kohë që, paraja qenka shumë e rëndësishme. Dy këstet e radhës nuk do t’i marrë këtë vit kompania që po ndërton rrugën. Kjo mund të sjellë vështirësi ose ngadalësim të punimeve në vazhdim.

Kështu, për t’i dalë përpara premtimit, po studiojmë pak by-pass-in. Ndoshta na nxjerr nga situata para zgjedhjeve të vitit të ardhshëm, por edhe ndoshta fitojmë kohë për tunelet. Nuk i mbarojmë pas 22 muajsh, por edhe po mbaroi, i vendosim direkt taksën. Sepse me by-pass-in zgjidhim edhe pakënaqësitë e atyre që nuk duan të paguajnë...

Në fund, mund të pyesë dikush: “Çfarë rëndësie ka, mjafton të hapet rruga që të shkojmë në katund, për të tjerat të bëhet ç’të bëhet.”

Pikërisht këtu e kam shqetësimin edhe unë: një rrugë me by-pass për Dibër nuk ka për të qenë Rruga e Arbrit, nuk ka për të qenë rruga që do të lidhë shqiptarët në rajon. Nuk ka për të qenë rruga që të do të lidhë Tiranën me Dibrën, Tetovën, Gostivarin, Shkupin e Sofjen. Por ka për të qenë një rrugë që do të na ndihmojë ne të shkojmë e vijmë më shpejt në katundet tona, por nuk ka për t’i dhënë frymëmarrjen e duhur ekonomisë dhe shoqërisë shqiptare. Dhe nuk do të jetë pastaj e largët dita kur emërtimin “Rruga e Arbërit” nuk do ta shpjegojmë si një rrugë që i binte dikur mepërmes Arbërisë, por një rrugë që e ka marrë emrin prej Arbërit, atij djalit që ka ngritur ato magazinat e grumbullimit të ndihmave te Ura e Brarit.

Në fund, do të doja që gjithçka që shkrova me lart ta kem gabim. Dhe që unë ta kem gabim, duhet që qeveria të dalë me një deklaratë zyrtare ku të ritheksojë se nuk ka asnjë tërheqje nga planet për ndërtimin e Rrugës së Arbrit me standarde europiane. Dhe kompania të dalë periodikisht, së paku një herë në tre muaj, dhe të bëjë publike ecurinë e punimeve. Sepse deri më sot të gjitha lajmet për devijime, vonesa, shembje, problematika e gjithçka tjetër i kemi marrë vesh në fillim si thashetheme dhe pastaj kanë dalë të vërteta.

Ura e Vashës përfundoi, por Tuneli i Murritzit nuk do të mbarojë në afat

(Vijon nga faqja 1)

“Jemi në fazën e hedhjes së asfaltit gjatë muajit maj për gjithë pjesën ku është shtruar traseja dhe janë mbyllur të gjitha detajet e trasesë. Punimet kanë ecur mirë, pavarësisht se ndodhemi në muajin e 22, fiks në mes të kontratës (kontrata parashikon 44 muaj punime), punimet kanë ecur dhe janë shumë të avancuara, edhe përtej grafikut të parashikuar që kemi pasur”.

Balluku i tha kryeministrit se Ura e Vashës, me gjatësi 316 metra dhe lartësi 152 metra ka përfunduar, ndërkohë që punëtorët janë duke mbyllur detajet e fundit. Ndërsa për urën tjetër, atë të fshatit Fshat, e cila është e gjatë 174 m, por 5 metra më e lartë, është akoma në ndërtim”.

Balluku theksoi se “megjithëse është bërë një punë shumë e mirë, me ritme të shpejta, kemi pasur pak vonesë në javët e marsit, për shkak të pandemisë së koronavirusit. Puna në kantier është ndërprerë disa ditë, por me pajisjen me maska, me syze dhe doreza puna ka nisur sërish.

Mbyllja e kufijve ka krijuar probleme me sjelljen e materialeve nga jashtë, konkretisht nga Turqia për profilet e urës së fshatit Fshat. Sipas presidentit të kompanisë, Rrok Gjoka, punimet e saj pritet të përfundojnë në gusht-shtator të këtij viti.

TUNELI I MURRIZIT 3.8 KM, SHTYHET AFATI I MBARIMIT

Një nga lajmet e mira për rrugën në perspektivën e saj është tuneli i Murritzit. Nga 3.2 km i parashikuar në fillim të punimeve, pas shembjes që ndodhi një vit më parë, ka ndryshuar projekti dhe tuneli do të jetë i gjatë 3.8 km, me dy tuba kalimi, njëri prej të cilëve do të përdoret në raste emergjente.

Rruga e Arbrit do të ketë në total 6 tunele, gjatësia e të cilave është rreth 10 km.

Pavarësisht nisjes së punimeve në kantierin e ri, puna nuk duket se po ecën me ritmet e duhura. Një punëtor i kompanisë, në kushtet e anonimatit, tha për gazetën “Rruga e Arbërit” se nga ana e Tiranës tuneli ka ecur 250 metra, ndërsa nga ana e Xibrit 800 metra”.

Me këto ritme tuneli i Murritzit, që është edhe vepra më e rëndësishme e Rrugës së Arbrit nuk mbaron dot në 22 muajt e ardhshëm të parashikuar në kontratë. Ndaj, del e nevojshme një zgjidhje tjetër.

“Kemi folur me ministren për një zgjidhje, e cila më kushton mua, por përfitojnë fshatrat që lidhin Xibrin me Bastarin, - tha Rrok Gjoka. Sipas tij, do të ndërtohet një by-pass 9 kilometra, i cili do të bëjë bashkimin nga njëra anë e tunelit në anën tjetër”.

“Në muajt në vazhdim do të bëjmë një vizitë në tunelin e Murritzit për të parë dhe kompleksitetin atje dhe për të parë dhe në terren zgjidhjen, pasi do kërkojë një lëvizje nga projekti. Është e pamundur të vazhdohet, pra, edhe koha po humbet dhe sigurisht edhe shpenzimet janë të larta, kështu që një zgjidhje të cilën ne po e shikojmë tani me ARSH, për sa i përket një by-pass-i, i cili jo vetëm bën lidhjen midis dy fshatrave, por na lehtëson edhe në vazhdimin e punimeve”, tha Balluku.

“Megjithatë, jemi në rrugë të mirë, jemi duke e përfunduar dhe padyshim kjo ka qenë

■ By pass-i panoramik, një zgjidhje që rruga të hapet në maj 2021

pjesa më komplekse e gjithë Rrugës së Arbrit, e cila ka ngushtuar kohën për të ecur përpara dhe ndoshta do marrë pak më shumë deri në fillim të dimrit mund të mbyllet”.

Një inxhinieri e Autoritetit Rrugor Shqiptar ishte më e qartë kur i tha kryeministrit se “kjo rrugë ndihmon zonën, por na jep dhe ne kohën që Rruga e Arbrit të përshkohet në kohë brenda kontratës në gjithë gjatësinë e saj”.

Ndërsa një inxhinier tjetër, të cilit Balluku iu drejtua me emrin Ergys, duke iu referuar problematikave të hasura gjatë punës në tunelin e Murritzit tha se “në variantin me by-pass kemi dhënë zgjidhjen më të mirë të mundshme ekonomike, bazuar mbi zgjidhjen nga ana gjeologjike, duke iu atashuar edhe Institutit të Gjeologjisë dhe oponencës teknike që mori projekti”.

Kryeministri Edi Rama, pasi u informua mbi punimet në by-pass, pyeti se ndërkohë punimet në tunel do të vazhdojnë, apo jo? Dhe përgjigja e presidentit të kompanisë ishte se punimet në tunel do të vazhdojnë ndërkohë. “Ajo e zgjat 5 kilometra rrugën në total. Rruga është shumë e nevojshme, është turistike, lidh edhe 2-3 fshatra, por ajo nuk është e papërshtatshme në dimër”.

Rruga panoramike do të jetë e gjatë 9 km dhe do t’i shërbeje turizmit në këtë zonë. Nga një vizitë në terren, banorët e Murritzit thanë se ishin shumë të kënaqur. Rruga, e cila do të kalojë përmes fshatit të tyre, do t’i japë shumë perspektivë zhvillimi zonës.

Një burim pranë kompanisë tha për gazetën se “pritet që kur kufijtë të hapen, për vazhdimin e punimeve në tunel do të vijë një kompani nga Turqia, së bashku me punonjësit e saj”.

Por ky lajm nuk mund të konfirmohet. Disa përpjekje për të kontaktuar kompaninë për më shumë informacion, duke u bazuar edhe të disa kërkesa të lexuesve, nuk morën përgjigje.

FINANCIMI: VITI 2020, 1 MILIARDË LEKË MË PAK PËR RRUGËN E ARBIT

Kuvendi i Shqipërisë, në ndryshimet që i bëri Buxhetit të Shtetit për vitin 2020 gjatë një seance të jashtëzakonshme në mes të prillit, vendosi që të heqë nga financimi një shumë



Pamje nga punimet në urën e fshatit Fshat

Një nga lajmet e mira për rrugën në perspektivën e saj është tuneli i Murritzit. Nga 3.2 km i parashikuar në fillim të punimeve, pas shembjes që ndodhi një vit më parë, ka ndryshuar projekti dhe tuneli do të jetë i gjatë 3.8 km, me dy tuba kalimi, njëri prej të cilëve do të përdoret në raste emergjente.



Pamje nga Tuneli i Murritzit, nga ana e Tiranës. Foto B.Karoshi / 1 maj 2020

prej 1 miliardë lekësh të llogaritura si këste të radhës gjatë këtij viti për Rrugën e Arbrit.

Në dhjetor të vitit të kaluar, revista “Monitor” raportoi se qeveria shqiptare “ka rritur financimin e rrugës me 45%, duke e çuar koston totale të ndërtimit të saj në 58 miliardë lekë (460 milionë euro), nga 40 miliardë lekë (33,6 miliardë vlera e kontratës plus 6.5 miliardë lekë TVSH) të parashikuara në kontratën ligjore”.

Për shkak të kostove të rritura, opozita kishte kërkuar në fillim të periudhës së pandemisë ndërprerjen e financimeve për Rrugën e Arbrit.

Më 25 prill, në një status në Facebook, zv. kryeministri Erion Braçe theksoi se nuk do të ketë ndërprerje të punimeve. Gjithashtu, ai thekson se rruga do të kushtojë 33.6 miliardë lekë, aq sa ishte parashikuar në kontratën fillestare.

Grupi i Lobimit nga shoqëria civile, që po ndjek hap pas hapi punimet në Rrugën e Arbrit që në mars 2013 doli me një deklaratë ku theksohej se “ne jemi të shqetësuar se kjo krizë mund të sjellë pasojë për rrugën, ndaj ju bëjmë thirrje aktorëve vendimmarrës që këtë çështje ta trajtojnë me seriozitet dhe përgjegjshmëri. Covid-19 solli menjëherë një realitet ekonomik të ri në vend dhe ky realitet do të ishte më pozitiv në qoftë se Rruga e Arbrit do të ishte ndërtuar me kohë. Nevoja për komunikimin e tregjeve të brendshme në mënyrë të shpejtë dhe me më pak kosto, e bën Rrugën e Arbrit një arterie që duhet të përfundojë sa më parë”.

* * *

Punimet në Rrugën e Arbrit nisën në pranverën e vitit 2018. Pavarësisht afatit prej 44 muajsh që parashikon kontrata, premtimet e presidentit të kompanisë në hapjen e punimeve në Klos më 17 qershor 2018, ishte se rruga do të mbaronte brenda 2 vitesh. Ndërkohë, edhe kryeministri Edi Rama gjatë zgjedhjeve lokale në qershor 2019 deklaroi në Peshkopi se në pranverë të vitit 2021 Rruga e Arbërit do të jetë e kalueshme.

Në këtë situatë të vështirë ekonomike që po kalon vendi këtë vit, për shkak të pandemisë Covid-19, duket se ndërtimi i by-passit panoramik në Qafë Murrizë, do ta ndihmojë kryeministrin dhe presidentin e kompanisë “Gjoka Konstruktion” të mbajnë premtimin.

DEKLARATË GRUPI I LOBIMIT PËR RRUGËN E ARBIT

“Asgjë, as Covid-19, nuk duhet të cënojë investimet për Rrugën e Arbrit”

17 Prill 2020- Në kohën kur vendi po kalon një situatë krize ekonomike dhe sociale si pasojë e pandemisë Covid-19, ne kemi marrë mesazhe dhe pyetje në lidhje me ecurinë e punimeve në Rrugën e Arbërit dhe nëse kemi informacione se çdo të ndodhë më tej.

Nga informatat tona në terren dhe kontaktet me “Gjoka Konstruktion” kemi mësuar se, edhe në këtë situatë, puna po vazhdon. Kjo na gëzon por shpresojmë se kjo po bëhet pa kompromentuar shëndetin e atyre që po punojnë në këtë situatë jo normale.

Ndërkohë Grupi i Lobimit po ndjek me shqetësim disa zëra mediatikë e politikë të cilët theksojnë se, për përballimin e situatës së shkakuar nga pandemia, duhen ndërprerë kontratat koncensionare, përfshirë edhe ato për Rrugën e Arbërit.

Ne jemi të shqetësuar se kjo krizë mund të sjellë pasojë për rrugën, ndaj ju bëjmë thirrje aktorëve vendimmarrës që këtë çështje ta trajtojnë me seriozitet dhe përgjegjshmëri.

Covid-19 solli menjëherë një realitet ekonomik të ri në vend dhe ky realitet do të ishte më pozitiv në qoftë se Rruga e Arbërit do të ishte ndërtuar me kohë.

Nevoja për komunikimin e tregjeve të brendshme në mënyrë të shpejtë dhe me më pak kosto, e bën Rrugën e Arbërit një arterie që duhet të përfundojë sa më parë.

Ndaj i ftojmë partitë politike, qeverinë dhe organizatat që kur të gjykojnë për vazhdimin e financimit të rrugëve, të marrin parasysh përfitimet që do të sjell kjo vepër e rëndësishme në një situatë të ngjashme në vitet e ardhshme.

Shtimi i ndjeshëm nënshkrimeve të peticionit të hapur 7 vite më parë, tregon se sa jetike është kjo rrugë jo vetëm për Dibrën e copëtuar dhe të lënë në harresë në të dyja anët e kufirit që nga 1913-ta, por edhe për Tiranën me 1 milionë banorë dhe pjesën tjetër të vendit.

Peticioni, që deri tani ka mbi 20,000 nënshkrime, nga cilat rreth 18,000 online dhe më shumë se 2,000 në formularë, mund të nënshkruhet këtu: <https://bit.ly/2RBZzha>

* Njoftim për mediat në 7 vjetorin e peticionit

Rizgjim pas pesë vjetësh...

Konspiracion dhe diversion ndaj rrugës së Dibrës

Nga: ABDURAHIM ASHIKU

RRUGA E ARBËRIT- rruga që duhej ndërtuar e para në Shqipëri...

E ndërtonte valuta e madhe e kromit, rrjedha çurg e djersës dhe të gjakut të minatorëve heroikë të kromit të Bulqizës, Batrës së Martaneshit, Tërnovës...

Nuk u ndërtua...

Konspiracioni dhe diversioni ndaj saj e kanë mbajtur dhe e mbajnë Dibrën në skaj të vëmendjes historike të shtetit shqiptar...

Tash, në kohë ngujimi nga pandemia botërore KOV-19, në skenë kanë dalë përsëri llapaqenet, politike e mediatike të cilët kërkojnë që RRUGA E ARBËRIT të harrohet, ti ndalin fondet e të ndërpriten punimet, të dhunohet...

Dhe kur ndodh kjo?

Kur janë lidhur të dy brigjet e Matit dhe “Ura e Vashës”, e historisë dhe legjendës është gati të përcjellë në të dy krahët mauna kromi e udhëtarë...

Kur janë çarë malet dhe tunelet aq të përfolur po marrin formë përfundimtare...

Kur dibranët jenë më pranë të të vërtetës që mund të nisen nga Tirana në mëngjes herët, të bëjnë llixha në Peshkopi dhe të kthehen për të filluar punën...

E dua edhe unë kënaqësinë të udhëtoj asaj ëndrrë të madhe...

* * *

Tirana, kryeqytet i Shqipërisë degëzohet gjeografikisht në katër drejtime e udhëton në katër rrugë historike, lëvizjesh e dyndjesh nga Lindja e Perëndimi: Rruga e Durrësit, Rruga e Kavajës, Rruga e Elbasanit dhe Rruga e Dibrës. Tre të parat lidhen me rrugë automobilistike e hekurudhore, rrugë që zgjerohen e shkurtohen, rrugë që kanë qenë dhe janë në vëmendje ndër shekuj.

Tre të parat lidhen me autostrada katërkalimshe, dy që shkojnë e dy që vijnë...

E vetmja rrugë që fillon në qendër të Tiranës dhe mbaron në periferinë e vjetër të saj, është Rruga e Dibrës.

E vetmja rrugë që “lëviz në këmbë” tash e tërë jetën e saj mijëra vjeçare është Rruga e Dibrës, historikisht RRUGA E ARBËRIT.

Dibranëve në këtë shekull Pavarësi u është dashur të udhëtojnë drejt Tiranës e Durrësit “tre ditë në këmbë” me ndalesa karvanësh në hane emri i të cilëve ende lakohet e tregohet me gisht, (ndonjëri edhe i restauruar dhe mbrojtur si pasuri kombëtare), Hanit i Nuzit në Dovolan, Hani i Duriçit në Bulqizë, Hani i Klos-Katundit në Mat, Hani i Kurtiqit, Hani i Zall Dajtit...

Dibranëve u është dashur të udhëtojnë “mbi katër rrota të lëvizshme” rrugë pa rrugë.

Nga Dibra në drejtim të Tiranës nëpërmjet Strugës, Elbasanit...

Nga Peshkopia nëpërmjet Gollobordës në drejtim të Elbasanit...

Nga Peshkopia nëpërmjet Bulqizës e Shëngjergjit në drejtim të Tiranës...

Nga Peshkopia nëpërmjet Burrelit e Qafë Shtamës në drejtim të Krujës...

Nga Peshkopia nëpërmjet Rrëshenit e Rubikut në drejtim të Tiranës...

Nga Peshkopia nëpërmjet Burrelit, Ulzës në drejtim të Milotit...

Nga Peshkopia nëpërmjet Muhurrit, Qafë Murrës, Lisit të Matit në drejtim të Tiranës...

Nga Peshkopia, në rrugë verore nëpërmjet Çidhnës, Lurës, Kurbneshit në drejtim të Tiranës...

Nga Peshkopia në drejtim të Kukësit nëpërmjet “Rrugës së Rinisë”, rrugë e hapur me punë vullnetare në vitin 1946...

Nga Peshkopia nëpërmjet Kalasë së Dodës, në Kukës e prej andej nëpërmjet “Rrugës së Kombit” në drejtim të Tiranës...

Nuk ka banorë të Shqipërisë që t’i ketë rënë kaq gjatë e kaq dhimshëm rrugëve për të shkuar në kryeqytetin e vendit, në Tiranë...

Zbulimi i minierës së kromit në Bulqizë nga



Punimet e rrugës së Arbrit në Qafën e Tujanit. Foto: B.Karoshi, 2013

pushtuesit italianë shtroi rrugën e kalldrëmtë nëpërmjet Qafës së Buallit, Klosit, Rrëshenit... në drejtim të Durrësit.

Hapja e minierës së Kromit të Bulqizës (me emrin “Fitore” e më vonë “Todo Manço” në shkurt të vitit 1948, nxjerrja atë vit për herë të parë në shërbim të ekonomisë shqiptare e 10.432 tonëve krom, sasi e cila në vitin 1954 do të shkonte në 100.321 tonë për tu dyfishuar në vitin 1960 në 219.956 tonë..., zbulimet e tjera të masiveve krom mbajtëse në hapësirën e Batrës, Krastës, Theknës, Tërnovës, Selishtës, Cërrujës etj. e çuan në një milionë tonë nxjerrjen e mineralit të kromit e natyrshëm shtruan nevojën e asfaltimit të rrugës nga Bulqiza në drejtim të Laçit...

Shtrimi u bë i ngushtë, aq i ngushtë sa kamionët me rimorkio ishin të detyruar të përjetonin “ndërrimin e trenave”.

Kishte kaluar afro një çerek shekulli nga “asfaltimi i rrugëve të kromit” kur për herë të parë në vitin 1972 u akorduan fondet dhe nisi zgjerimi dy kalimësh i rrugës nga Bulqiza në Peshkopi dhe asfaltimi i saj.

Do të zgjerohej (aq sa është sot në segmentin e Rrugës së Arbërit nga Bulqiza në Peladhi) në atë gjatësi deri kur armiku më i egër i Dibrës dhe i dibranëve Mehmet Shehu (i njohur për masakrën e Fushë-Çidhnës dhe të tjera) do t’i thoshte me egërsi “Ndal” asfaltimit dhe zgjerimit të rrugës nga Bulqiza në Peshkopi.

Nga Peladhia në Peshkopi rruga mbeti njëkalimshe me stacione ndërrimi si në linjat hekurudhore...

Nisi hapja e dy traverbankëve të Klosit në drejtim të nivelit të pestë të minierës së kromit

të Bulqizës, u ndërtua një kompleks i madh për pasurimin e kromit, mori formë traseja e hekurudhës Klos-Milot, u shtruan një pjesë e shinave...

Dibra, me një pasuri të jashtëzakonshme, me vend të tretë në botë për nxjerrjen e mineralit të kromit dhe të parë për frymë të popullsisë, mbeti vendi më i largët në Shqipëri...

Në vitin 1995, në kohë të reja, një grup modest dibranësh që e donin Dibrën në Shqipëri, Dibrën në Evropë (midis tyre edhe unë) ngritën zërin dhe kërkuar publikisht, në radio (Hysen Uka) dhe në shtypin e shkruar (unë e të tjerë) çarjen e maleve dhe lidhjen e Dibrës në rrugën e saj natyrale, rrugën e lashtë sa jeta e saj, Rrugën e Arbërit.

Një zë nga larg, zë i intelektualit dibran Gëzim Alpion i mblodhi dibranët në një listë të gjatë, listën më të gjatë që është nënshkruar masivisht ndonjëherë, Peticionin për Hapjen e Rrugës së Arbërit.

U shkrua një libër me argumentime shkencore historike për Rrugën e Arbërit dhe rrugët historike të Dibrës nga historiani dhe arkeologu Iliaz Kaca...

U shkrua një libër për gjeologjinë në Rrugën e Arbërit nga prof. dr. i shkencave gjeologjike Bashkim Lleshi...

U organizua Kuvendi Tekniko-Shkencor Rruga e Arbërit me punime dinjitoze të intelektualëve nga Dibra, Mati, Dibra e Madhe, Gostivari, Tetova etj.

Dibra u zgjua si asnjëherë tjetër...

Dibra firmosi si asnjëherë në kërkesat e saj legjitime...

Dibra, për herë të parë në historinë e vet,

e theu kufirin shqiptaro-shqiptar.

Me Dibrën u bashkuan personalitete nga të katër anët e botës...

Njëzet vjet u zhurmua kërkesa për hapjen e Rrugës së Arbërit...

Në vitin 2005, në kohë gënjeshtresh të njohura elektorale një kryeministër në ikje “përuroi” me hedhje lopatash me zhavorr “fillimin e punimeve” për hapjen e Rrugës së Arbërit...

Dhjetë vjet që atëherë u fol (dhe u bë ndonjë segment mbi trasenë e vjetër) për Rrugën e Arbërit në muaj fushatash për zgjedhjet vendore e kuvendare.

Konspiracioni për Rrugën e Arbërit, fshehtësia zyrtare shtetërore është e mbyllur në “kasafortën” e heshtjes.

Diversioni ndaj Rrugës së Arbërit njohu një kulm të ri të enjten e 16 prillit, në debatin e çuditshëm kuvendar për miratimin e koncesionit ndaj një firme të madhe kineze e cila ka marrë përsipër hapjen e tuneleve dhe lidhjen e segmenteve të “përfunduara” për ti dhënë formë Rrugës së Arbërit.

U mbrojt hapja e rrugës, ashtu si edhe u sulmua. Të dy krahëve nuk luajtën nga “istikami” i kundërshtimeve partiake.

Askush nuk foli për cilësinë e saj, për gjerësinë e saj. U quajt “Rruga e Dytë e Kombit” por në zbatimin praktik mbeti një rrugë “Gjysmë e Kombit”, një rrugë një kalimshe në një kohë që të gjitha rrugët e ndërtuara nga Veriu në Jug të vendit janë rrugë dy kalimesh, autostrada me ndarje korsishë.

Askush nuk u ndal të flasë për cilësinë e pjesëve “të mbaruara” të Rrugës së Arbërit, pjesë që në një gjatësi të madhe janë asfaltuar mbi rrugën e vjetër që lidh Bulqizën me Peshkopinë.

Askush nuk foli për “segmentin ende të pa projektuar” për trasenë dhe fillimin e punimeve mbi të.

Rruga e Arbërit është një rrugë që do të lidhë jo vetëm Dibrën brenda kufirit shqiptaro-shqiptar por edhe Dibrën e Madhe, Gostivarin, Tetovën, Shkupin, Sofjen për të shkuar deri në Varna, do të lidhë Detin Adriatik me Detin e Zi.

Si rrugë që i bie Gadishullit Ballkanik mes përmes ajo do të kërkojë që rrugët në vijim dhe veçanërisht rruga që lidh Dibrën e Madhe me Gostivarin, duhet të hapet, zgjerohet e asfaltohet në cilësinë e rrugëve ballkanike.

Përvoja e ndërtimit të Rrugës së Kombit ku Shqipëria e ndërtoi kurse Kosova e vonoi pjesën e vet do të duhej të ishte diskutuar para-prakisht me palën maqedonase. Në Kuvend nuk u tha asnjë fjalë për këtë.

Rruga e Arbërit, me vendimin e Kuvendit më 16 prill hyri në muhabetin popullor dhe në median elektronike dhe atë të shkruar ligjërisht.

Konspiracioni dhe diversioni ndaj Rrugës së Arbërit druaj se do të njohë kulme të reja.

Rruga e Arbërit duhet ndërtuar si Rruga e Dytë e Kombit, me të njëjtat projekte dhe përmasa.

Mos e leni atë në mëshirën e njerëzve që e shohin atë si “Lopë” për të mjelë qumësht në kusitë e korrupsionit të njohur për ndërtimin e rrugëve...

RRUGA E ARBËRIT- rruga që duhej ndërtuar e para në Shqipëri...

E ndërtonte valuta e madhe e kromit, rrjedha çurg e djersës dhe e gjakut të minatorëve heroikë të kromit të Bulqizës, Batrës së Martaneshit, Tërnovës...

Nuk u ndërtua...

Konspiracioni dhe diversioni ndaj saj e kanë mbajtur dhe e mbajnë Dibrën në skaj të vëmendjes historike të shtetit shqiptar...

Si dibran, si gazetar, larg informacionit të gjallë, jam pesimist për të ardhmen e mbarë të Rrugës Historike dhe Ekonomike të Arbërit, për ndërtimin e saj me të gjithë parametrat bashkëkohorë...

Athinë, 20 prill 2015



Ura e re e Vashës e sapo përfunduar, prill 2020. Foto: MIE

Sfidat e fermerëve në bujqësi e blegtori

Nga OSMAN XHILI

Në qoftë se me 1 prill dikush në mëngjes do të thoshte se “po bie borë”, të gjithë do të besonin për një gënjeshtër. Por këtë vit kjo thënie ishte krejtësisht e vërtetë. Bora u shfaq në Dibër e qartë, e pastër, me një trashësi mbi 30 centimetra. Njerëzit në këto ditë të izolimit, kryesisht fëmijët, vrapuan në oborre për t’iu gëzuar bardhësisë. Luajtën me topa bora, bënë burra, i stolisën ata me komça, me këpucë, me kapele, shalle e lloje të tjera zbukurimesh. Megjithëse e ftohtë, bora e 1 prillit e ngrohu atmosferën në këto ditë të pazakontëkarantine që ka mbërthyer vendin.

Ndërsa fëmijët janë më të kënaqurit, një pjesë e fermerëve në Dibër janë të shqetësuar. Përvoja gjatë dy viteve të kaluara, ku gjatë prillit pati borë dhe ngrica dhe që dëmtoi shumë prodhimet në vend, rikthen frikën e dëmtimit të frutikulturës dhe prodhimeve bujqësore.

Qatip Doda, përgjegjës i këshillimit për qarkun e Dibrës, në lidhje me këtë problem thotë se “nga biseda me disa specialistë të këshillimit e fermerë potencialë, rezulton se dëmet mund të jenë minimale”.

“Në zonat e ulta të luginës së Drinit ka pasur disa varitete më të hershme të dardhës e të qershisë, që mund të kenë një përqindje të lehtë dëmi, - thotë ai për gazetën “Rruga e Arbërit”. Këtyre mund tu bashkohen dhe disa lloje kumbullash, që dëborë i gjeti me petale të hapura. Për mollat nuk ka pasur asnjë lloj rreziku, pasi ato duan, të paktën dhe një dhjetë ditë për të filluar lulëzimin. Për arrat, as që bëhet fjalë për ndonjë lloj dëmtimi, pasi janë akoma më të vona”, thotë Doda.

Në kopështin tim nektarina kishte çelur prej ditësh, një kumbull, po ashtu kishte hapur petalet e bardha. Dy rrënjët e kivit kishin disa gjethe të djegura dhe lulet e tulipanëve ishin fundosur nën dëborë.

Vetëm pak vite më parë ra njëborë me datë 15 prill. Atëherë qershitë ishin gati në formimin e kokrrave dhe pati një rënie prodhimi prej gati 20 përqind. Po tu referohemi dhe pak situatave kritike, patjetër që na kujtohen ngricat e 21 dhe 22 prillit, të cilat e çuan prodhimin e frutave në më pak se 50 përqind. Të shpresojmëse nukdo të ketë ndonjë rrezik tjetër për pemtarinë e për fermerët tanë, që po i bëjnë shërbimet e stinës në një situatë shumë kritike dhe për vetë shëndetin e tyre.

Gjatë bisedave me fermerë dhe specialistë të frutikulturës e bujqësisë në Dibër, situatën mund ta përshkruajmë si neutrale: mes shpresës dhe pesimizmit. Shumica e fermerëve i kanë kryer punët më të shumta nëfrutikulturë. Janë kryerplehërimet, krasitjet dhe spërkatjet dimërore. Vendimi i qeverisëshqiptare për të lënë hapur farmacitë bujqësore gjatë ditëve të karantinës, ka qenë njëdihmesë e madhe në furnizimin me farëra, fidane, pesticide dhe inpute të tjera. Po



Në kushtet kur Europa ka mbyllur kufinjtë, për shkak të pandemisë, është vënë në dukje jo vetëm për fermerët, por edhe për institucionet vendore dhe qendrore që kanë në fokus bujqësinë, se sa e rëndësishme është bujqësia, me të gjitha anekset e saj. Megjithëse është shumë vonë, është kuptuar se sa e nevojshme është investimi i fuqishëm në këtë sektor. Në qoftë se gjatë tridhjetë viteve të demokracisë investimet në bujqësi e frutikulturë do të kishin qenë të vazhdueshme e me një program të detajuar që fillon nga prodhimi, grumbullimi e futja në treg, sot do të ishim shumë më komodë në furnizimin me produkte bujqësore e blektorale. E shkuara nuk kthehet më, por le të shërbejë kjo situatë për të nxjerrë mësimet e duhura. Le të punojmë, planifikojmë, investojmë e ti menaxhojmë më mirë në të ardhmen punët e këtij sektori.

kështu, baxhot kanë punuar pothuaj normalisht.

Sakip Ngota, pronar i fabrikës së qumështit në hyrje të fshatit të Melanit, ka grumbulluar çdo ditë qumështin e bagëtive nga fermerët. Ka vijuar dhe shitjen e djathit e nënprodukteve të tij, në Peshkopi, Tiranëapo destinacione të tjera.

Veip Salkurti, pronari i “Koop. Frutit Dibër”, vazhdon shpërndarjen e produkteve të fabrikës së tij. Ai ka gjendje akoma rreth njëqind mijë litra lëng molle dhe po kaq sasi uthulle. Krahës shërbimeve që po bën në pentoren e tij prej dhjetë hektarësh, përgatitet për të filluar sezonin e ri të përpunimit të frutave në fabrikë.

Shërbimet sapo kanë filluar dhe në grurë, ku një pjesë fermerësh kanë hedhur dorën e parë të nitratit. Pas kësaj

lagështire të bollshme, që u krijua, janë të gjitha mundësitë për ti përfunduar këto shërbime në grurë dhe për ti hedhur sytë nga kultura e misrit.

Megjithëse bora e rënë ka shkaktuar pak dëmeve, ajo ka sjellë edhe dy gjëra të tjera pozitive: së pari, sasia e lagështirës në këtë kohë, është një garanci për plotësimin e nevojave të bujqësisë me ujë, aq shumë të nevojshëm. Së dyti, bora dhe ulja e temperaturave frenojnë me një javë, apo dhjetë ditë, lulëzimin dhe çeljen e pemëve.

Në kushtet kur Europa ka mbyllur kufinjtë, për shkak të pandemisë, është vënë në dukje jo vetëm për fermerët, por edhe për institucionet vendore dhe qendrore që kanë në fokus bujqësinë, se sa e rëndësishme është bujqësia, me të gjitha anekset e saj. Megjithëse është shumë vonë, është kuptuar se sa e nevojshme është investimi i fuqishëm në këtë sektor. Në qoftë se gjatëtridhjetë viteve të demokracisëinvestimet në bujqësi e frutikulturë do të kishin qenë të vazhdueshme e me një program të detajuar që fillon nga prodhimi, grumbullimi e futja në treg, sot do të ishim shumë më komodë në furnizimin me produkte bujqësore e blektorale. E shkuara nuk kthehet më, por le të shërbejë kjo situatë për të nxjerrë mësimet e duhura. Le të punojmë, planifikojmë, investojmë e ti menaxhojmë më mirë në të ardhmen punët e këtij sektori.

Karantina, si rezultat i virusit Covid-19, është prezente akoma dhe në një mënyrëapo në një tjetër, ajo ndikon negativisht në ritmet e punës dhe cilësinë e shërbimeve. Fermerët kërkojnë që të mos pengohen në kryerjen e shërbimeve të stinës dhe fasha orare e lëvizjes së tyre të mos jetë e kufizuar. Ndhimesat e tjera për ta, në këto ditë të vështirado të ishin një dhuratë e madhe.

I vetmi problem për momentin është për blegtorët. Ata përgjithësisht e kanë nën kontroll situatën, por shqetësimi i tyre mbeten tregjet për shitjen e kecape dhe qengjave, të cilët nuk funksionojnë si vitet e tjera. Rrjeti i restoranteve është i mbyllur krejtësisht dhe të vetmit që janë hapur janë dyqanet e mishit, të cilët me kapacitete jo të plota, nuk arrijnë ta mbulojnë tregun.

Megjithatë, fermerët besojnë se kur të dalim nga karantina, njerëzit do të jenë më të orientuar drejt prodhimeve bujqësore e blegtorale vendase, si një mundësi e mirë për një ushqim të shëndetshëm, por edhe për të ndihmuar njëri – tjetrin ekonomikisht, për ti dhënë më shumë kuptim jetës së bashku.



fejton



Eh ç'më kujtove teze Shahen, or mec!

Nga ABDURAHIM ASHIKU

E dhe këtu, njëmijë kilometra larg më erdhi një SMS. Jo në celularin me 9 numra pas 0030-s por në atë me 8 numra pas 355. E kisha lënë hapur dhe SMS-ja si të jetë koronavirus bëri dritë në ekranin e vogël...

E shtypa dhe në vend të germave një zë më buçiti në vesh... "Jam Edi. Lani duart me sapun..."

Nuk i ktheva përgjigje.

E ç't'i kthej kur atë thirrje e dëgjoj në të gjitha stacionet dhe në të gjitha gjuhët e botës?

Madje e kam në vesh që në fëmijëri kur prindërit nuk më ulnin në sofër pa larë duart me sapun e nuk më linin me dalë me luajt me shokët pa i larë ato pas buke.

Madje, madje... bile, bile... e kam jetuar jo "njëherë e një kohë" por nja katër a pesë dekada më parë në qytetin tim të vogël ku jetonte Teze Shahja...

Teze Shahja, atëherë një grua në të gjashtëdhjetat në moshë por në të tetëdhjetat në dukje tek hynte e dilte nga shtëpia në podrum në pallatin e parë trekatësh, të parin në qytet, kurriz thyer deri në kënd të drejtë, me netull në njëren dorë e me mashë në tjetrën.

Ishte pastërtore Shahja, pastërtore deri në dhimbje. Merakun e kishte tek dorezat e dyerve, dyshemeja, karriget, dollapët, ku prekte ora e shkelte këmba. Hyje e dilje nga shtëpia përdhese e Teze Shahes i ndjekur nga pas prej saj me netull e me leckë në dorë. I pastronte dorezat e dyerve sa dukesh se do ti hollonte deri në këputje. I fshinte gjurmët tuaja sa çimentoja ishte bërë kartë cigareje. E ku nuk e kishte syun e merakun Teze Shahja por atë, më të madhin e kishte me drutë e zjarrit.

I merrte me mashë, i pastronte dhe i stivonte si një murator vakti në depon e vogël...

I merrte e i fuste në sobë me mashë...

Dibranet mbahen si pastërtore të veçanta, sidomos ato të Fushës së Shehrit e të Topalltisë. Nuk rrinë pa e lyer shtëpinë dy herë në vit. Një herë në pranverë, "muaji i të rejave" siç quhej një herë e një kohë, dhe në tetor, pa emër të veçantë, sa vinte pranvera e fillonte dimri. Me gëlqere e lyenin, bardhë si bora. E merrnin në Selane, katund i përmendur për bardhësinë e gurit të djegur me dushk. Smolloviçi apo nga guroret e Grykës së Vogël djegur me dushkun e Sopotit e Zerqanit.

Po, por me Teze Shahen nuk mateshin as ato të Shehrit të Dibrës e as ato të Shehrit të Peshkopisë. Teze Shahja ishte embleme e pastërtisë deri në humor...

Këto mu kujtuan tek lexoj portalet e dëgjoj kronika koronavirusesh me zë bubullues të kryeministrit tim, e zë këshillues butë e butë mjekësh specialistë ku pas çdo këshille për refren kanë:

"Lani duart!"

Nuk e di por më ngjan se mesazhi i Teze Shahes duhet të ishte dëgjuar e lexuar me kohë...

Lani duart...

Lani dyshemenë...

Hiqni këpucët tek dera...

Fshini me leckë dorezat e dyerve...

Dhe jo thjesht për tu mbrojtur nga koronavirusi, por për higjienën dhe pastërtinë si mbrojtje kundër çdo sëmundje, si kulturë jetese...

Eh! Qofsh e xhenetit Teze Shahe!

Athinë, 17 mars 2020

Gripi i vitit 1957 dhe një refleksion për gripin e sotëm

Nga ABDURAHIM ASHIKU

7 epidemitë nga gripi që kanë vlarë masivisht botën njerëzore:

• **Gripi spanjoll H1N1 i vitit 1918, preku gjithë botën dhe mori nga 50 – 100 milionë jetë.**

• **Një version i të njëjtit virus i quajtur virusi i derit i vitit 2009 shkaktoi 575 400 vdekje.**

• **Gripi aziatik i vitit 1957 shkaktoi 2 milionë vdekje.**

• **Gripi i Hong Kongut ne vitin 1968 shkaktoi 1 milionë vdekje.**

• **Gripi i korona viruseve Sars i vitit 2002 infektoi 8.000 njerëz nga të cilët vdiqën 700.**

• **Gripi i korona virusit Mers i vitit 2012 infektoi 2.500 vetë, nga të cilët vdiqën 850 vetë.**

• **Gripi korona virusit COVID 19 deri me 14 mars ka infektuar më shumë se 145 000 njerëz, nga të cilët kane humbur jetën 5400 vetë.**

• **Vdekshmëria llogaritet sipas rastit nga 0.7 – 3.4%.**

Nga shtypi

Kujtime të një nxënësi nga gripi i prag pranverës 1957 shoqëruar me tre pyetje:

Si e përjetoi Shqipëria gripin e vitit 1957?

Sa vetë u prekën dhe cila ishte gjeografia e përhapjes së sëmundjes?

Sa vetë vdiqën si pasojë e atij gripi që në radhë është më vrastari pas atij të vitit 1918?

Dhe një thirrje SOT...

Informacioni, këshillat njëzet e katër orë në njëzet e katër orë, në shqip dhe në gjuhët e botës, masat shëndetësore, masat organizative qoftë edhe drastike, janë ilaçi më efikas kundër këtij virusi të panjohur, vdekjeprurës...

Koha tu qëndrojmë këshillave dhe masave parandaluese e mbrojtëse...

* * *

Shkollën e mesme e mbarova në Fier...

Udhëtimi nga Dibra ishte i gjatë, i lodhshëm...

Ndër të tjera më vjen e më ulet në kujtesë udhëtimi me tren dhe vrapi nga stacioni i trenit në agjencinë e udhëtimeve të Rrogzohinës...

I për gatitëhim atij vrapi me valixhe në duar e çanta mbi kurriz sapo treni dilte nga tuneli e ndalonte pesë minuta para stacionit për të mbushë kazanët me ujë prej nga, nën zjarrin e qymyrit, prodhohej avulli që vinte në lëvizje lokomotivën...

Me fat ishim kur kapnim biletën e bënim vend në të vetmin autobus që shkonte për Fier. Për autobusin e Vlorës nuk bëhej fjalë. Ishin edhe ata në të njëjtin hall si udhëtarët e Fierit.

Kur nuk arrinin të merrnin biletë na mbetej rruga, dora lart e "bagazh" i hedhur mbi ndonjë kamion me dyfishin e çmimit...

Ishin vite të vështirë...

Ende nuk ishte kapërcyer kriza e bukës, ende vazhdonte sistemi i triskëtimit të ushqimit dhe veshmbathjes në qytet dhe i reciprokut në fshat.

Shkolla e mesme bujqësore e Fierit, një ndërtesë kartoni ndërtuar nga Italia, ishte në dalje të qytetit, drejt Vlorës.

Konvikti, i pari, ishte i vendosur në një ndërtesë sekuestro e kohës disa dhjetëra metra larg shkollës, i dyti ndonjë kilometër larg, afër fushës së sportit.

Ushqimi niste me çaj me bukë misri e marmelatë molle në mëngjes, me supë apo fasule në drekë e çaj me bukë misri e marmelatë në darkë. Një ditë në mes javë kishim mish e një ditë, të dielat, ëmbëlsirë, kabuni...

Flinim në shtretër tip "marinar" druri, në dyshekë e jastëkë mbushur me kashtë nga lëmi i shkollës.

Myzeqeja asokohe ende ishte në "në kënetë" e malaria kishte zbehur pamjen dhe jetën e njerëzve.

Nuk do të më kursente as mua. Më kapi një ditë fillim tetori 1956. Qëndroja në diell, që megjithëse digjte, nuk ngrohesh. Dridhesh si dridhen degët e shelgut nga uji i lumit. Temperatura nuk më binte... Tek dyzetat qëndronte...

Më shtruan në spital...

Spitali ishte asokohe në qendër të Fierit, vendosur në një ndërtesë sekuestro siç thuhej e familjes feudale të Vriovëve. Më vonë u bë bibliotekë...

Ishte i vështirë shtrimi dhe qëndrimi në spital. Larg Dibrës, pa zë për familjen, në vetminë e një shtrati hekuri, një dyshek e sipër një velenxë pambuku...

Një shok shkollë, Semini më vjen në kujtesë mbiemri i tij, ndante me mua ato ushqime që i vinin nga familja e tij në Seman. Më vjen në kujtesë ashtu i zverdhur, i pa zhvilluar në trup, pamje tipike e të sëmurëve nga malaria.

E kalova, e mora veten dhe u përshtata me mjedisin e ri, krejt tjetër nga ai ku isha rritur...

Në shkurt të '57-s plasi gripi. Një grip shumë i rëndë.

U mbyll shkolla. Nxënësit e jashtëm u mbyllën në shtëpitë e tyre. Të tjerët, konviktorët nga fshatrat e Myzeqesë, shkuan pranë familjeve.

Mbetëm vetëm ne, konviktorët e largët, tre dibranë, një elbasanas, dy...

Na grumbulluan në një dhomë, majtas në katin përdhese të godinës. Një dhomë me pesë metër gjatësi e gjerësi, me katër krevate marinarë prej druri, me hapësirë sa në ije hynim e në ije dilnim.

Radio nuk kishte. As gazeta. Asnjë lajm nuk hynte e nuk bënte vend për të na qetësuar për sëmundjen e për të na dhënë kurajë. Na jepnin mëngjes, drekë e darkë disa hapa; ca të bardha, ca të verdha e ca kafe. Racioni i ushqimit ishte rritur por oreksi kishte zbritur.

Temperatura, kur ndonjëherë vinte e na e maste infermieri, askujt nuk i binte poshtë 39 gradë celsius.

Mua më shkoi dyzet pa dy vija. Kisha dhimbje të tmerrshme koke sa në jerm bërtisja sa lëkundej krevati e ushtima kalonte dhomën.

Njëherë kisha bërtitur aq fort, duke hequr e hedhur poshtë rrobat e sipërme të trupit sa fjalinë bërtitëse do të ma kujtonin me romuze duke qeshur shokët e dhomës: "Partizan, koka në Tiranë". Ndonjëri këtë do të ma kujtonte shumë vite më vonë. Isha (dhe jam) tifoz i "Partizanit" dhe në jermi me të ishin përzierë halucinacionet...

Nuk e di sa vazhdoj gripi i rëndë i asaj prag pranvere 1957...

Nuk e di sa shkruan gazetën e sa u fol në radio...

Nuk e di sa vetë mori...

Di që një nxënës nuk u kthye më në shkollë...

Një vit më vonë shkolla do të shkonte në NB "Çlirimi". Të tjera kushte fjetjeje e mësimi, ushqimi e dëfrimi. Ishte hequr sistemi i triskëtimit dhe ishin zgjeruar hapësirat e jetës...

Që prej asaj kohe gripin e kam kaluar në këmbë, me pak ethe e ndonjë plagë të vogël në buzë...

Flitet për një grip të rëndë në vitin 1918...

I vështirë do të ketë qenë...

Aso kohe kriza e bukës ka qenë më e rënda në historinë shqiptare të shekullit të njëzetë. Në Dibër, për ato vite ka një fjalë që flet më shumë se çdo kronikë e kohës. "Koha e nemces" quhet edhe sot e kësaj dite...

Sot, në një titull gazete, flitej për dymijë viktima të gripit të vitit 1967...

Sa do të jenë të prekurit dhe viktimat e gripit 2020, koronavirusit kinez?

Sado që të jenë ato nuk do ti kalojnë të prekurit dhe viktimat e dyndjeve të tjera gripale.

Informacioni, këshillat njëzet e katër orë në njëzet e katër orë, në shqip dhe në gjuhët e botës, masat shëndetësore, masat organizative qoftë edhe drastike, janë ilaçi më efikas kundër këtij virusi të panjohur, vdekjeprurës...

Koha tu qëndrojmë këshillave dhe masave parandaluese e mbrojtëse...

Abdurahim Ashiku

Athinë, mars 2020

Shënim: Nuk e di se si e përjetoi Shqipëria gripin e vitit 1957.

Sa vetë u prekën dhe cila ishte gjeografia e përhapjes së sëmundjes?

Sa vetë vdiqën si pasojë e atij gripi që në radhë është më vrastari pas atij të vitit 1918?

Ky virus le të bëhet shkak për njerëzit, për politikën dhe për drejtuesit e shteteve që aktualisht shpenzojnë miliarda dollarë për prodhim armësh vdekjeprurëse të njerëzimit deri në ato biologjike e kimike, të kujdesen më tepër për shëndetin e popullit, për shëndetësinë, për arsimin, për jetën e popullit.

Nga AHMET ÇAUSHI*

Nga fundi i vitit 2019 e në vazhdim rreth 3 milionë njerëz në gjithë botën po përjetojnë vuajtje shpirtërore, fizike dhe ekonomike. Nga e përse erdhi ky virus kaq i vogël që po trondit botën njerëzore!? Ai erdhi dhe u përhap nga faje njerëzore. Burime të kësaj sëmundjeje janë papastërtia dhe të ushqyerit:

1-Feja islame detyron pastërti shembullore. Besimtari musliman e fillon ditën e re me pastrim të trupit dhe të shpirtit. Sa zgjohet është i detyruar të lajë duart, gojën, hundën, fytyrën, krahët deri tek brrylat dhe këmbët. Gjatë ditës në vazhdim e përsërit këtë pastrim 5 herë në ditë (çdo 3-5 orë). Njeriu është i urdhëruar të pastrojë duar e gojë para e pas çdo të ushqyerje. Gjatë javës ai bën 1 deri në 4 larje të detyruara të trupit. Islami detyron trup e shpirt të pastër, rroba të pastërta dhe vend faljeje e pune të pastra. Po të ishin zbatuar këto detyrime nga njerëzimi koronavirusi nuk do të kishte ardhur tek njeriu, që në fakt vetë është prodhuar papastërtish. Bota sot numëron rreth 8 miliard njerëz. Mjafton të neglizhojë qoftë edhe një person, hapë rrugë për viruse të tilla.

2-Është shkruar se ky virus e ka burimin nga ngrënia e mishit të qenit, të gjarprit, lakuriqit të natës por edhe të derrit, edhe pse e fshehin. Feja islame i ndalon këto edhe kafshë të tjera të egra, mishin e të cilëve e përdorin për ushqim. Ata na përcjellin edhe sëmundje të tjera, nxisin tek njeriu shqetësime shpirtërore. Në vitin 1957 në Kinë u shfaq një virus i tillë i marrë nga mishit i derrit e që solli vdekjen e miliona njerëzve, shkruan Dr.Ibrahim Kazim në librin e tij, Ese. Në vitin që kaloi Bullgaria propozoi brenda pak ditëve 100 mijë derra, që ishin rrezik epidemish. Kina kohët e fundit ndaloj të përdoret për ngrënie mishit i qenit dhe ai i maces. Nëse doni të shpëtoni popujt nga kësaj sëmundje duhet të ndalohen për ngrënie çfarë është caktuar në Kuran.

Këto fatkeqësi vdekjeprurëse dhe tërmetet nuk janë sprovë për njerëzimin. Zoti nuk vret krijesat e veta, sidomos njeriun. Tërmetet janë fenomene natyre. Ato ndodhin ku ka dhe ku nuk ka njerëz. Kur ndërroi jetë djali i Profetit u errësua hëna. Profeti u tha njerëzve se hëna nuk ka lidhje me jetën e djalit tim. Këto ndodhi sjellin pësim dhe mësim. Pësimin e sjellë njeriu për veten e tij. Në suren "Nisa" ajeti 79, faqe 122, thuhet: "Çfarëdo e mirë që të vjen është prej Zotit e çfardo e keq që të bie e ke nga vet ti". Mishin e qenit, të maces, të lakuriqit e të derrit i hëngri njeriu dhe vet u sëmur. Mos prisni më tej. Duhet respektuar porositë e Kuranit. Mos hani mishin e tyre. Kurani nuk është libër vetëm i muslimanëve, por i të gjithëve.

Edhe në të ardhmen si në të kaluarën do të ketë të tilla fatkeqësi. Mbështetur në mësimet islame dhe përvojën profetike kërkohen veprime konkrete e të mos harrohen. Masa e parë e porositur nga Profeti Muhammed është të mbyllën rrugët e shfaqjes dhe të përhapjes sipas porositë të Kuranit: Të ushqehemi me ushqime hallall e të pastra. Po nëse shfaqen

Koronavirusi: ardhja dhe përhapja janë faje njerëzore

■ **Këto fatkeqësi vdekjeprurëse dhe tërmetet nuk janë sprovë për njerëzimin. Zoti nuk vret krijesat e veta, sidomos njeriun. Tërmetet janë fenomene natyre. Ato ndodhin ku ka dhe ku nuk ka njerëz.**

të tilla ndodhi dhe janë të mundura nga njerëz të pakujdesshëm dhe nga kafshë bartës të këtyre viruseve, ç'duhet bërë?! A ka patur raste zgjidhjeje? Po. Para rreth 1500 vitesh u përjetua sëmundja e Murtajës e ngjashme me Koronavirusin e sotëm. Profeti urdhëroi: "Nëse ndodheni në atë familje e më tej në zonën ku shfaqet një sëmundje e tillë, mos u largoni nga ajo familje dhe nga ajo zonë, mos dilni jashtë saj derisa të siguroheni se



Një punonjës i bashkisë së Dibrës duke dezinfektuar xhaminë në qytetin e Peshkopisë. Foto: Bashkia Dibrë

sëmundja nuk vepron më tej. Nëse jeni jashtë kësaj familjeje dhe kësaj zone mos shkoni atje deri sa të zhduket virusi (Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi)". Po të ish kryer kjo porosi e Profetit Muhamed nuk do të kishte vuajtje për popujt. Përhapja e kësaj sëmundjeje vdekjeprurëse masive është faji njerëzor. Ka edhe një të keqe aq të madhe se po përdoret edhe për politikë.

3-Muslimanët dhe jomuslimanët të jenë të bindur dhe të zbatojnë porositë e dhëna që pengojnë përhapjen e virusit vdekjeprurës. Nëse e bëjnë këtë vetë virusi do të vdesë shpejtë. Pejgamberi na udhëzon dhe na siguron kur para 1400 vitesh thotë: "Për çdo sëmundje është krijuar ilaçi, gjejeni dhe përdoren". Ai është në krijimet e Zotit: në lule, prodhime bujqësore në male dhe fusha. Është detyrë islame që shkenca ta kërkojë këtë ilaç. Në hadithin 1046 thuhet: "Shkenca është shtyllë dhe jetë e islamit (e njerëzimit), andaj kush mëson diçka Allahu do t'ja shtojë

shpërblimin, kush mëson e vepron me të Allahu do ti mësojë atij atë që nuk din". Më tej vazhdon: "Më i pikëlluari ditën e gjykimit do të jetë ai njeri që i është dhënë mundësia të mësojë e nuk e ka bërë atë".(77). Nuk është as besim islam, as trimëri, as burrëri të mos zbatosh këto porosi. Mos zbatimi i porosive që synojnë luftën kundër këtij virusi, është faj. Sikur të ndodhë edhe një rast i vetëm që sjell vdekje nga ky virus si do t'u përgjigjen jetimëve, pleqve pa përkrahje, dhimbjes të njerëzve për të dashurit e tyre?! Askush nuk e din ndërrimin e jetës, andaj nuk kërkohet ajo.

Masat mbrojtëse duhen respektuar. Është detyrë fetare islame mosmarrja pjesë në tubime ku kërcënohet jeta nga ky lloj virusi. Feja islame i ka të sqaruara të tëra, edhe ato që do të vijnë. Falja kolektive kudo ka më shumë vlera sepse nxit bashkëjetesë paqësore, por në kësaj rastesh falja kryhet edhe individuale nëpër shtëpitë a në grupe

të vogla ku mund të sigurohen mosmarrja e sëmundjeve ngjitëse. Pastrimi i trupit është domosdoshmëri islame. Edhe kur lind fëmija së pari lahet, por edhe kur ndërrohet njeriu urdhërohet për t'u larë kufoma, të pastrohet mirë, të qefinose pa shumë shpenzime e pastaj të varroset. Për raste si të ditëve të sotme tolerohet: Nëse vërtet mund të jetë burim për sëmundje të tilla kufoma qefinose dhe mbi mbulesën e fundit përshkohet me duar të veshura me doreza e të lagura, jepet tejumum. Çdo hapje rruge për përhapje të sëmundjes ngjitëse e të rrezikshme është e ndaluar. Këto ditë problematike po bëhen më të vështira nga njerëzit. Qindra mijëra të vdekur, miliona të prekur e të trembur, mijëra të shtruar në spitale që jetojnë midis vdekjes e jetës, ndërsa miliarda në arrest shtëpie. Ja si i paguajnë popujt pakujdesitë duke filluar nga individi e në vazhdim me qeveritë. Duhet të kufizohen vizitat kolektive, të zbatohen tërë ato porosi që janë dhënë e luftojnë këto soj mikrobesh nga kushdoqoftë. Tregtarët nuk duhet të fshehin mallin e të ngrenë çmimet. Ju duket se fitojnë, por shumë shpejtë do të provojnë dënime në punën e tyre si varfëria dhe dënimin në jetën e pasorit. Edhe kjo do të vijë. Mësime për të tëra kemi e keni në Kuran. Në një nga ajetet e sures bekare, ajeti 195, faqja 59, thuhet: "Shpenzoni gjithçka: "dije, kulturë, pasuri" etj, në rrugë të Zotit e mos e hidhni veten në humnerë, rrezik. Bëni mirë sepse me të vërtetë Zoti i do dhe i shpërblen bamirësit. Në ajetin 32 të sures bekare thuhet: Sikur një njeri të bëhet shkak për të shpëtuar një person tjetër do të shpërblehet sa me shpëtuar tërë njerëzimin e nëse bëhet shkak për vdekjen e një njeriu do të ndëshkohet sa me vra gjithë njerëzit mbi tokë.

Ky virus le të bëhet shkak për njerëzit, për politikën dhe për drejtuesit e shteteve që aktualisht shpenzojnë miliarda dollarë për prodhim armësh vdekjeprurëse të njerëzimit deri në ato biologjike e kimike, të kujdesen më tepër për shëndetin e popullit, për shëndetësinë, për arsimin, për jetën e popullit. Nga ky popull i marrin fitimet e duhet t'ja u shpërblejnë me bamirësi, siç u thanë ajetin e mësipërm. Edhe agjërimi që po kryejmë i shërben këtij qëllimi. Ai pastron tërë organet trupore nga mbetjet vjetore si dhjamosja, ujërat e tepërta, mbetje djerse, çlodhje në tërësi të organizmit e bashkë me ta asgjëson mikrobe të shumta. Ai pastron edhe ndërgjegjen e njeriut, nefsën dhe mendjen, forcon organizmin dhe e bën atë më të qëndrueshëm për tu përballë me kësaj vështirësie për një jetë më të shëndetshme e më frutdhënëse në tërë jetën.

*Ish myfti i Dibrës
*Ish kryetar i Këshillit të Përgjithshëm të Komunitetit Mysliman Shqiptar

Dëshironi të **BOTONI PAK KOPJE LIBRI**, por nuk mundeni sepse shtypshkronjat ju kërkojnë të paguani për një tirazh të madh...

Tani nuk është nevoja të prisni...

JU OFROJMË BOTIME NGA 1 KOPJE E VETME!

Njëlloj si në shtypshkronjë... Çmime të favorshme dhe shpejtësi!

Telefono: **068 65 08 441** ose shkruaj email: **mbbotime@gmail.com**

M'u desh që për disa minuta ta shkëpus nga atmosfera tepër e gëzueshme e ditëlindjes së 70-të të tij, nga pjesëtarët e familjes së tij të ngushtë që kishin fluturuar (ndër ë tjera me një shishe stërmadhe me verë italiane me një urim domethënës) për të qenë të pranishëm në ditën e shënuar të babait, xhaxhait, gjyshit nga miqtë dhe shokët dhe në veçanti nga ata që nuk ishin ndarë me të që nga viti 1966, shokë klase e që nga viti 1970 kolegë në profesionin e agronomit, aq të dashur me njeri tjetrin që së bashku ishin gëzuar në takimet e përvitshme me njeri tjetrin dhe ishin hidhëruar duke përcjellë shokë në amshim. Për ta Xhevatit do të na ngrinte në këmbë në një minutë heshtje me një pikë loti në sy...

I mora zërin, tashmë ngrirë në një zarf kompjuterik...

I mora fjalën, tashmë juaja në faqe gazetash e portalesh, ndër të tjera edhe në një "udhëtim" Rugës së Arbrit, në "Rruga e Arbërit"...

* * *

Ashiku: Përshëndetje Xhevat Dani!
Takohemi pas 49 vjetësh mësuesi dhe nxënësi. Takohemi më 9 gusht 2019, në ditëlindjen e shtatëdhjetë.

Të uroj edhe 100 vjet jetë pas të shtatëdhjetave që feston sot.

Dani: Faleminderit!
Çfarë janë 70 vjet për Xhevat Danin?

Dani: Shtatëdhjetë vjet për Xhevat Danin janë kontribut; kontribut për familjen, kontribut për zonën e Maqellarës, kontribut për Dibrën. Jam shumë i ndërgjegjshëm që nuk kemi bërë aq sa duhet, por do të bëjmë. Do të bëjmë edhe pse kemi bërë 70 vjet dhe jam pensionist, Dibrës sonë do ti shërbejmë.

Ashiku: Kur dhe ku ke lindur?
Kam lindur në fshatin Podgorcë më 9 gusht të vitit 1949.

Pasi mbarova shkollën 8 vjeçare në Maqellarë mu dha mundësia që të vazhdoj shkollën e mesme në Peshkopë.

Kënaqësi e imja ishte që pata pedagog Abdurahim Ashikun që e kam të pranishëm në këtë ditëlindje time.

Jeta ime në shkollë ka qenë një jetë që me të gjithë shokët kemi kaluar në mënyrë të shkëlqyer dhe tash 49 vjet që kur mbaruam shkollën i ruajmë lidhjet tona me shokët e klasës.

Vit për vit takohemi. Sivjet është kënaqësi që takohemi për ditëlindjen time. Kënaqësi e madhe është se kam profesorin tim të nderuar, të pranishëm shokun Abdurahim Ashiku.

Kush nga bashkënxënësit tuaj është i pranishëm sot?

Ashiku: Të pranishëm kam Halil Tanën nga Shkodra, Sabri Ismailin nga Tirana, Ismet Bokën nga Tirana, Hamza Hykën nga Tirana, Engjëll Cukun nga Shkodra, Gjergj Tonin nga Shkodra, Selim Agën nga Tirana, Sabri Ismailin nga Baldushku i Tiranës dhe shokë e shokë të tjerë.

Ashiku: A mund të ma përshkruash udhëtimin tënd nëpër Dibrë?

Dani: Në vitin 1974 mbarova arsimin e lartë, në Tiranë, në Kamzë. Fillova punën si agronom dhe arsimtar në Maqellarë. Nga Maqellara shkova kryeagronom dhe kryetar kooperative në Klenjë. Prej Klenje erdha kryetar kooperative në Maqellarë. Kam punuar sekretar i Këshillit të Bashkuar të Maqellarës, përgjegjës për agjencinë e zhvillimit të zonave malore për katër rrethe; Mirditë, Mat, Bulqizë dhe Dibër. Në fund e mbylla me bankën Opornuty Albania. Sot jam pensionist. Jeta ime ka qenë që ti shërbej sa më mirë popullit tim, fshatarëve të mi, popullit të Dibrës. Dhe kam kontribuar shumë për Dibrën. I kam dhënë Dibrës shumë. Njëmbëdhjetë vite që kam punuar në Klenjë,

Xhevat Dani i Podgorcës së Dibrës



- Kam shëtitur Amerikën, kam shëtitur Evropën, Francën, Italinë. Kënaqësia ime është vendlindja ime. Këtë kam zgjedhur. Fëmijët janë në emigracion. Punojnë me djersën e ballit.**
- Dani: Ky është fshati Podgorcë, vendi ku unë kam lindur, vendi që unë e dua shumë. Shumë njerëz duan të ikin, ndërsa unë kam ble tokë për t'u ngulë mirë në këtë fshat. I kam mbjellë grurë, misër me fasule, shalqinj, bostan, perime të ndryshme që ne i pëlqejmë. Është një fshat i mrekullueshëm buzë Drinit me toka pjellore, të ujitshme. Njerëzit janë të shtruar pas pune. Të gjithë e kanë ndërtuar jetën për sëmbari.**

edhe sot e kësaj dite, klenjasit më urojnë për gjithçka. Më urojnë për festa zyrtare, festa fetare, për shumë e shumë të tjera. Nuk e di se si mund ta përshkruaj kënaqësinë, respektet që ruhen të jashtëzakonshme nga zona ku kam punuar. Gjithë njerëzit flasin fjalët më të mira për Xhevatin.

Ashiku: Ku banon tani?

Dani: Tani banoj në vendlindjen time, në Maqellarë. Është kënaqësi e madhe. Kam shëtitur Amerikën, kam shëtitur Evropën, Francën, Italinë. Kënaqësia ime është vendlindja ime. Këtë kam zgjedhur. Fëmijët janë në emigracion. Punojnë me djersën e ballit. Kënaqësia ime është se kam fëmijë të mrekullueshëm që ma kanë organizuar edhe këtë 70 vjetor sot.

Ashiku: Sa fëmijë ke?

Dani: Kam gjashtë fëmijë. Tre djem e tri vajza. Vajzën e madhe dhe dy djemtë e mëdhenj i kam në Firence të Italisë. Djalin e vogël e kam në New York në Amerikë, dy vajzat tjera i kam në Tiranë. Janë me fëmijë, punojnë, janë të kënaqur nga jeta. Janë të gjithë të arsimuar me arsim të lartë. Është kënaqësi që i kam fëmijë dhe megjithëmend janë për së mbari. Nipër e mbesa kam plot. Kur mora një vizë nga ambasada amerikane një nga pyetjet që mu bë ishte përbërja e familjes. U thashë fëmijë kam plot, nipër e mbesa kam plot. Më tha: "Ti do të shkosh në Amerikë"

Ashiku: Cili është mesazhi jot për të gjithë shokët tuaj të klasës, njerëzit e tuaj këtu dhe larg në këtë ditë të shënuar tuajën?

Dani: I uroj shokëve të mi të klasës pleqëri të mbarë se në pension janë, të gëzohen familjarisht, me familje, nipër e mbesa me çfarë kanë.

Fëmijëve të mi, për djemtë e vëllait që kanë ikur nga Italia për të festuar 70 vjetorin e xhaxhait sot në Dibër, me shpenzime, me kanë ardhur dhe i kam të pranishëm. Mesazhi im më i madh është: Shqipëri të qetë, Shqipëri ku të punohet për mirëqenien e këtij populli, për të ardhmen e fëmijëve tanë. Ky është mesazhi im si kuadër që kam

shërbyer dikur por që vazhdoj të jem edhe kuadër sot pavarësisht se jam në pension.

Ashiku: Këtu ku jemi është pjesë e Podgorcës?

Dani: Ky është fshati Podgorcë, vendi ku unë kam lindur, vendi që unë e dua shumë. Shumë njerëz duan të ikin, ndërsa unë kam ble tokë për t'u ngulë mirë në këtë fshat. I kam mbjellë grurë, misër me fasule, shalqinj, bostan, perime të ndryshme që ne i pëlqejmë. Është një fshat i mrekullueshëm buzë Drinit me toka pjellore, të ujitshme. Njerëzit janë të shtruar pas pune. Të gjithë e kanë ndërtuar jetën për sëmbari.

Ashiku: Faleminderit shumë!

Dani: Rrofsh profesor! Sot kam ndje një kënaqësi të jashtëzakonshme jo për pjesëmarrjen e shokëve por për pjesëmarrjen tënde. Kishte vite që nuk ishim parë dhe kur më thanë se do të vijë profesor Abdurahimi të them të drejtën u gëzoza dhe shpreha kënaqësinë më të madhe dhe thashë shpyqyr që do ta kemi në mesin tonë atë ditë.

Abdurahim Ashiku

Fragment nga reportazhi "Pas gjysmë shekulli, mes nxënësve të mi..."

printime dixhitale

me ngjyra dhe bardh e zi

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme

libra | broshura | revista | fletëpalosje

katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.

duke filluar nga 1 kopje e vetme

për informacion: mbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

emigracion

Të pasqyrosh vlerat më të mira të një kombi është punë me patriotike, edhe më shumë se të dalësh me flamur në rrugë.

Arjan Cara i Bulqizës dhe Selanikut

Nga ABDURAHIM ASHIKU,
gazetar-Athinë

...Një emigrant, një që vjen nga një vend i huaj dhe që shkon për arsye të ndryshme në një vend tjetër, shkon gjithnjë me mendimin për tu kthyer. Fatkeqësisht emigrantët mbeten emigrantë. Gjithmonë e kemi në mendje që një ditë do të kthehemi por se kur është ajo ditë është e pamundur ta përcaktosh.

... Qëllimi i shoqatës "Nënë Tereza" është që gjuha shqipe të bëhet pranë gjuhës greke në shkollat greke, aty ku mësohet gjuha greke, atje duhet të mësohet edhe gjuha shqipe. Nuk mendoj se ka shoqatë të arrijë dhe të bëjë një shkollë sepse ajo që bëjmë ne nuk mund të quhet shkollë, është mësim plotësues, është thjesht një kurs.

E kisha zbardhur nga diktofon mbushur me emocione e atyre dy ditëve të bukura të Selanikut kur më 11 maj 2014 (në ditëlindjen time të 73-të), në një tubim të bukur në 10 vjetorin e shoqatës "Nënë Tereza", paraqita librin "Shkolla shqipe e Selanikut"...

Më ishte "fshehur" në arkivin tim të gjerë të mërgimit. E kërkoja por nuk e gjeja...

E gjeta, vonë, pas afro gjashtë vjetësh...

Po e përcjell në vlerë të Shoqatës shqiptare "Nënë Tereza", të qenies së tij kryetar i saj...

Në vlerë të Bulqizës, malli për të cilën këndellet prush...

Ashiku: Ku janë rrënjët e Arjan Carës?

Cara: Jam nga Caret e Bulqizës. Origjina ime është, si më ka thënë gjyshi, nga Caret e Kastriotit ardhur para 500 vjetësh. Janë dy familje të shpërngulura atje dhe janë ulur në Bulqizë për arsye që nuk i dimë. Në atë kohë kishte shumë lëvizje demografike. Jam rritur në Bulqizë. Shkollën 8 vjeçare e kam bërë në Bulqizë. Të mesmen e kam bërë në Durrës. Kam mbaruar për mekanikë të përgjithshme. Më lart për arsye se gjyshi ishte zogist, xhandar i Zogut, nuk më dhanë të drejtën e studimit.

Ashiku: Në Bulqizë a ke njeri?

Cara: Në Bulqizë kam të gjithë të njohurit e mi, kam miqtë, shokët, fëmijërinë time. Kam motrën time të martuar atje. Nga fisi Cara kam Sami Carën. Sabri Carënduhet ta mbash mend. Edmond Xhafa drejtori i sotëm i Bulqizës është kushëriri i parë imi. Gjysmën e Bulqizës i kam njerëz të njohur dhe miq të mi, të afërmit e mi, kështu që po ti përmend me emër është një listë e gjatë.

Ashiku: Të shoh që qesh me shpirt kur i përmend. Të ka marrë malli për ta?

Cara: Qesh sepse fëmijëria është ajo që e kujton me nostalgji, e kjo kur je edhe larg atdheut tënd, bëhet më e mallëngjyeshme sepse të kujton, të kalojnë nëpër mendje figura të jetës tënde, të fëmijërisë, rinisë, miq, dashamirë, shokë, të rinj që janë shpërndarë dhe kam vite pa i takuar.



Ashiku: Kur ke ardhur në Greqi?

Cara: Për herë të parë kam ardhë në fund të '93 fillim i '94. Erdha rastësisht. Greqinë nuk e quaja vend ku mund të vija për emigrim, e quaj thjesht një vend ballkanik, një vend që ishte i pasur por nuk e mendoja të ardhmen time në Greqi. Më shumë isha për perëndimin, Itali.

Një miku im më thotë: Arjan do iki në Greqi. Unë në atë kohë isha në punë shtetërore, punoja në ndërmarrjen e ujërave mekanik, pastaj kalova në një park mekanik. Më emëruan në Bulqizë por pastaj u ktheva në Durrës. Erdha me të. Morëm një 30-40 mijë dhrahmi. Paguam një taksë dhe erdhëm.

Në fillim u vendosëm këtu afër, në Kalkidhiki. Më pas me mësimin e gjuhës gjeta vend dhe fillova punën në zanatin tim. Kam bërë punë nga më të ndryshmet këtu në Greqi. Kam bërë punë bujqësie që unë nuk kisha punuar asnjëherë. Punoja për tu vendosur në qytete si Selaniku apo Athina. Kam punuar 4 vjet në Athinë.

Përfundimisht më pëlqeu Selaniku sepse është një qytet mjaft i bukur. Gjeta edhe shqërinë time jo të vjetër por krijova një shqëri të re. Kam 15 vjet në Selanik. Jam i martuar me dy djem. Nusen e kam nga... ka një shprehje këtu në Greqi... "Këpuçë të vjetra, le të jenë të grisura por nga vendi jot". E kam marrë nga Bulqiza, nga fisi Muça. Unë tani punoj hidraulik me profesion të lirë. Kam qenë i varur por tani jam në profesion të lirë. Gruaja merret me rritjen e fëmijëve ende të vegjël.

Ashiku: Ju jeni kryetar i shoqatës "Nënë Tereza". Çfarë është shoqata për ju?

Cara: Është pyetje e vështirë. Është shumë e vështirë të gjej një përgjigje e ta përmbledh në një fjali.

Një emigrant, një që vjen nga një vend i huaj dhe që shkon për arsye të ndryshme në një vend tjetër, shkon gjithnjë me mendimin për tu kthyer. Fatkeqësisht emigrantët mbeten emigrantë. Gjithmonë e kemi në mendje që një ditë do të kthehemi por se kur është ajo ditë është e pamundur ta përcaktosh. Mendoj se të gjithë njerëzimi në këtë botë është emigrant, i gjithë njerëzimi është në emigracion.

Shoqata për mua është diçka që unë e respektoj aq shumë, diçka që e shoh, e shoh... që të gjej fjalën e përshtatshme si diçka që emigrantët shqiptarë të jenë të bashkuar dhe të bëjnë një diçka që s'po e gjej fjalën...

Dashmir Zaçe: Që shqiptarët të mblidhen e punojnë të bashkuar për të mbrojtur të drejtat e tyre në emigracion. Kjo është shoqata për një kryetar dhe për një anëtar.

Ashiku: Si e sheh të ardhmen tënde?

Cara: Një emigrant, një që vjen nga një vend i huaj dhe që shkon për arsye të ndryshme në një vend tjetër, shkon gjithnjë me mendimin për tu kthyer. Fatkeqësisht emigrantët mbeten emigrantë. Gjithmonë e kemi në mendje që një ditë do të kthehemi por se kur është ajo ditë është e pamundur ta përcaktosh. Mendoj se të gjithë njerëzimi në këtë botë është emigrant, i gjithë njerëzimi është në emigracion. Kur përmend shoqatën gjëja më e thjeshtë për emigrantët është të bashkohen në një shoqatë, në një bosht. Duke u bashkuar bën gjëra që nuk i arrin t'i bëjë një individ. Shoqata "Nënë Tereza" ka arritur më së mirë ta bëjë këtë gjë. Ka bashkuar njerëz, ka bashkuar politika të ndryshme, ka bashkuar kulturat. Përpjetat të hapë gjuhën shqipe që është nga më të rëndësishmet. Po rritet brezi i ri. Po nuk u mësua gjuha, po s'u mbrojt brezi i ri që po rritet këtu, fatkeqësisht ajo humbet. Ne po bëjmë diçka simbolike por duhet zgjidhje përfundimtare. Nuk është zgjidhje që një shoqatë ose të gjitha shoqatat të mar-



rin përsipër mësimin e gjuhës shqipe. Kjo është simbolike. Nuk arrin dot shoqata, nuk mendoj se mund të arrijë ndonjë shoqatë ta mbajë. Atë që bën është simbolike dhe është një simbolikë e çmuar që ne e bëjmë që në krijimin e shoqatës prej 10 vjetësh, por qëllimi i shoqatës "Nënë Tereza" është që gjuha shqipe të bëhet pranë gjuhës greke në shkollat greke, aty ku mësohet gjuha greke, atje duhet të mësohet edhe gjuha shqipe. Nuk mendoj se ka shoqatë të arrijë dhe të bëjë një shkollë sepse ajo që bëjmë ne nuk mund të quhet shkollë, është mësim plotësues, është thjesht një kurs.

Shoqata është një organizatë në një vend ku njerëzit shprehin mundësitë e tyre, mendimet e tyre, dëshirat etyre ku organizohet. Pa organizim nuk ka asgjë të mirë. Shoqata është një vend ku forcohet uniteti mes shqiptarëve në mërgim, ku krijohen mundësitë që të shpreh njeriu mundësitë dhe aftësitë e tij, ku krijohen mundësitë që të jepet një ndihmë më e specializuar për hallet që kanë njerëzit. Shoqata tani mendoj se duhet të pasqyrojë mbledhjen e vlerave më të mira të emigracionit dhe të pasqyrimit të këtyre vlerave.

Dua të them se të pasqyrosh vlerat më të mira të një kombi është punë me patriotike, edhe më shumë se të dalësh me flamur në rrugë. Për këtë punon shoqata "Nënë Tereza". Përpjetat t'i përcjellë opinionit vendas se emigrantët nuk janë ata që erdhën nga një vend dhe erdhën për punë por janë emigrantë që kanë një kulturë, kanë gjuhën e tyre, kanë talentet e tyre, identitetin e tyre ashtu si i kanë edhe vendasit. Këto vlera shoqata i pasqyron dhe i trumbeton në mënyrën më të mirë të mundshme. Pasqyrimi i vlerave të kombit.



Bëj një abonim online ose në print...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...

email: rrugaearbërit@gmail.com



Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit ose ndiq linkun: <https://tinyurl.com/lcc3e2f>

100-vjetori i lindjes së ish-partizanit të Brigadës së 18-të Sulmuese dhe kryetarit të parë të Kooperativës Bujqësore Muhurr, Dibër

Xhetan Prençi, burri shekullor i Muhurrit e i gjithë Dibrës

Nga Halil RAMA

Si i shpëtoi burgut, pas incidentit me ish kryeministrin Mehmet Shehu, kur kërkoi investime qeveritare për kanalin vaditës të Fushës së Muhurrit

Ndërhyrja e Haxhi Lleshit për të mos e mbajtur në arrest pinjollin e familjes, dëshmorët e së cilës, të rënë në lufrat me serbët, edhe sot i kanë varret në Kolosian të Kukësit



Më 5 prill 2020, ish-partizani i Brigadës së 18-të Sulmuese dhe kryetari i parë i Kooperativës bujqësore Muhurr, Dibër, Xhetan Prençi festoi ditëlindjen e 100-të. Zoti i fali këtë jetëgjatësi këtij burri trim e të mençur, simbol i urtësisë dhe i njeriut me shpirt sakrifice e humanizmi, që nderon Muhurrin e gjithë Dibrën. Xhetan Prençi është pinjolli i fisit Prençi, lindur më 5 prill 1920, i cili jeton dhe sot dhe sapo ka mbushur plot 100 vjeç.

Ai mbahet mend nga bashkëmoshatarët për një fëmjëri të mbarë dhe dëshirë për arsimim. Xhetani kishte mbaruar arsimin 5-vjeçar dhe kuptonte shumë mirë zhvillimet e kohës. Në vitin 1943 bëhet aktiv i lëvizjes Nacional-Çlirimtare dhe në gusht 1944 bëhet pjesë e Brigadës së 18-të Sulmuese që u formua në Sllatinë, Diber.

Xhetan Prençi ka luftuar me armë në dorë për 30 muaj, nga gushti 1944 e deri në Janar 1947, kohë kur u shpërnda Brigada e 18-të Sulmuese, ku ai bënte pjesë. Ai ka qenë në vijën e parë të frontit në betejat që kjo brigadë ka zhvilluar në zonën e Prizrenit dhe të Kosovës, deri në kufi me Serbinë.

Pas vitit 1947, Xhetan Prençi ka punuar si teknik pyjesh dhe si drejtues i pushtetit popullor.

Në vlerësim të kontributit të tij në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, më 1 Nëntor 1951, Xhetan Zenel Prençi, është dekoruar me “Medaljen e Çlirimit” nga presidenti i kohës Omer Nishani.

Në vitin 1967 deri në vitin 1969, do t’i ngarkohej detyra e Kryetarit të Kooperativës Bujqësore Muhurr dhe kështu do të ishte kryetari i parë i kooperatives, pas kolektivizimit të bujqësisë dhe kalimit nga

prona private në pronë kolektive. Në këtë funksion të vështirë, Xhetani do të dallohej për vullnetin dhe dëshirën për të punuar dhe për të drejtuar mbarëvajtjen e punëve në kooperativën Bujqësore të Muhurrit, me qëllim përmirësimin e jetesës së muhurrakëve, duke ngritur vlerën e ditës së punës. Për këtë ai ishte kërkues ndaj punonjësve muhurrakë, por edhe në organet e larta të partisë dhe pushtetit në rrethin e Dibrës.

SI I SHPËTOI BURGUT PAS “INCIDENTIT” ME ISH KRYEMINISTRIN MEHMET SHEHU

Në vitin 1969, Muhurrin e viziton ish kryeministri i kohës Mehmet Shehu dhe Xhetani do të ishte padyshim njeriu që do e priste bashkë me popullin e Muhurrit. Në takim e sipër, Xhetani, në rolin e kryetarit të kooperatives do t’i drejtohej kryeministrit Mehmet Shehu, duke i kërkuar ndihmë për hapjen e kanalit të madh që mernte ujin në “Gjurrën e Kumullës”, në Rrasë të Bardhë, afër lumit Murra, që do të përshkonte gjithë Muhurrin, duke futur nën ujë e vaditje mbi 450 hektarë tokë në Fushë-Muhurr dhe Vajmdhej. Ky kanal do të ndikonte në rritjen e prodhimit dhe kultivimin e disa kulturave bujqësore.

Kryeministri Shehu, duke parë pozicionin gjeografik të Muhurrit mes dy lumenjeve dhe të rrethuar me male tha: “Muhurri duhet të ishte “Myzeqe për Dibrën”, se i ka të gjitha kushtet klimatike për zhvillim të hovshëm të bujqësisë dhe blegtorisë, por duhet të punoni vetë e njëkohësisht edhe kanalin duhet ta hapni vetë. Po të isha unë kryetar i kooperativës bujqësore Muhurr, nga 50 lek për ditë pune do e kisha ngritur në 200 lekë, por ju kërkoni vetëm nga partia dhe qeveria”.

I gjendur përpara këtij presioni të kryeministrit Shehu, kryetari i kooperativës bujqësore Muhurr Xhetan Prençi, mendoi se zgjidhjen do e gjente tek alegoria dibrane, ndaj i drejtohet kryeministrit duke i thënë: “Shoku kryeministër! Unë nuk e kam fuqinë dhe kompetencat tuaja. Kanali ka nevojë për lëndë eksplozive dhe punë të specialistëve, pasi një gjatësi mbi 5 km e tokës ku duhet të kalojë kanali është shumë shkëmbore, ndërsa ne nuk i kemi as lëndën shpërthyesë dhe as specialistët. Edhe pula u mundua ta bëjë vezën sa pata, por i plasi b....”

Kur kryeministri dëgjoi alegorinë, menjëherë urdhëroi arrestimin e kryetarit të kooperativës Xhetan Prençi dhe dërgimin e tij në Peshkopi. Pastaj kryeministri Shehu iu drejtua popullit të Muhurrit se kanali do të hapej nga Partia dhe do jetë dhuratë e Partisë për popullin punëtor të Muhurrit. Për lirim të Xhetanit nga arrestimi ndërhyri Haxhi Lleshi që shoqëronte Kryeministrin,

Më 5 prill 2020, ish-partizani i Brigadës së 18-të Sulmuese dhe kryetari i parë i Kooperativës bujqësore Muhurr, Dibër, Xhetan Prençi festoi ditëlindjen e 100-të. Zoti i fali këtë jetëgjatësi këtij burri trim e të mençur, simbol i urtësisë dhe i njeriut me shpirt sakrifice e humanizmi, që nderon Muhurrin e gjithë Dibrën. Xhetan Prençi është pinjolli i fisit Prençi, lindur më 5 prill 1920, i cili jeton dhe sot dhe sapo ka mbushur plot 100 vjeç.

duke argumentuar se Xhetani kishte qenë partizan dhe ishte nga një familje e mirë që kontribonte në bujqësi e blegtori. Disa ditë më vonë, filloi puna për hapjen e kanalit dhe shumë shpejt e gjithë toka bujqësore në Muhurr u fut nën ujë dhe në sistemin vaditës.

Xhetan Prençi u lirua brenda ditës nga Dega e Brendshme, por kryeministri kishte urdhëruar se ai nuk do të ishte më kryetar kooperative. Nga ajo ditë, ai ka punuar si Teknik Pyjesh, deri sa doli në pension në vitin 1985.

VËLLAI I VETËM SELIMI, “VIKTIMË” E KËRKIMEVE TË URANIUMIT!

Edhe vëllai i Xhetanit (Selim Prençi), 8 vjet më i vogël se ai, do të kishte një karakter “rrebel” dhe reagim të drejtëpërdrejtë me të gjithë udhëheqësit e pushtetit e të partisë, kur ishte nevoja.

Ai do të ishte punonjësi i parë i mbledhjes së taksave pas vendosjes së pushtetit popullor. Më pas punoi si magazinier i tregtisë dhe pastaj për plot 27 vite ishte punonjës në minierat e mermerit në Muhurr dhe Balxhaj. Selimi ka marrë pjesë edhe në kërkimet e Uraniumit si shumë muhurrakë të tjerë, të cilët ashtu sikurse ai, pikërisht për këtë arsye, ndërjuan jetë para kohe...

EMRA TË TJERË TË FISIT PRENÇI

Nga fisi Prençi, do të spikasin edhe të tjerë burra si: Bajram Prençi si xhandar trim në Tropojë në kohën e Zogut dhe Mehmet Prençi si oficer i Ushtrisë Shqiptare për 37 vite. Muhurri dhe Dibra nuk do të harrojnë as zgjuarsinë dhe shkathtësinë e Mexhit Prençit



nga Hurdhë Muhurr apo vullnetin për punë dhe organizim të Nazif Prençit. Fisi më pas do të ketë më të rinjtë e tij si: Faik Prençi, Ajet Prençi, Besnik Prençi (veteriner e zooteknik në ish Kooperativën Bujqësore e Ndërmarrjet Bujqësore Dibër), Avni Prençi (kryeagronom e më pas kryetar Kooperative në Muhurr) dhe Xhelal Prençi, që do të ishte për 30 vjet mjeshtri duaraartë i mekanikës në SMT, duke nderuar veten, fisin dhe Muhurrin me urtësinë dhe profesionalizmin e tij. Dy djemtë e Xhetanit gjithashtu, kanë dhënë kontribut të madh për komunitetin, pasi Besniku ka punuar si veteriner dhe ndihmësmjek, ndërsa Zeneli si punonjës policie (u vra në krye të detyrës në vitin 2002). Agron Prençi, Shensi Prençi, Zenel Prençi dhe Adrian Prençi, do të ishin ushtarakët e karrierës të cilët do ta përfaqësonin denjësisht fisin dhe Muhurrin në Dibër dhe në Shqipëri.

Xhetan Prençi kishte dy djem, Besnikun dhe Zenelin, të cilët kanë dhënë kontribut në komunitetin e Muhurrit. Besniku si veteriner dhe ndihmësmjek, ndërsa Zeneli si punonjës policie, i cili u vra në krye të detyrës në vitin 2002.

“VARRET E PRENÇIT” NË KOLOSIAN

Në Kolosian të Kukësit është një vend me emrin “Varret e Prençit”. Ky toponim nuk ka mbetur rastësisht, por përkundrazi për të përjetësuar luftëtarët trima të këtij fisi të Muhurrit, të rënë në betejën legjendare kundër pushtuesve serbë në Kolosian. Ajo është një histori qëndrese që ia rrit lavdinë jo vetëm fisit Prençi, por gjithë Muhurrit. Kronikat e kohës dëshmojnë se në këtë betejë të përgjakshme janë vrarë disa nga burrat e fisit Prençi si: Rushit Prençi, Isuf Prençi, Bajram Prençi (të vjetrit), Abaz Prençi, Vesel Prençi. Pesë kushërinj janë vrarë në front, ndërsa Mysim Prençin e kanë marrë rob dhe e kanë pushkatuar në Zhur të Prizrenit. Pas luftimesh të përgjakshme, ata kanë rënë heroikisht në Kolosian të Kukësit, pikërisht në atë vend që edhe sot mban emrin “Varret e Prençit”.

Ata ishin pasardhësit e Dalip Prençit, i cili kishte lëvizur shumë dhe e njihte jetën, madje ai kishte qenë një luftëtar i vazhdueshëm në lufrat kundra serbëve, si dhe të Zenel Prençit të vjetër, që ishte njohës i mirë i gjuhës turke, pasi kishte udhëtuar në kurbet për në Turqi dy herë nga 7 vite (1913-1919 dhe 1920-1927) dhe pas kthimit kishte arritur të ngrinte tufat e mëdha të bagëtive me fitimet e kurbetit.

Në gjurmët e tyre eci vendosmërisht edhe Xhetan Prençi, i cili gjatë jetës së tij ka dhënë kontribut të rëndësishëm për përmirësimin dhe shtimin e pyjeve në zonën e Dibrës. Por, ajo që ia rrit vlerat më shumë, është fakti se ka arritur të kontribuojë edhe për pajtime gjaqesh në zona të ndryshme të Dibrës si dhe për sheshimin e mjaft ngatërresave mes individësh apo fisesh. Ne pasardhësit e tij, krenohemi me jetën, mendjen dhe veprën e këtij vigani, luftëtar e patriot, pjesëmarrës me armë në dorë në Luftën e lavdishme Antifashiste Nacionalçlirimtare, guximtar e të pathyeshëm në kohën kur drejtonte kooperativën bujqësore. Pasi kundërshtoi hapur ish kryeministrin Mehmet Shehu, vërtet i vuajti pasojat e rebelimit të tij, por këtë e bëri në dobi të prosperitetit të Muhurrit.... Përkushtimin për punën që i besoi do ta shfaqte edhe më vonë për vite të tëra si kontributor shembullor për zhvillimin e pyjeve e të kullotave. Pikërisht për këtë kontribut të çmuar, ai do të frymëzojë brezat. Ndaj nga zemra na del urimi: “I dhëntë Zoti edhe sa më shumë vite jetë në gjirin e familjes së tij të ngrohtë e të nderuar!”.



Hajdar Poliçi punoi plot pasion
e përkushtim gjatë gjithë karrierës së tij.

Nga OSMAN XHILI

Hajdar Poliçi lindi në Katundin e Ri, me 15 dhjetor 1947, në një familje të thjeshtë punëtore.

Babai i Hajdarit, Rama, deri nga vitet 1960 është marrë me bujqësi e blegtori. Rama ishte njeri shumë punëtor, inteligjent e njeri besimtar. Në punët e tij të përditshme e ndihmonin shumë edhe fiziku i tij i veçantë, zgjuarsia dhe pasioni. Ai bënte gjithçka, siç thotë populli: “Çfarë i shihte syri, i bënte dora”. Ai kryente rolin e infermierit në familje, në fisin e tij e më gjerë, rolin e kuzhinierit në fshat e zonë, për raste vakish, rolin e rrobaqepësit (për rroba e leshta), murator, karpentier e kudo tjetër ta kërkoje. Në pemëtoren modeste të tij do të gjeje edhe bajame apo mana te zinj të Sharakanit (zonë e lartë në thellësi të Muhurrit). Në fëmijërinë e tij Rama kish ndjekur shkollën (5 klasë) dhe kishte qenë nxënës i shkëlqyer, me të gjithë notat njësha, nota me e lartë e atyre viteve.

Në vitin 1960 nis një punë dhe eksperiencë e re për të, si magazinier në ndërmarrjen “Guri i Kuq” Muhurr. Me korrektësinë e tij dhe saktësinë në veprime, Rama qëndroi në atë pozicion pune derisa doli në pension. Ishte njeri që herë pas here lexonte ndonjë libër, kryesisht fetar, të fesë islame. Shumë vite më pas, profesor Hajdari, gjen një nga librat e babait të tij, Dhiaata e Re, aty në një valixhe druri, të punuar po nga duart e tij.

Midja, ishte e ëma e Hajdarit. Në një shtëpi të madhe, me shumë hyrje e dalje, me gjashtë fëmijë, ishte e vështirë mbijetesa. Por zemra e saj e bardhë, shpirti i saj altruist, do të dinte të përballonte mikpritjen, shërbimet në familje dhe punën në kooperativën bujqësore. Për çdo ditë do të përcillte fëmijët për në shkollë, të ushqyer mirë e në veçanti të pastër. Ajo do të kujdesej për veten e saj, vetëm kur të tjerët ishin në gjumë.

Meqë Rama shkollën e kishte pasion, nxiti dhe dërgoi fëmijët për shkollim. Edhe pse në zonë nuk kishte shkollë të mesme (deri pas viteve 1970), të gjashtë fëmijët e tij mbaruan shkollën e mesme, ndërsa dy prej tyre, Hajdari dhe Isufi mbaruan shkollat e larta (Hajdari për mësuesi, Isufi për inxhinieri elektrike).

PROFESOR HAJDARI, MË I MADHI I FËMIJËVE.

Pasi mbaroi shkollën fillore në Katund të Ri, djaloshi, i etur për dije e kulturë, vazhdoi shkollën 7-vjeçare dhe atë të mesme pedagogjike në Peshkopë. Përveçse ishte një nxënës shumë i mire në mësim, ai shkëlqeu në muzikë, si instrumentist në mandolinatën e shkollës pedagogjike. Qëkur ishte pesë vjeç, ai kishte mësuar notin në mënyrë të shkëlqyer. Kishte parë e dëgjuar valët e Drinit, vetëm pak metra poshtë shtëpisë së tij, herë të përplaseshin egër e herë të tjera të rrëshqisnin butësisht. Ato lëviznin brenda shtratit të lumit, si në një pentagram gjigant. Kishte dhe lumi notat e tij, muzikën e tij, gjuhën e tij e të gjitha këto do të linin gjurmë të pashlyera në mendjen e karakterin e fëmijës që po rritej pak nga pak.

Si instrumentist pranë Shtëpisë së Kulturës “Haki Stërmilli” Peshkopë, ka të inçizuar, në Radio Tirana mjaft pjesë instrumentale dhe instrumentalo-vokale. Në vitin e katërt të shkollës pedagogjike ai njihej nga afër me muzikantin Tonin Rota. Këshillohet prej tij që të shkojë për studime në Shkollën e Lartë të Muzikës, që në ato vite quhej Konservator, ndërsa sot, Akademia e Arteve. Për arsye mentaliteti të prindërve, kjo ofertë nuk u realizua.

Shkollën e lartë e kreu në Tiranë, te Fakulteti i Shkencave të Natyrës, me rezultate shumë të larta. Në përfundim të saj, në ceremoninë e shpërndarjes së diplomave, e cila organizohej çdo fundviti, Hajdari bënte pjesë në grupin e studentëve të cilësuar, më të mirët e fakultetit, në atë vit akademik. Për këto arsye, Fakulteti i Shkencave të Natyrës e pati kërkuar profesor Hajdarin, disa vite rresht, për të punuar si pedagog pranë kësaj katedre. Për arsye të ndryshme, për kulisa e prapaskena, që nuk kanë munguar në asnjë kohë, kjo ide e mundësi asnjëherë nuk gjeti zbatim në praktikë.

Pas mbarimit të shkollës së lartë, fillon punë si mësues në shkollën e mesme Maqëllarë (5 janar 1973). Pas dy vite pune, Hajdari emëro-

Pesë anëtarë të familjes Poliçi, pesë intelektualë të përkushtuar



het drejtor i shkollës së mesme Maqëllarë, detyrë të cilën e kreu për 15 vite radhazi (shtator 1975 - qershor 1990).

MBRESA E KUIJTIME NE KËTO VITE

Ishin vite të vështirë. Të vështirë për mësues, por dhe për nxënës. Ndërtesa në të cilën zhvillonte mësim shkolla e mesme ishte një shtëpi private, e konfiskuar nga regjimi i asaj kohe. Objekti ishte dykatësh, por i papërshtatshëm për shkollë. Sallone të ngushtë, dhomat ku zhvillohej mësimi ishin të vogla, shkallë prej dërrase që bënin shumë zhurmë në ngjitje e zbritje. Kjo, edhe për arsye konsumimi nga vitet e ndërtimit e, megjithëkëtë, nga kujdesi që tregohesh si nga nxënësit, ashtu dhe nga mësuesit, shkolla mbahej mirë.

Thuhet që dibranët janë arsimdashës. Këtë cilësi profesor Hajdari e gjeti të mëshiruar në

nxorën një plejadë nxënësish të shkëlqyer, që u bënë kuadro me vlera në degë të ndryshme të ekonomisë. Kam pasur fatin e privilegjim, që një prej tyre të jem dhe unë, shkruesi i këtyre rreshtave për profesorin dhe drejtorin tim të asaj kohe, Hajdar Poliçin.

Shkolla, shumë shpejt u mbush me kabinete mësimore, si ai i letërsisë me bibliotekën me të gjithë treguesit e kohës, i historisë, i kimisë, i fizikës. Për lëndët e fizikës dhe kimisë ishin ngritur dhe ambiente me laboratorë. Kishte dhe kabinete për lëndët profesionale, si ai i bimëve të arave, mekanikës, mbrojtjes së bimëve, zooteknisë, salla sportive etj. Shkolla e mesme Maqëllarë tashme jo vetëm në formë, por edhe në përmbajtje e nivel njohurish, konkurronte me shkollat më të mira të rrethit e pse jo dhe të Republikës. Si model dhe pikë referimi ishte shkolla “Nazmi Rushiti” Peshkopë, e cila ishte cilësuar një nga tri shkollat më të suksesshme të Republikës.

Në një vit mësimor, në provimin e Shtetit (queshin atëherë provimet e klasës përmbyllëse të shkollës së mesme) për lëndën “Bimë arash”, rastësisht vjen nënkryetari i Komitetit Ekzekutiv të atyre viteve, Fatmir Çomo. Ai nuk dëgjon vetëm një nxënës të përgjigjej, por disa prej tyre, radhazi. Fatmiri kishte mbaruar degën Agronomi. Ngelet i habitur nga përgjigjet dhe e merr si shembull për mirë shkollën tonë në Komitetin Ekzekutiv të asaj kohe.

Gjatë shumë viteve, në shkollën që drejtonte profesor Hajdari, ka pasur nxënës të shkëlqyer. Vehap Aga, në olimpiadën e matematikës zuri vendin e tretë në shkallë Republike. Po kështu, nxënësja Dhurata Elezi në olimpiadën e letërsisë, zuri vendin e parë në shkallë rrethi dhe vendin e tretë në shkallë republike. Pas semestrit të parë të provimeve në shkollat e larta, pranë kësaj shkolle do të vinin çdo vit fletë falenderimi për cilësinë e nxënësve që

dhëna, janë vetëm maja e ajsbergut, të punës së tij plot pasion e përkushtim.

Ndoshta ky rrugëtim i gjatë i profesor Hajdarit nuk do të kishte qenë aq i suksesshëm pa ndihmën e një personi tjetër, që e takoi në Maqëllarë dhe u bë pjesë integrale e jetës së tij. Ajo ishte Flora Kosiqi, bashkëshortja e tij. Një nxënëse e shkëlqyer në të gjitha nivelet e shkollimit. Kur ajo ishte nxënëse në shkollën e mesme Maqëllarë, ekipi i volejbollit të Maqëllarës përfaqësonte rrethin Dibër në takime të ndryshme kombëtare të volejbollit. Flora ishte pjesë e skuadrës së parë të këtij ekipi. Pasi mbaron shkollën e lartë me rezultate shumë të mira, duke qenë pjesë e listës “Krenaria e Universitetit”, emërohet mësuese e bio-kimisë pranë shkollës së mesme Maqëllarë. Flora kështu hap siparin e punësimit të nxënësve, që do të mbaronin shkollën e mesme Maqellare e, pasi mbaronin shkëlqyeshëm shkollën e lartë, do të vinin të punonin si mësues në këtë shkollë. Me lëvizjen e Hajdarit në Peshkopë, Flora transferohet si mësuese kimie në shkollën “Demir Gashi” Peshkopë.

Shumë shpejt, në Peshkopë, Flora do të dallohej si mësuese pasionante dhe me nivel të lartë përgjegjshmërie. Për punën e saj shumë të mirë, Këshilli Bashkiak i qytetit e nderon me titullin “Nderi i Qytetit”. Në vitet 2010 e më pas, Flora drejtoi shkollën 9 vjeçare “Selim Alliu” si zv.drejtoreshë dhe atë “Demir Gashi” si drejtoreshë, nga ku doli dhe në pension. Krahas punës së shtetit, Flora ka pasur një përkujdesje shumë të madhe për familjen e fëmijët e saj.

FËMIJËT , LULET E JETËS

Çifti i profesorëve Poliçi kanë tre fëmijë, një djalë e dy vajza. Djali, Alfredi, fëmija më i madh, pasi mbaroi gjimnazin Peshkopë, shkoi me studime në Universitetin e Peruxhas, Itali, dega Farmaci. Pasi mbaroi shkollën, Alfredi



kulturën e kësaj zone. Shkolla kishte pak vite që ishte hapur. Në vitin 1968, si shkollë pa shkëputje nga puna, profili agronomi e më pas, në vitin 1969 gjimnazi me shkëputje nga puna, ndaj dhe numri i nxënësve ishte i vogël. Por nga dëshira për arsimim, shumë shpejt, shkolla u mbush jashtë kapaciteteve të saj, pra, me shumë nxënës. Çdo vit shkolla rritej si nga ana sasiore, ashtu edhe nga ajo cilësore. Këto tregues detyrojnë organet e pushtetit në rreth që të ndërtohej një objekt i ri shkollor (sot shkolla 9-vjeçare Maqëllarë).

Mësuesit e shkollës filluan të shpërfaqin pasionin e tyre, por dhe aftësitë profesionale, pse jo dhe talentin e tyre si më mirë. Shefki Shehu, Sabri Vraniçi, Hamza Spahiu, Lutfi Manjani, Gëzim Hoxha, Rexhep Shahini, Sulejman Kata kishin vite dhe eksperiencë mbi supe. Esat Bunguri, Xhevdet Stafa, Demir Osmani, Xhevahir Hoxha, Bexhet Aga e shumë të tjerë, ca më të rinj se të parët, kishin forcën e dinamizmin, përkushtimin e dëshirën për t’u shkuar deri në fund gjërave të mira. Pasi mbaronin mësimin, ata luanin futboll, basketboll, volejboll, shah e ping pong, bashkë me nxënësit e tyre, si një ansambël, që funksionon më së miri.

Ashtu, bashkë, në mendim e veprim, ata

ne dërgonim në ato universitete, sidomos në Korçë.

Në vitin 1991, pas plot 15 vite pune si drejtor i shkollës së mesme, profesor Hajdari, transferohet si inspektor në Seksionin e Arsimimit. Një vit më pas u organizuan drejtoritë arsimore. Në këtë institucion punoi me ndërprerje, rreth 11 vjet. Në periudhën e parë si përgjegjës i Sektorit të Kontroll - Kualifikimit e në periudhën e dytë si përgjegjës i Sektorit të Kurrikulës e Cilësisë, pozicion në të cilin del në pension. Në Peshkopë punoi dhe në disa pozicione të tjera, si drejtor i Gjimnazit “Seid Najdeni, si përgjegjës zyre pranë institucionit të Prefektit Dibër, por edhe si mësues në shkollën pedagogjike Peshkopë. Në këto vite të shumta të punës së tij, siç ka pasur telashe e zhgënjime, nuk kanë munguar dhe vlerësimet e shumta. Dy herë ka marrë titullin si “Mësues i dalluar”, kurse me Urdhrin “Naim Frashëri”, është dekoruar kur ishte drejtor i shkollës së mesme Maqëllarë. Është vlerësuar nga këshilli bashkiak si “Nderi i Arsimit” për qytetin e Peshkopisë. Profesor Hajdari drejton prej vitesh shoqatën “Blini”, në aktivitete të ndryshme pastrimi, higjienizimi e ndërgjegjësimi të popullatës. Këto janë shumë pak të



punësohet si farmacist në Peruxha, punë të cilën e vazhdon edhe sot.

Vajza, Prunela, mbaroi gjimnazin Peshkopë dhe më pas edhe ajo shkoi te vëllai në Universitetin e Peruxhas, në degën Stomatologji. Prunela, pasi mbaroi shkollën me rezultate maksimale, vjen në Shqipëri dhe punësohet pranë Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mire” Tiranë. Gjatë kohës që punon pranë këtij Universiteti, Prunela ka bërë specializim të nivelit Master pranë Universitetit Tovergato në Romë, ndërsa në vitin 2019, po pranë Universitetit Tovergato - Romë, mbrojti doktoraturën në specialitetin Odontoiatri.

Vajza e vogël, Ariola, pasi mbaroi gjimnazin në Peshkopë, shkoi për studime në Universitetin e Mjekësisë në Tiranë. Për ca kohë punoi si mjeke e përgjithshme në spitalin Maqëllarë. Aktualisht, vazhdon specializimin si mjeke në gastro- enterologji pranë Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mire” Tiranë.

Familja e nderuar Poliçi endet si një anije në detin e jetës. Ajo lëviz mes Peshkopisë, Tiranës e Italisë, e më të rrallë zbret deri në Katundin e Ri të Luznisë, ku i ka dhe rrënjët e vjetra. Pesë anëtarë të familjes, pesë intelektualë të shquar, pesë yje, apo një yll me pesë cepa...

HISTORI E VËRTETË NGA ARTAN GJ. HASANI

Kënga e mjekut



Në foto: Doktor Rahim Gjika, të cilit i kushtohet "Kënga e mjekut", kompozuar nga Agim Prodanit dhe e kënduar nga Anita Take

Në marsin e vitit 1963 Anita Take po luftonte me vdekjen, ndërsa përpiqej të sillte në jetë fëmijën e saj ta parë. Pacientja ndiqej nga profesor Gliozheni, por meqë ai ishte tepër i zënë me pacientet e shumte, për yllin e këngës shqiptare u kujdes një mjek i ri specialist nga Peshkopia që quhej Rahim Gjika që më vonë u bë një nga ikonat e gjinekologjisë shqiptare.

Kishte një arsye specifike për këtë "rastësi". Profesor Gliozheni preferonte që shtatëzanitë e komplikuar të zgjidheshin me operacion. Mjeku i ri, përkundrazi, preferonte lindjen natyrale, sado e vështirë të ishte kjo, gjë me të cilën ishte dakord edhe vete pacientja.

Por, kishte edhe një rrethanë tjetër. Njohja e mëparshme mes mjekut të ri Rahim Gjika dhe Agim Prodanit. "Shpirtërat e mëdhenj takohen", thotë shprehja e famshme greke. Muzika dhe mjekësia kanë shkuar bashkë që nga agji i njerëzimit. Në Greqinë antike, ndërsa gratë lindnin, në dhomën pranë luhej muzikë me harpë. Mjeku i ri dibran ishte adhures i lojës magjike të Agim Prodanit në fizarmonikë dhe disa muaj më parë kishte marrë edhe disa orë mësimi fizarmonike nga mjeshtri.

Natë e ditë te koka e pacientes së tij të famshme, që po përjetonte një lindje tepër të vështirë me rrezikun e jetës për veten dhe beben që kishte në bark.

Fati e solli që djali i çiftit të artistëve të vinte në jetë në duart e mjekut të ri dibran.

Në fëmijërinë time mbaj mend që sa herë jepej kjo këngë në radio, prindërit thonin: "Kënga për Doktor Rahimin". Imë më, që ishte për dhjetra vjet krahë i djathtë në sallë të lindjes i doktor Rahimit, (ish shokë klase në shkollën mjekësore dhe miq të afërt të familjes), tregonte për këtë rast fjalët e Agim Prodanit drejtuar doktor Gjikës:

"Doktor Rahimi, "Kënga e Mjekut" të është kushtuar ty në shenjë mirënjohjeje për atë sakrificë disa mujore tënden të koka e Anitës, që përfundoi me lindje normale dhe shpëtuan të dy jetët. Është dhurata më e vogël që

mund të të bëja. Por nuk mund ta bëj publik këtë dedikim, për arsye se do të ndjehej keq profesor Gliozheni, dhe ku i dihet, mund të na dalë ndonjë telash në këto momente të vështira që po kalon im vëlla."

Një detaj kuptimplotë: Në versionin e parë të transmetuar në radio kënga titullohej "Kënga e mjekut të ri".

Profesor Gliozheni ishte koka e gjinekologjisë shqiptare në atë epokë. Një figurë absolute, plot autoritet, të cilin e donte shumë populli dhe e vlerësonte akoma më shumë hierarkia e lartë e diktaturës.

Nga ana tjetër, në atë periudhë i vëllai i Agim Prodanit, Mediu, i konsideruar babai i kitarës klasike shqiptare, ishte flakur në rrugë dhe po i nënshtrohej persekucionit nga diktatura dhe pak vite më vonë përfundoi në burg.


Por ka edhe një burim tjetër për autencitetin e kësaj historie. Ja si e tregon kompozitori Përparim Tomçini:

"Andej nga vitet 2005-2006, takova rastësisht në studion e këngëtarit Ilir Shaqiri në Prishtinë, këngëtares Anita Take (e shoqja e kompozitorit Agim Prodanit). Pasi Iliri na bëri prezantimet e çastit, Anita m'u drejtua mua: "Nga Peshkopia?" "Po", i them unë. "Ne kemi një mik të familjes në Peshkopë dhe quhet Rahim Gjika. Unë kam patur probleme me lindjet e fëmijëve të mi, dhe doktor Rahimi ishte ai që m'i bëri lindjet e fëmijëve normale. Nisur nga ky fakt, burri im "Këngën e Mjekut" ia ka kushtuar Rahim Gjikës."

* * *

Është e natyrshme që kjo histori të përvetësohet edhe nga të tjerë mjekë apo specialistë, apo t'u mvishet atyre që kanë shërbyer pranë këngëtares së famshme në ato momente dhe unë nuk dua të paragjykoj asnjërin në të vërtetat e veta.

E kush nuk do të donte t'i kushtohej një këngë e tillë, më e bukura e shkruar ndonjëherë për një mjek?! Ndoshta, kantautori Kujtim Prodanit, mund të dijë diçka më shumë e më afër të vërtetës, meqë bëhet fjalë për një këngë që lidhet shpirtërisht me ardhjen e tij në jetë.



NJË POEMË E MADHE PËR TË VOGLËN TIME

1
kujtime të paharruar, harruar pa u ndërruar
si fletët e kalendarëve në hotele të dorës së dytë
ku serviren kokteile turbullues poetësh
në ditë të mbushura me të qeshura të bujshme
dhe netë tropikale me lotë të nxehtë
kur ti ndjeheshe Marianne dhe më quaje Leonard
pak kohë para se të bëhesha Neruda yt...

2
kemi dashur gjithnjë të fluturojmë, e dashur,
dhe nuk kemi bërë ndonjë mëkat
e vështirë të mbetesh me këmbë mbi tokë
kur ndjehesh re dhe të thërrasin qiejt
me zërin prej shiu dhe Chardonay
derdhur bujarisht mbi ne të dy
nga Perënditë takikardike të Fundjavës
e vogël sa një avion dyvendësh ëndrra jonë
dhe gjumi aeroport për njerëz me flatra
ndaj dhe ti pranë meje nuk ecje, por fluturoje,
qeshje aq fort sa orenditë e shpirtit dridheshin
tingëllonin qelqet dhe gëzimi derdhej si vera
nga gotat e servirura në trenat e shpejtë
e mban mend?
Të mbaja për dore si fëmija balonën
ah...epik ky mall, rapsodi humnerash kënduar në heshtje
madhështor si përqaftimi kur vjen nga krahë avionësh...

3
ato shtretër fluturues të 1001 bujtinave
ku marrin shpirt trupat tanë të zhveshur
janë Hiroshima jonë prej mishi, e dashur,
destinuar për bomba anatomike
hedhur nga sytë me parashuta njëpërdorimshe
vështrimesh tunduese arratisur nga ëndrrat
për të rënë mbi duar të vogla e të buta
që i vendosnin me puthje mbi buzë të paduruar
të nxehta gjuhët si kometa të çmëndura
me gjak trëndafilash përflakin qiellzën
qumësht dëshirash të djersitura derdh gjiri
në gojën time kriminale prej fëmije të parruar...

4
kish ardhur fundi i botës dhe jetonim veç ne
ishin kohë lirike të mbarsura me art dhe tinguj
kur Klimtë pasionantë mbyllnin buzët tona
dhe në shtrat rrinim si dashnorët në ekstazë
dalë nga vizatimet e paturpshme të Schiele-s
zhveshur nga petalet e Van Gogut
kridheshim lakuriq në Valsin e Trëndafilave
në atë dhomë që pas pak minutash ngjasonte
herë me një boudoir parisien ku hiret Baudelaire
me epshin tim shuante flakën e hireve të tua
dhe herë me Operan e Vienës vizatuar në qiell...

5
jemi bërë një dhe nuk dimë më kush jemi
kush shkruan këto vargje dhe për kë
ajo dritë në sytë nuk është muzg, por ag
dhe ti, bijë e mallit dhe zemra ime...

(Marrë nga vëllimi poetik ID, botimet M&B, Tiranë 2018)

Poezi nga Agron Tufa

BALADË

Kjo kullë e grymët në fund të katundit,
Tepara nisi vashat, mandej djalit e fundit.

Me mote nëpër botë, ku tek e tek, ku dyshe,
U kthyen vajzat shndërruar dallëndyshe.

Mandej kthyen djemtë tek e tek e trumba,
Shndërruar dhe ata në tufa me pëllumba.

Mbyllur gjetën kullën. Prindërit - në varreza.
Qark mureve në muzg vërtitëshin bukureza.

Të hynin s'iu desh, se s'kishte frymë njeriu,
Se shpirtrat e të vdekurve kuptohen vetvetiu,

Andaj zunë të sillen rreth kullës palë-palë,
Dallëndyshe e pëllumba si njerëz të gjallë;

Me çvit-çvit, gugatje si motit ndër shpërgenj,
I pritën nanë e babë - dy garguj të mëdhenj.

Rreth kullës, trumbë, kundrohen në mëhallë:
I vdekuri me të vdekurin, i gjalli me të gjallë.

18. 04. 2020

DASHTË ZOTI...

dashtë Zoti që prekjet e mia
të kenë hedhur rrënjë prore
në materien tënde trupore;
prekjet e mia - farëra kokëforta -
durojnë dimërime të gjata, -
baromina që çajnë
shkëmbin në mijëra plasaritje
për ta zhbërë rërë,
rërë sedentare.

fryma ime që të rrahu fytyrën
mbijetoftë në porët e tua
derisa t'i herrë, zvetënojë
të gjitha kujtimet e tjera -
ato bimësi parazite
që fiksohen pa rrënjë
pas gjërave të forta.

dashtë Zoti, që tingulli i prajtë
i zërit tim
të zhavarisë zhurmajtat,
që ploja e kohës derdhi
në hinkën e veshëve të tu,
duke ta prishë ritmin e gjakut
dhe ashtu,
e pastruar nga kjo barrë barbare,
të rilindësh si Afërditë
nga shkuma e muzikës së parë.

dashtë Zoti, që e kafta e syve të mi
ta fshijë njëherë e mirë
kromatikën e kurmeve që ke njohur
tek shkrihesh,
tek tretesh
njësh me nuancën
ku ç'prej zanafille dallove veteveten.

dashtë Zoti, që zjarri i trupit tim,
si në një rit të shenjtë të purifikojë
gjithë ngrohtësitë e rreme,
të sëmura
që t'u shitën nën dorë
me premtimin dinak

të një lulnimi të vërtetë.

jo! do jetë puthja ime ajo që do t'i zhbëjë,
do t'i fshijë
të gjitha iluzionet
e qytetërimeve parazite
mbi truallin e dobët të keqkuptimit tënd.

dhe atëherë
gjithçka e parëlindur
do marrë udhën e vet të divnimit
me bujën,
harlisjen,
shpërthimin
e një stine si në kohën e parë të Krijimit.

ne jemi misteri i vetëm në univers
për ekzistencën mistike të llojit...

Nga "Zonja asnjëri dhe zoti askurrkush", Onufri, 2019

MORTHI I MARJANTHIT

(eksperimentale)

Marianthin e zë morthi, andaj hidhet hopthi;
herë hopthi, herë lingthi,
mandej pupthi, vrikthi,
derisa shqimthi, pulson prajthi fikthi.
Fikthi vetëtimthi vate-vjen për fytyrë...
Marianthi rrëshqanthi kapet për divanthe.
Kapur për divanthe, çfarë po dron Marianthi?
Mos po e zë ankthi? Mos e gllab'ron makthi?
Ja pra se çfarë kurthi: turthi e mbyt urthi!
Djegthi e tërbimthi, urthi, përvëlimthi

JOSIF BRODSKU

Mbrëmje dimri në Jaltë

Një fytyrë e thatë levantine
me linë e fshehur përnën basetë.
Kur kërkon cigaren në paqetë,
e bjerrë unaza, pa shkëlqime -
Papritmas shkrepëtin në dyqind vat,
po lentja ime shkrepjen s'e duron:
kapsallitem; mandej fill ia pat,
gjithë tym duke gëlltitë, "pardon".

Janar në Krime. Në breg të Detit t'Zi
dimri vjen pothuaj për gallatë.
Dëbora s'ia del të mbajë gjatë
mbi tehet e agavës pa u shkri'.
Të shkreta restaurantet. Në ranishtë
ihtiozaurëve-zhul u del tymi.
Gjethesh vjen i kalbur kundërmimi.
"T'ju shti nga kjo ndyrësi?" "Sigurisht"

Kështu - buzagaz, muzgje, broke.
Bufetieri tej, tek shmang me duar,
shpërhap rrathë, si një delfin i ri,
rreth flugës plot gjindje marroke.
Katrë dritareje. Lulet - manushaq.
Flok'boret tej fërfëllojnë furishëm...
Ndalo, o grimëçast! Ti nuk je aq
i bukur, sa ç'je i papërsëritshëm!

Janar 1969

Përktheu nga origjinali: Agron Tufa



e kaplon tërbimthi... Mos do jetë kalimthi?
Ja se si ngrin stopthi! Këmbadoraz lophthi...
Ah, Marja-Marjanthi! Ah, se çfarë variantthi!
Tapthi edhe branthi, ja tek hyn Kleanthi...
Pupu çfarë momentthi?!
Si kaq marramentthi?!
Kleanthi i largthi, zë i merr merenthi
si me e kapë korenthi, si me e nga zekthi;
L'shohet rrokapjekthi, aspak xhentëlmentthi:
s'ka mëshirë i shkretthi: vërtitet fustanthi,
zbulohet Marianthi... Ah, se çfarë të ngjeththi!
Ah, se çfarë të nxehti i përpiu verbthi...!

Ah, se çfarë Marianthi!
Ah, se çfarë Kleanthi!

2011

ELEGJI PËR DRITËN

Ka nisë me u zhburosë drita: çdo rrezë
me pingrimë çan e then qafën si fyell kristali ndër
gurë
ku majmet e panjohuna me bojën e vet.

Si bukë e ardhun, e mbrueme shekave t'errta
drita ka nisë me teptisë.

Dheu asht i lagësht, qielli - i vramë;
fytprëmë dergjen buzë prroni krenja t'paqarta
ushtarësh
kërleshun me rranjë drandofillash.

Gurgullon i çartun hamendjesh
uji i shterrun qyshkur.

Ka nisë me u zhburosë drita,
me u rrëxue përjashtë -
thes i artë me kashtë
prej frëngjive picirake t'ksollës.

Me mendje ngarend dhe e prek,
ngarend dhe e prek,
e puth me buzët me bojë
kambanën në ag.

Tue qa me gjys ngashrime falem:
"Lavde, Zotynë, për dritën
që na e ep ma të madhe se Ndriçuesin!"

E dallgë mbas dallge, dallgë mbas dallge
tue e lpi si kurmin e Afërditës
e shtyn terrin me fshesë
deri kur drita kapet për majë.

Nga "Fragmentet e Gjësë", OM, Prishtinë, 2012

TREGIM NGA RAMIZ GJINI

Rrëfimi i bariut

Unë e di, o Bajazit vëllai, se nuk do të di ta shkruaj këtë histori, sepse nuk jam asi kalemxhiu me shkollë. Po meqenëse ti je larg e m'u lute që të ta kallzoja me të shkruar, po e provoj një herë. Të dalë ku të dalë! Veç, të lutem, o Bajazit, nëse nuk ia dal dot mbanë ta kërrell ashtu si duhet, mos më tall, mos më qesh e mos ia jep askujt ta lexojë. Po e bëj meqë ti tani je larg e të ka pik malli për atë kohë vigjilence, për kooperativën, katundin, stallat, bokat, zabelet, bërrakat e rrafshet ku kullosnim bashkë tufat me berrat e kooperativës. Pra, meqë ta ka qejfi të ta rrëfej me të shkruar, unë po e shkruaj, po siç të thashë, pash Zotin, në besën tande, vetëm unë e ti, dhe asnjë tjetër!

A të kujtohet Përroi i Xhetës, ku verës e ndalnim ujin me gurë e plisa dhe lanim vapës në hurdhë berrat e kooperativës, që na e binin në majë të hundës duke u hequr rrodhet e rriçnat? Mu aty, o Bajazit e takova atë burrin jabanxhi.

Kisha mbërthyer atë cjamin larosh për brirësh dhe po i hiqja një nga një rriçnat e rrodhet e ngjitura në lesh, kur pashë që bagëtia ia mbathi menjëherë e trembur nga frika.

Aso kohe, ti e di që neve barinjve, pushteti na sugjeronte të tregoheshim vigjilentë. Mund të shkelej kufiri, të hynin diversantë nga jashtë, të na përmbysnin pushtetin tonë popullor e ku di unë çfarë tjetër.

Kur e pashë, o Bajazit vëllai atë burrin të veshur spic, me çantë ushtarake në shpinë, mendja më vajti tek ndonjë i huaj, që kish ardhë prej larg për të çarë ferrën.

Më salutoi njerëzisht e pastaj më pyeti nëse kishte dyqan katundi ynë. Unë i thashë se kishim dyqan ku mund të blije kripë, vaj, sheqer e ç'të të dojë e bardha zemër; dhe ai u duk se u gëzua. Pastaj tha se donte të blinte vetëm një paketë cigare dhe ndoshta, edhe ndonjë gurabie. Bëmë një copë herë muhabet bashkë; më pyeti sa berra kisha gjithësej (a thua se qenë të mijtë), pastaj ec e ec, dhe duke më vështruar si dhëlpër dinake e nxorri fjalën tek posta e kufirit. Dontë të dinte sa ushtarë kishte posta dhe sa larg gjendej ajo prej aty! E nxorri kokën qafiri! - thashë me vete. Të them të drejtën, o Bajazit vëllai, më rrahu zemra në krahanor si trokëllimë mullini. Menjëherë më vajti mendja se më kish zënë kaderri, se më kish rënë në dorë një armik i pushtetit tonë popullor dhe nuk dija ç'të bëja me të. Mendova: po të arrij ta mbërthej këtë edëpsëz, pushteti do më merrte në sy të mirë, do më jepte dekorat të lartë, dhe pse jo, ndoshta edhe mund të më dërgonin të shikoja falas muzeun kombëtar. Por ajo që nuk m'u shqit nga trutë qe, se mund të më bënin skuadërkomandant të brigadës së arave. Merre me mend sa qejf i madh do të ishte, sikur unë, o Bajazit vëllai, nga bari dhishë, tu jepja urdhër grave të Bibollit! Ti bija çangës së katundit në pikë të mëngjesit, t'i vija gratë në rresht si pulat e t'i urdhëroja. Eh, more Bajazit vëllai! Feja vetë do të ishte! Vetëm njëherë të kisha mbërritur të jepja urdhëra në jetë dhe le të vdisja. Pastaj të hakmerresha me atë bullicën e Bexhetit, që sa herë më shikon, për t'u tallur me mua, qesh e më pyet:

"A i kullote berrat, o berr i allahut?"

Unë e di që ajo më tall pse zoti më la gjithmonë me berra, pse nuk pata fat të marthohem, të marr ndonjë nuse si gjithë të tjerët; a ndoshta më tall edhe pse sa herë e kam hasur, ia kam shti sytë gjigjë dhe e kam shpuar tejpertej. Të kam thanë o Bajazit, veç po nuk e shtiva në dorë, t'ia hyp në ato vithe krekcare, pa do ta mjel për cicash si një lopë Sukthi...

Që ta pata llafin, o Bajazit vëllai, ky jabanxhiu, erdhi me mua gjer në katund. Gjatë gjithë udhës nuk çeli gojë. Vetëm njëherë më kërkoi një cigare, por ti e di që unë e pi duhan gërgjall të keq, madje me të dredhur; dhe ngase nuk dinte ta dridhte vetë edëpsëzi, ia drodha unë një të shtrembër. Pastaj edhe ia ndeza; dhe kur e thithi, pështyu belaziu e tha: - Ky duhan mbytkua edhe gomarin! Athuase unë, që e pija gjithmonë të tillë nga halli e mërzia, isha më keq se një gomar. Nuk i fola. Thashë me vete: e kërkove? Pije tani, ta zëntë gurmazin, ta zëntë!

Për mua nuk kishte pikë dyshimi, madje më qe mbushur mendja top se kisha të bëja me një diversant, por kisha frikë, o Bajazit vëllai, se për aq kohë sa do të më duhej mua të lija berrat në rrugë e të hyja në shtëpi për të marrë pushkën, ai do të kish hyrë në dyqan; e aty, do ta kish bërë zap dyqanxhiu e do ma kish marrë.

Sa lashë berrat në rrugë pranë stallës, ia dhashë vrapit me teftik e drejt në shtëpi.

Nëna ime, që ishte prej dy javësh zaif në shtrat, kur më pa që nxitoja, u tremb e gati i ra të fikët.

- Ç'ka ndodhur, bir?!- pyeti ajo që nga shtrati.

- E gjeta,- thashë unë,- po më duket se do ma marrë ai hundëderri i dyqanit, Baloshi.

- Shyqyr more bir, që më në fund e gjete edhe ti kismetin tënd! - ia bëri ajo sepse kujtoi, që kisha gjetur nuse. Pastaj bëri me gisht si të deshte të më qortonte e shtoi: - A e shef, që ta zgjidhi fatin ajo nuska, që ta shkrova te hoxhë Kupa?!

Nga qejfi i madh, i ranë rrotaqeles trutë në qafë!

U ngrit e me lot në sy deshi të më përqafonte, po nuk e mbajtën këmbët, iu morën mendtë e vajti e u gremis me bythë drejt e në vatër të zjarrit. Fat i madh, o Bajazit, që zjarri nuk qe ndezur se do ish djegur krejt e shkreta. E ngrita shpejt e i thashë:

- Jo nuse moj belazezë! Gjeta diversant, po lermë rehat tani se do ma marrë ai hundëderri! Dhe sa hap e mbyll sytë rrëmbeva gjermanen që e mbaja të varur në një kunj të ngulur në mur, i rrasa fishekun në gojë dhe kur dola jashtë, për bela, sikur ta dija, pashë që diversantin na e kish vënë para me pushkën e vet dyqanxhiu Balosh Losh!

Të them të drejtën, o Bajazit vëllai, më hypën rrebet. Mu terrën sytë dhe nuk dija të dalloja, cili prej tyre qe diversanti, e cili dyqanxhiu.

Vendosa pushkën për syri e brita aq fort sa rrezik e dëgjuan edhe ata shokët e partisë atje lart në komitet:

- Ndaaaaaa!

Ngrinë në vend të dy, dhe unë, duke i parë përmes një reje amzash e kacabujsh të vegjël, i bërtita sërish dyqanxhiut e i thashë që të ikte, të shihte punët e dyqanit me kapistrat e vezët e prishura që shiste hundëderri, sepse ende nuk kishin lindur në Biboll aso bij nanash, që mund të përvetësonin diversantin tim.

Ti nuk do ta besosh o Bajazit, si u ba beterr Baloshi! Deshi të thoshte njëherë, se e kish kapur vetë diversantin, por i iku goja e u ba memec si gur shtufi. Pastaj, bishtin ndër shalë, u përvodh si skile prapa qoshit të murit, theu qafën dhe iku.

Atëherë i fola diversantit; i dhashë urdhër të nxirrte e të hidhte menjëherë në tokë të gjitha armët: bombat, fishekët, pistoletat, thikat, helmet kimike, kutitë me bakterje vdek-jepurëse, të gjitha çfarë mendoja unë se kishte ai në atë çantën e tij ushtarake. Eh, more Bajazit vëllai! Më vrafshin shtatë teqe e më rafshin në kokë rrufetë e qiellit në të gënjej një gjysëm fjale! I kishte ngritur diversanti duart lart dhe më vështronte njëlloj si ai braci fakirfukara kur e kapin duke këputur ndonjë kokërr mollë në kopësht të huaj.

Me urdhërin tim të rreptë, ai nxorri e nisi të hidhte një nga një në tokë të gjitha sendet që kish në çantë. Por, ç'të të them, o Bajazit vëllai?! Nuk kish pasur me vete asnjë lloj arme a municioni qafiri, përveç një broshure me direktivat e pleniumit të tetë të partisë, një faqorje me raki kumbulle, një shami të pisët hundësh si dhe një copë byreku të mbështjellë me gazetë, të cilën, kur kjo histori pat sosur, më duket se e hëngri ajo bullica e Bexhetit. Atëherë mendova se do të kish fshehur ndonjë send në trup dhe i dhashë urdhër të zhvishej, por ja që mbërriti aty kryetari Ibrahim bashkë me Balosh Loshën dhe unë e harrova atë punën e zhveshjes.

Skilja! Kish vajtur me vrap dhe kish lajmëruar kryetarin Ibrahim! I kish thënë se kishte kapur vetë një diversant dhe se ia kisha përvetësuar unë pa të drejtë!


- Për pak u vramë, mor shoku Ibrahim, - thoshte ai i çuditur e i pezmatuar njëherësh, - Dhe për çfarë?! Për një palo-diversant, që në të vërtetë e kapa unë!

Thashë me vete: u bë ky hundëderr te marrë hazërllop diversantin tim?! Unë e solla në Biboll, që nga përroi i Xhetës, kurse ai na e donte hazërllop! Mendoje vetë këtë punë o Bajazit vëllai! Pastaj edhe të na dekorohet nga pushteti popullor, ta çonin të shikonte falas edhe Muzeun Kombëtarë e ku di unë çfarë tjetër...! Kulmi!

Më hypën rrebet në tepe të kresë, mu çue delli, ia futa dyqanxhiut me një grusht hundëve, që Zoti më faltë dhe e plandosa me turinj në një hurdhë uji.

Kur u ngrit, kishte humbur kujtesën zavalli. Nuk dinte as ku gjendej, as çfarë i kish ndodhur. Në vend që të futej në shtëpi të vet, vajti belaziu e u fut në stallën ku mbante deshtë Mud Mahmuti.

U dha berihaja e u mor vesh në mbarë Bibollin se kisha kapur rob një diversant! U dyndën tek sheshi para dyqanit shumë njerëz, mes të cilëve, siç thashë, ndodhej edhe bullica e Bexhetit. Ajo pallavozja u shkri duke qeshur me cicat që i hovnin përpjetë. Qeshte, zgjaste kokën si brace nga unë dhe tinës të tjerëve, duke bërë shenjë me dy gishtat e bashkuar majë më majë, me të tallur thoshte:



- Bravo, o berri i allahut! Na e kape një plesht!

Përse e bënte ajo këtë vetëm një zot e di. Mbase do ta marr vesh kur ta shti në dorë e ta mjel për cicash... Sepse e shikoj, që ia ka qejfi, ndryshe nuk do të kruhej me mua në atë farë feje. Ta dish, o Bajazit vëllai: ja kam ba betë! Veç mos ia gjetsha rastin, pa do ta shikojë ajo bullicë kur ta pupëzoj, ta mrruci e ta bëj sa një kakruk...!

Që ta kisha llafin, Latif Kishaveci, (nëse të kujtohet, e patën kapur njëherë duke vjedhur pula në një kotec andej nga mëhalla e Bazallarëve) e lidhi diversantin me litar kacatrup dhe pastaj, të dy bashkë, e ngritëm hopa dhe e futëm në magazinën e plehut kimik. Aty e plandosëm si një thes me pleh mbi një grumbull thasësh bosh.

Kryetari Ibrahim nisi menjëherë për tek posta e kufirit Latif Kishavecin, që të vinin e ta merrnin. Besomë mua, o Bajazit: ta rrahësh me shkop gjithë Bibollin, nuk gjendet njeri më këmbëshpejtë se ai!

Nuk vonoi shumë dhe ia behu kapterr Meleqi, ai qefliu, që zbriste nganjëherë këtë nga Bibolli për të kullotur sytë mbi vajzat si pela herxhele te pashalua e që binte erë livanto dhjetë litarë kali larg. Rëndë-rëndë, si një pasha, athua se ish veç ai dhe nuk kish më kapterrë të tjerë në faqe të dheut! Kishte marrë me vete edhe një katër ushtarë kopili. Atëherë puna mori krejt ndryshe. Kapterr Meleqi sa e pa diversantin, uli pakëz kokën dhe më vështroi vëngër, athua se unë, dija sekretin që gruaja e tij, kishte një nishan në prapnicë.

I tha kryetarit Ibrahim:

- Ma hiq sysh këtë budall të shkatërruar.

Përse isha unë budalla i shkatërruar, këtë nuk e mora vesh! Madje edhe kryetari Ibrahim m'u duk se nuk e mori vesh, sepse nuk bëzani. Kapterr Meleqi, si ta kishte kurdisur vetë dreqi, më shau zavalli me rroc e koc e ma futi me shkelm bythëve; e unë për pak u rrëzova për të thyer qafën para gjithë atij mileti. Pastaj, u afrua pranë diversantit, e nderoi me grushtin lart dhe nisi ta zgjidhte!

Por çfarë thashë unë, o Bajazit vëllai?!

Diversantin, thashe?! Jo, jo! Ai zgjidhi komandantin e ri të postës së kufirit, i cili me ta marrë veten, rreshtoi ushtarët bashkë me katundarët; e tha se këtë lojë, na e paska pas kurdisur rrengëçorri, sepse kish dashur të vinte, medemek, në provë, gadishmërinë e banorëve të Bibollit!

E marrtë dreqi me gjithë gadishmëri, jarabi!

Mua, sa nuk më luajti tepeleku i kresë! Kurse ajo bullica e Bexhetit u shkri gazit!

Mileti e pat rrethuar komandantin e ri të postës dhe dëgjonte prej tij me shumë vëmendje, do komente, që ai i bënte kësaj loje me fjalë e me duar, duke vënë në dukje disa dobësi dhe të meta të mëdha, që gjasme, na paskësh parë tek unë gjatë gjithë kësaj kohe. Për këtë as nuk më falenderuan, e jo më të më jepnin dekoratë, të më shpinin të shikoja falas Muzeun Kombëtar, apo të më bënin skuadërkomandant të brigadës së arave.

Për Zotin, o Bajazit vëllai, kurnigja nuk më dhanë, në asnjë vend nuk më çuan dhe asnjë nuk më banë!

Ngela si një qen, me shpinën e mbështetur pas murit të magazinës së plehut kimik, me sytë gjithnjë nga bullica e Bexhetit, që bënte me gisht nga unë dhe shkrihej gazit.

Ruspia!

U afrova pranë saj e gjithë inat i thashë:

- Po të shtiva në dorë, moj bullicë, do të t'i shkep të dyja tulet që më ke mes shalëve.

Atëherë, ajo qeshi prapë e tha:

- Ik e kullot berrat, o berr i allahut, se për atë punë je ti!

Edhe sot e asaj dite, mallkoj veten dhe me vjen inat se si ndodhi që më ra mua për hise kjo histori. Veç te lutem, po të porosis edhe njëherë, o Bajazit vëllai: mos ia jep asnjëriu t'i lexojë këto qe shkrova, e pash Zotin, mos ma ban të madhe.

Nga XHAFER MARTINI

Shtylla e katërt që i shton “godinës së vet krijuese” Haziz Ndreut është alegoria. Kështu *kulla* bëhet *me katër qoshe*, siç janë të gjitha kullat. Hazizi qe mbledhës i alegorisë, bartës dhe përdorues i mirë i saj. Bëri disa përpjekje për të qenë edhe studiues, por pa sukses për shkak të mungesës së shkollës. Por edhe nëse nuk ia arriti asaj që dëshironte më shumë, Hazizi bëri mjaft edhe në këtë kahje. Alegoria e ka çarë rrugën me vështirësi. Trualli ku është bërë debati ka qenë Dibra, ku ajo ndodhet me shumicë dhe ku ka veçori të dallueshme nga alegoria në vendet e tjera. Hazizi ka kontribuar për njohjen e saj vetëm me përpjekjet që ka bërë, jo me rezultatet që ka arritur. Rezultate nuk pati. Por kështu e ka suksesi. Nuk vjen menjëherë. Nuk duhen harruar pionierët që e nisin një punë, por e vazhdojnë të tjerët. Haziz Ndreu ka qenë pionieri i alegorisë. Unë jam dishepulli i tij.

Alegoria nuk ishte thjesht çështje letrare, çështje arti apo shkence. Ishte edhe çështje shtetërore. Të paktën, kështu është trajtuar në fillim. Është trajtuar si e tillë në nivel lokal, por udhëzimet kanë ardhur nga qendra. Diktatura donte ta mbante larg këtë lloj arti. Nuk donte të flitej për të dhe për shumë vjet ajo u rrethua me heshtje. Hazizi që i pari që e nxori alegorinë nga strofka ku rrinte e ndrydhur dhe e vuri në një sofër me artet e tjera dhe me kulturën tjetër të popullit. Alegoria nuk u pranua në këtë sofër. Kjo ka ndodhur në vitet shtatëdhjetë, kur në Peshkopi u mbajt një sesion shkencor për problemet e historisë dhe të kulturës së popullit. Trajtesën e shkurtër për alegorinë e mbajti Haziz Ndreu. Ishte një trajtim i thjeshtë i kësaj “mënyre të foluri”, siç e prezantoi ai alegorinë. Trajtesa ishte pa nivel. Por ajo nuk u hodh poshtë për këtë arsye. Alegoria u kundërshtua si e tillë, u konsiderua si muhabet odash me spica dhe kunja, krejt i papërshtashëm dhe i panevojshëm për kulturën socialiste që është e hapur dhe e singertë dhe në funksion të idealeve komuniste. I pari kundër saj foli sekretari i parë, pastaj dhe ato që e pasuan. Hazizi vetë dhe ata që e kishin futur temën për alegorinë në programin e konferencës, nuk e mbrojtën atë. Hazizi kishte thënë aq sa kishte ditur, të tjerët nuk patën guxim, por ata edhe nuk kishin ç’të thonin më shumë. Partia ku i lartë dukej i revoltuar jo vetëm si partiak, por edhe si jodibran. Ishte i vetmi sekretar i parë që nuk e donte Hazizin. Motivet nuk i di, por siç u kuptua atë ditë kur ai e nxori mllefin, kjo kishte të bëjë edhe me faktin që ai Hazizin e quante njeri të *kunjave dhe të spicave*. Kumtesa e Hazizit në të vërtetë duhej kritikuar, por për tjetër gjë: ajo nuk kishte thellësi mendimi; u krijua përshtypja sikur alegoria ishte një dialekt, brenda dialektit, shkurt, nuk u tha asgjë specifike e këtij lloj arti. Më poshtë ne do ta shikojmë se sa e ndërlikuar është alegoria, sa shumë dituri dhe angazhim kërkon zbërthimi i saj. Aq sa kishte shkruar Hazizi në tre-katër faqe ishte e pamjaftueshme. Sekretari i parë e kritikoi alegorinë si të ishte e Hazizit, por ajo në të vërtetë ishte e popullit. Në atë kohë dhe gjatë gjithë viteve që zgjati diktatura, në qytetin e Peshkopisë kishte shumë të huaj, me kuptimin jodibranë. Dibranët kanë një të metë shumë të madhe: e respektojnë shumë të huajin dhe e shtynjë shumë të vetin. Të huajt përgjithësisht ishin nga Jugu dhe ishin me detyra të rëndësishme, kryesisht në sigurim, në ushtri, por edhe drejtues të institucioneve dhe ndërmarrjeve, madje edhe sekretarë të parë. Pothuaj të gjithë sekretarët e parë në Dibër kanë qenë jodibranë. Jodibranët kanë ardhur në Dibër me një gjel rraqe dhe janë larguar prej saj me makina me rimorkio. Kanë shirë në Dibër si kali në lëmë, por pa u lodhur si kali. Por këto nuk janë objekt i këtij libri. Kam shumë për të shfryrë, por nuk dua ta bëj nëpërmjet Hazizit. Për Hazizin nuk duhet të shkruhet një libër *mistrec*. Ishte burrë dhe duhet shkruar si për një burrë. Le të shkojmë te problemi: jodibranët nuk e kishin qejf “muhabetin me shifra”, siç e quante populli alegorinë, se kishin frikë se viheshin në lojë nga populli i zgjuar i Dibrës. Kjo u pa në reagimin e sekretarit të parë që edhe ai nuk qe dibran. Por këtë nuk ndikoi vetëm të qenurit e sekretarit të parë jodibran. Do të ishim të cekët po të mendonim se kjo qe arsyeja. Ishte një ndër arsyet, por jo kryesorja. Punët ishin më të thella. Njerëzit kryesorë të asaj partie edhe kur nuk ishin mendimtarë (të tillë kishte fare pak), kishin intuitë klasore. Ata nuk e donin alegorinë se me intuitë e shikonin që nuk ishte një art që vihej në

Haziz Ndreu, mjeshtri i alegorisë



HAZIZ NDREU, KRIJIMTARIA, PERSONALITETI

Xhafer Martini

Botimet M&B, 2019

ISBN 978-9928-307-09-5

Faqe 128 / Çmimi: 800 lekë

shërbim të tyre, të elitës, përkundrazi, ishte arti i popullit që mund të vihej vetëm në shërbim të popullit. Nuk ishte pakënaqësia e sekretarit të parë me Hazizin strumbullari i atij reagimi aq të ashpër. Në mes ishte alegoria si art popullor dhe si mbrojtës i vetëm i popullit.

Po kështu, si alegoria, i dënuar me heshtje ishte edhe Kanuni. I vetmi Kanun në atë kohë i njohur në Shqipëri dhe jashtë saj ishte Kanuni i Lekë Dukagjinit. Edhe ai luftohej dhe futej te “mbeturinat e së kaluarës”.

Por diskutimi për alegorinë vazhdoi edhe jashtë mureve të sallës, ku u mbajt konferenca. U përpush mendimi dhe kishte plot prej atyre që e aprovonin. E aprovonin dhe e donin ta afirmonin vetëm pse ashtu u dukej më e drejtë, por nuk sillnin argumente shkencore në mbrojtje të saj. Sidoqoftë, disa muaj më vonë, siç mbaj mend, gazetari i gazetës lokale “Ushtima e maleve”, Sami Milloshi, bëri një artikull pozitiv në këtë gazetë për alegorinë. Ishte një përpjekje pak më ndryshe nga ajo e Hazizit, megjithatë edhe ky mbetej në sipërfaqe të problemit. Flitej për rëndësinë e alegorisë, pa zbuluar se ku qëndronte rëndësia e qaj në të vërtetë. Dikush mund të pyesë: Po ti ku ishe: Në Peshkopi isha, por i mënjauar dhe i i përjashtuar nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve të Shqipërisë.¹⁾

Por nuk ishte kjo arsyeja përse heshta dhe nuk u mora me alegorinë në atë kohë. Ajo duhej studiuar dhe unë iu futa studimit të saj. Zotit Milloshi nuk iu vërsul askush për artikullin që shkroi për alegorinë. Edhe ai ishte i huaj, matjan, ndonëse nga një krahinë fqinje. Më vonë ai do të bëhej korrespondent i “Zërit të Popullit”, për Dibrën dhe Matin dhe, mbas disa vitesh, zëvendëskryeredaktor i kësaj gazete. Por perspektivën e kishte qysh atëherë kur ishte në gazetën lokale. Partiakët dhe pushtetarët e asaj kohe nuk u suleshin atyre që kishin perspektivë për t’u ngjitur. Kishin nuhatje të madhe në këtë drejtim dhe ishin parashikues të aftë. Unë fillova të merrem seriozisht me studimin e alegorisë. Më dha një kënaqësi të veçantë se, sa më shumë avancoja në njohjen e saj, aq më shumë dilnin probleme të reja. Përpjekja për ta afirmuar alegorinë vazhdonte dhe këtë e bëri prapë Haziz Ndreu. Në almanakun “Dibra dhe dibranët”, Peshkopi 1981, u botua një shkrim i shkurtër i Haziz Ndreu për vlerat e alegorisë me titull: “Rreth të folurit alegorik në Dibër”. Ky shkrim nuk ishte më me nivel sesa ai që ngjalli diskutime para dhjetë vjetësh. “Drejtimi i këtij të foluri, - shkruante autori, - dhe në alegorinë dibrane ka një objekt të caktuar dhe qëllimin për t’i shërbyer interesave të klasave të caktuara”. (“Dibra dhe dibranët”, Peshkopi 1981, f. 81).

Kur bëhet fjalë për përdorimin e alegorisë në praktikën jetësore, Haziz Ndreu ishte Njëshi. Me të nuk ka të krahasuar asnjë në Dibër, por as jashtë saj. Po Hazizi ishte Njëshi edhe si mbledhës i alegorisë. Ai ishte Njëshi edhe si vlerësues i saj. Ai ishte si ai gjeologu i mirë që vetëm nga disa vija ose nga disa pika dallon një lloj minerali nga disa vija ose nga disa pika dallon një lloj minerali nga minerali tjetër.

Autori kujtonte se alegoria ishte në shërbim të klasave të caktuara dhe jo në shërbim të popullit, në shërbim të më të vegjëlve, në shërbim të të munduarve dhe të lodhurve, në shërbim të atyre që heqin e vuajnë dhe u kundërvihet pikërisht atyre që i shkaktojnë popullit këto vuajtje. Unë dua të jem i drejtë me Hazizin, ndryshe nuk do t’i përmendja faktet që dëshmojnë se Hazizi e faktorizoi alegorinë. Por duhet thënë se sukses nuk qe ana shkencore e trajtimit të alegorisë, por fakti që kjo trajtesë, pavarësisht nga niveli i saj, u botua në një libër, që kishte një redaksi, ngritur nga komiteti i partisë që ishte marrë me aprovimin e materialeve. Kjo do të thoshte që për alegorinë tani ishte hapur drita jeshile. Këndej e tutje mund të shkruhej edhe për të.

Më vonë Hazizi e kuptoi edhe vetë se përpjekja e tij për ta studiuar alegorinë ishte një dështim. Nuk kishte hyrë kërkund në filozofinë e saj, kishte mbetur në sipërfaqe. Kur ia thashë këtë pa dorashka, ma ktheu: “Ndihmomë të hyjë në thellësi”.

- Or Haziz, - i thashë me një qortim dashamirës, - kjo punë nuk është me të thanme, por me të dhanme. Ty Zoti të ka dhënë shumë talente, këtë nuk ta ka dhënë. Ti ke bërë mjaft për alegorinë. Më kryesorja është se e ke mbledhur. Do të dalin të tjerë për ta studiuar. Punët janë të ndara: disa e mbjellin grurin, ka prej atyre që e korrin, e çojnë në mulli dhe e bluajnë, por të tjerë janë ata që e bëjnë bukë, petulla, byrekë, revani dhe lloj-lloj ëmbëlsirash.

Hazizi e kapte menjëherë figuracionin:

- Demek unë jam nëpunës grumbullimi, unë jam si: - dhe Hazizi dëftonte me emra disa grumbullues që i njihte mirë. – Unë mbledh e ruaj, ti vjen e mbush thesin e shkon...

- Pak a shumë kështu, janë të ndara punët. Studimi i alegorisë është një punë tejet e vështirë... Desha t’i them se studimi i alegorisë i kapërcente mundësitë kulturore dhe arsimore të Hazizit, por përmbahesha se Hazizit i ngelte hatri shpejt.

Hazizi nuk e kuptonte siç duhet ndarjen e punëve, me pak fjalë nuk hynte thellë te specialitetet. Për të, të merresh me folklorin në radhë të parë kishte kuptimin ta mbledhësh. Studimi i folklorit për të ishte një fushë e lehtë që nuk donte një përgatitje të veçantë. Në jetën e Hazizit pati një periudhë të vështirë kur e pezulluan nga puna, siç e kemi bërë të qartë më lart. Po ai kishte plot shokë e miq, që e ndihmonin dhe nuk do ta linin pezull gjatë. Ndonjëri prej tyre, siç duket, i kishte thënë t’ia vinte syrin ndonjë pune që ishte në përshtatje me aftësitë dhe dëshirat e tij. Një ditë më tha:

- Më kanë thënë të gjej një punë. Kam ndërmend të kërkoj mësues në gjimnaz. Si mendon ti?

- Por çfarë lënde mund të japësh ti në gjimnaz?!- e pyeta i habitur.

- Folklor. A bën folklor gjimnazi?

Bën, por folklorin nuk mund ta japësh, or Haziz, - i thashë me singëritet që të mos e bënte atë gafë të kërkonte punë në një shkollë të mesme, kur vetë nuk kishte të rregullt asnjë lloj shkolle. – Folklori është shkencë, nga më të vështirat. Edhe mua më duhet punë për ta dhënë në shkollë; por për ta studiuar, duhet punë e madhe.

Kur bëhet fjalë për përdorimin e alegorisë në praktikën jetësore, Haziz Ndreu ishte Njëshi. Me të nuk ka të krahasuar asnjë në Dibër, por as jashtë

Mars - Prill 2020 - 15

Alegoria cilësore, alegoria “e vërtetë” është jashtëzakonisht e vështirë për t’u deshifruar.

saj. Po Hazizi ishte Njëshi edhe si mbledhës i alegorisë. Ai ishte Njëshi edhe si vlerësues i saj. Ai ishte si ai gjeologu i mirë që vetëm nga disa vija ose nga disa pika dallon një lloj minerali nga minerali tjetër. Për analogji, nëse ne të tjerët thonim *alegori*, Hazizi ishte në gjendje të dallonte çfarë alegorie ishte, duke pasur këtu parasysht cilësinë e saj. Cilësia e alegorisë varet nga shkalla e deshifrimit. Alegoria cilësore, alegoria “e vërtetë” është jashtëzakonisht e vështirë për t’u deshifruar. Hazizi ishte i pajisur me talent dhe intuitë. Në një kuptim, alegoria ishte e odave, një art tamam demokratik dhe popullor, prodhim i një parlamenti elitar. Aty matej forca e fjalës. Dhe forca e fjalës nuk qëndron në të lëshuarit e saj, por në të përmbajturit. Gëte, kur dikush fliste keq për të tjerët në praninë e tij, kushdo goftë ai, ia kthente: “Këtë baltë mos e hidhni në shtëpinë time, çojeni te shtëpitë tuaja”. Në odat dhe kuvendet e Dibrës nuk mund të vrisje dikë me fjalë. Oda nuk ishte si Hani i Bar Kallametit, ku hyn e del kushdo e flet si i do qejfi. Oda që priste e përcillte, ajo që kryente funksionin shoqëror, kishte tre zotër shtëpie: i pari, ishte zoti i shtëpisë që e kishte atë odë të vetën, pronë private, pjesë e shtëpisë së tij, pra, pjesë e nderit familial, e nderit fisnor e më gjerë; së dyti, çdo odë – dhe këtu kam parasysht në radhë të parë odat e parisë, që rrinin përherë të hapura për miq e dashamirë, - kishte një zot shtëpie të dytë, që nuk ishte zoti i shtëpisë, por një prej burrave të fisit, që kujdesej për kafe e duhan, për dreka e për darka, për mënyrën e shërbimit, për gatimin, për gjithçka, për shtrimin dhe mbulimin e miqve kur ato bujtnin aty. Ky ishte i përhershëm, zgjedhur nga zoti i shtëpisë. Murat Kaloshi, si shembull, nuk e çante kokën për asgjë, se kishte kush kujdesej për të gjitha këto. Si lodhej ca, tërhiqej dhe shkonte në odën e tij të veçantë. Halil Alia, në atë “mbretërimin” e tij fare të shkurtër kishte si zot shtëpie në konakun e burrave Maliq Përnezhën, i cili merrej me të gjitha; së treti, çdo mexhelis kishte një kryetar mexhelisi, që ishte një prej burrave më të shquar që merrej me menaxhimin e fjalës, me përmbajtjen e saj jo deri në censurë, por që ajo të bëhej e matur, e kujdesshme duke mos cënuar nga pikëpamja morale asnjë prej të pranishmëve. Ky burrë nuk zgjidhej, por “emërohej” sipas përbërjes së mexhelist.

Pra, një odë burrash nuk ishte një merà ku mund të kullo tësh si të duash e sa të duash, por një institucion fort mirë i rregulluar në të gjitha aspektet. Hazizi jo vetëm nuk stononte në asnjë odë, por ishte drita kryesore e saj.

Janë me dhjetëra alegoritë që kanë si promotor kryesor Haziz Ndreun. Po japim disa nga më brilantet që i gjykojmë jo thjesht nga mesazhi që përcjellin, por edhe pse ky mesazh ishte “kundra rrymës”, me çka duhet të kuptojmë se ishte kunj thane për sistemin. Kjo alegori hynte tek alegoria elitare. Të dyja këto alegori i ka përdorur Mane Kacani, një tjetër mjeshtër i alegorisë, por alegoria është si vallja dyshe, që njeri kërcën dhe tjetri e mban. Mbjatësi ka rëndësinë e vet, madje shumë të madhe. Por për të kemi folur më lart. T’i shikojmë konkretisht këto alegori, duke dhënë me vërtetësi mënyrën, kohën dhe rrethanat që i prodhuan:








Ishte festa e 23 gushtit – çlirimi i Peshkopisë, sipas punistëve socialistë, dhe pushtimit të saj, sipas demokratëve e ballisto-zogistëve. Por ky gjykim është i sotëm. Atëherë festa mernte një rëndësi të veçantë. Njerëzit niseshin që me natë edhe nga lokalitetet më të largëta, më këmbë, duke ngrënë edhe pluhurin me të cilin i “pudroste” ndonjë makinë fare e rrallë, me të cilat në përgjithësi udhëtonin kryetarët e kooperativave. Aty nga ora dhjetë Peshkopia gëlonte nga njerëzit që vërdalliseshin si mizat në lis. Peshkopia nuk kishte hapësirë për aq shumë njerëz. Një shesh i vogël para shkollës së mesme bujqësore ishte zënë nga kooperativat që e merrnin drekën me vete për ta shtruar nën hijen e drurëve. Bënin një rrethim mugjullor, vinin kazanat e tepsiat dhe hanin mishin që e kishin pjekur me kohë dhe pinin arkat me birra. Rugët e qytetit mbusheshin plot me njerëz dhe pluhuri nën rrezet e diellit dukej si re rozë që kishte qëndruar në majë të plepave. Tregtia i kishte hapur ato pikat e veta me barraka, njerëzit grumbulloheshin kapicë para tyre, por mbeteshin pa gjë. Ishte vështirë të merrje një copë mish të ftohtë të pjekur ose ndonjë copë djathë.

(vijon numrin e ardhshëm)

16 - Mars - Prill 2020

libra të rinj

Rruga Arbërit nr. 166



BOTIMET M&B

mbbotime@gmail.com
069 20 68 603 / 04 22 33 283

Të gjitha botimet tona mund ti gjeni pranë librarisë sonë në Tiranë në rrugën "Isa Boletini", pranë kryqëzimit të Selvia; rrjetit të librarive "ADRION"; librari "Art's" të Stacioni i Trenit në Tiranë; FletaXXI në Peshkopi ose mund ti porosisni përmes agjencive të shpërndarjes së librit ose online në www.bukinist.al

KËRKOHET GAZETAR

Kërkohen një gazetar me kohë të pjesshme. Detyra kryesore është të shkruajë dhe raportoje për ngjarje që ndodhin në qarkun e Dibrës.

Të interesuarit duhet të kenë pasion gazetarinë.

Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.

Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.

Tel. 069 20 68 603



**Shkozë
Tiranë**

SHITET

1 200 m² katror sipërfaqe e përdorshme për biznes dhe banim.
300 m² lokal, bar kafe dhe restorant, i përshtatshëm për dasma, **100 m²** kuzhina.
4 apartamente, me dy dhoma të mëdha gjumi dhe **2** të tjera me një dhomë.
Restoranti ka katër banjo moderne dhe një dhomë ndërrimi.
Lokali në katin e parë është **200 m²** + magazinë, qilari është **30 m²**.
Bari - **30 m²** brenda dhe **140 m²** ambienti i jashtëm.

Për një vizitë në pronë, kontakto: ☎ 068 65 08 441 ✉ ramizgjini@yahoo.com



www.rrugaearbërit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: info@rrugaearbërit.com

Informacioni për versionin e printuar: rrugaearbërit@gmail.com

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin “**NDIHMO EDHE TI**” që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqipëri në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Ëëbsite është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës “Rruga e Arbërit”, lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

Mund të na ndiqni edhe në Facebook duke kërkuar me emrin “Rruga e Arbërit” ose përmes lidhjes:

<https://tinyurl.com/lcc3e2f>

Foto Majtas tregon pamjen e parë të faqes zyrtare në Facebook të gazetës *Rruga e Arbërit*

REKLAMO BIZNESIN TËND

Një faqe e plotë me ngjyra kushton 15000 lekë

Me 1000 lekë mund të rezervosh një reklamë gjatë gjithë vitit në format kartvizite (8x5cm)

NE jemi gazetë e lirë dhe e pavarur nga ndikimi politik. Pavarësia dhe liria jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...
BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: **600 lekë**. Në Europë: **10 Euro**.
Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Botimi i gazetës është punë vullnetare, ndaj çdo pajtim vjetor ose dhurim, është i mirëpritur. Dhurimet pranohen vetëm përmes llogarisë bankare që gjendet më poshtë dhe për çdo rast ai do të bëhet publik.
Raiffeisen Bank, Rr. Kavajës, Tiranë. Swift code: SGSBALTX. IBAN(ALL): AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

FJALË E FRAZEOLOGJIZMA TË RRALLA

Marrë nga libri “Toponimia e Çidhnës” i autorëve Haki Përnezha dhe Rruzhi Bitri, Botimet M&B, Tiranë, 2016.

FJALË TË RRALLA

M

- **majsk / majsk / mâjsk**: Sapun me erë të mirë, sapun majsk. Nga pers. *mysk*, lloj bime në formë myshku me erë të mirë. Ne besojmë se dhe *myshk* vjen nga i njëjti burim.
- **m'tëj / m'taj / m'tëj; m'tova**: Është e njëjtë me fjalën *zbuloj*. *E m'tova ku e kishte hallin*. Duhet të ketë lidhje burimore me *(ku) mtoj*, prej këndej *(ku)ptoj*, *mtoj*.
- **mar'so / mar'so / mârso**: *Mbarësoj bëj gati, përgatis*⁽²⁹⁹⁾. Në të folmen e vendit fjala *marësoj* përdoret edhe me kuptimin *përgatisë dikë për udhë: ia marsova punët dhe e përcolla*; *Nusja jonë â hazrue / Të gjithë petkat i ka marsue* (pop.).
- **me / mē / mē-ni**: *Mangut. Sadri aga një kacadre / Shtie tepër e i del më* (pop.). Kjo fjalë përdoret edhe si folje, në formën *më-mëni* që janë të njëvlershme me *pushoi, ndaloj: meni shiu, meni kroi*. Ka dhe kuptimin *praj, prani, pushoi: e meni të qamen*.
- **mitajë / mitaja / mitáj'**: *I urtë, i padjallëzuar*. Ndoshta nga *i mitur*, i padjallëzuar si një i mitur, mitajë.
- **mullarth / mułare / mullárth-i**: Quhet kështu një bosht cilindrik druri tek mulliri, mbi të cilin vendosen fletët. *Mullarthi* shërben për të rrotulluar gurin e mullirit.
- **mun'çer / mun'tfer / munçér-i**: *Mundçar*. Përveç sa shënon Çabej për fjalën *mund*⁽³⁰⁰⁾, në të folmen e vendit *munçer* quhet ai njeri që është gjithnjë i gatshëm të japë mundin e vet për të tjerët (djersën, punën). *Munçer* i madh, thuhet për dikë që punon shumë.
- **m'shel' / m'fel / m'shël-at, të**: *Mëshel, mbyll*. Çabej e bashkon me *ngujoj*⁽³⁰¹⁾. *M'shela derën dhe menjëherë u nisa për tek spitali; Ndejtëm gjithë ditën m'shelë*; erdhi shumë herët, çil e *m'shil* mëngjesi; ngujimi - *të m'she-lat* ka qenë mënyrë e vështirë për të jetuar. *Shumë fëmijë janë rrit me t'm'shela*. *Kemi jetue me t'm'shela*. E një burimi me çel, antonim me të: çel, mçel, mshel. Me shumë interes kjo parashtesë funksionale për antonimi.
- **mufo / mufo / mufô-j,-va**: *Mbufat*, fus enën e drurit në ujë që të bashkohen mirë pjesët e saj të drunjta dhe të mos rrjedhë më. *E mufuemja* bëhet duke e shti enën e drurit tre katër-ditë në ujë. Në këtë mënyrë ena e drurit *mufohet* dhe nuk rrjedh lëngjet. Përpara se ena të *mufohet* në ujë, grihen *blлага* dhe i futen me gjiçë kudo ku bashkohen pjesët e drurit.
- **m'xhë / m'dçe / m'xhë**: Shumësi i këtij emri *mxhëjt'*. Quhen kështu trungjet e mëdhenj të drurëve të prerë. Çabej na jep formën

vgjë⁽³⁰²⁾. Erdhën nga dy m'xhë të mëdhenj për Drini.

- **mërcajn' / martsajn' / mērcâ-jn'-a**: *Ngordhësirë*, shkurtim i kësaj fjale në thjeshtligjërime: *ngordhësinë, ngordhsajnë, ngër-sajnë mërcajnë*. Ndoshta e njëjtë me *bercane*⁽³⁰³⁾ te Çabej. Quhet një gjallesë që është shumë e dobët fizikisht. *Hanë bukë e sh-lajjnë/ Bahen si mërcajnë* (pop.).
 - **mrume (e) / ε mrume / mrúme, e**: *E mbrujtun*: kështu quhet buka e misrit e cila zihet me farë (me tharm). Brumi i bukës, pasi i futet tharmi (fara), pritët deri sa të vijë, të tharmohet, ndaj quhet edhe *bukë e ardhme* ose *e mrume (e mbrujtme)*.
 - **miskon (më) / mā miskon / mískon, (më)**. Pickim i lehtë i trupit. Më *miskon* trupit. E njëjtë me *pickon*.
- N-Nj
- **n'rrolle / n'rwë / n'rrólle, n'rróllet**: Fjalë e rrallë në vargjet që shoqërojnë *lojën me kaçokë*: *Taaa bëj një rrolle / Kam veç një t'i bëj dy / Kam veç dy / T'i bëj tri...* Kështu veprohet deri te numri pesë.
 - **nabere/ nabere / nabére**: *Dobare, barem*, të paktën. Në FG-JSSH: *dobare, të paktën*. Çabej sjell formën *bare*⁽³⁰⁴⁾. Nga pers. *درابود*, *dobare*, me kuptim të drejtpërdrejtë përsëri dhe me kuptim të bartur të *paktën*. *Nabere hajde heret* në punë. Edhe në këngët popullore dhe tek bejtexhinjtë: *Barem* në tre-katër muaj.
 - **nare / nare / nâre**: *E hodhi tutje, e flaku larg. I dha nâre*.
 - **norë (e) / ε nora / nór', e**: *E ndorme, e ngjeshur me dorë, e norë*. Njësoj me *e ndorme* te Çabej⁽³⁰⁵⁾, me ndryshimin që të folmet e vendit *bukë e norë* quhet buka që përgatitet me ngjeshje dhe jo me tharm (farë). Hyn në korrelacion me *bukë e mrume, e mbrume* (Koliqi: *Shija e bukës së mbrume, të mbrujtun*).
 - **nugj / nuç / nûgj**: *Nugjet, myket: mos e ven kashtën mullar se është e njomë e do të nugjet; e kishe nugjë kashtën*. Shenjë dalluese se një objekt po *nugjet* është *ndezja*, nxemja e tij.
 - **nefer / nefer / nefër-i**: Nga turq. *nefer, ushtar*. Përdoret me kuptimin *i parëndësishëm*: *Ai, nefer krajpe është*.
 - **nesrit / nesrit / nés'rit**: Njësoj me të *nesërmen*⁽³⁰⁶⁾: *Atë ditë bana të gjitha gjanat gati e nesërit u nisa*. Një formë e çuditshme rrjedhorje, në një ndajfolje të nominativizuar: *nesër* (ndf.), *nesër-mja* (em.) dhe *nesëret, nesërit* më në fund.
 - **nask' / nask' / nâsk'-a**: Grua e sertë, inatçore e hileqare. Zakonisht në njëjës. *Hë ç'është një naskë ajo, veç unë e njoh; Nana e nuses ni turajnaskë / Qaka ba si dele llaçkë* (pop.).

Tregime alegorike nga Shaqir Skarra

Drini i Zi

Sa këngë janë kënduar për Drinin, sa legjenda janë treguar për të! Sa ndodhi dhe ngjarje! Sa urime, por dhe mallkime ka marrë Drini i Zi! Thonë se në kohë të hershme Drini ka qenë thjesht një lumë. Ndoshta nuk ka pasur as emrin që ka sot.

Edhe i zi nuk i thoshin atëherë, se uji i tij nuk është as i zi e as i kuq edhe kur vjen i rrëmbyeshëm. Tek ne ka ardhur në formë legjende dhe ajo tregon se Drinit i mbeti nofka i Zi nga mallkimi i një motre për motrën, që ia rrëmbyen dallgët para syve. Çdo gjë është e lidhur me dashurinë e dy të rinjve, që ishte pikërisht Drini ai që ua përmbysi ëndrrat e gjithçka. Përmbysi dashurinë e saponisur mes dy të rinjve.

* * *

Maria, vajza më e madhe e Nik Perës në fshatin Gjurras ishte rritur dhe zbukuruar mjaft. Ishte bërë për martesë, por hë sot, hë nesër, fati nuk i kishte trokitur në derë.

Burrat thoshin fjalë të mira e plakat luteshin që të kishin në shtëpi një nuse si Maria. E bukur si zanë mali. Me atë trup të gjatë e të drejtë, me ato sytë e shkruar dhe gërshetat hedhur supit, nuk kishte vajzë që t'ia kalonte për bukuri në të gjithë zonën.

Djemtë e fshatit e kishin lakmi dhe e dëshironin që ta kishin fat e të martoheshin me Marien, por, atëherë, në këtë fshat ishte vendosur që nuk mund të bëhej miqësi brenda fshatit. Erdhi një ditë që edhe këto ëndrra të bukura rinore të përmbyseshin.

Nika e fejoj Marien në fshatin Murrizë pa dijeninë e saj. E vajza e bukur e Nikës, kjo zanë mali që e lakmonin të gjithë djemtë e fshatit, ia kishte falur zemrën Lekës, një djalë ky moshatar me Marien në fshatin matanë Drinit, megjithëse as ishte parë e dëgjuar ndonjëherë që vajzat të fejoreshin vetë pa pëlqimin e prindërve. Hë sot, hë nesër, Maria nuk kishte pasur mundësi që t'i thoshte të paktën nënës, t'i hapte zemrën pa droje. Dashurinë mes dy të rinjve e dinte vetëm motra më e vogël Marta, por dhe ai çelës, si i thonë fjalës, nuk i kishte treguar njeriu për bë. Ajo e kishte parë shpesh Marien tek mernte tufën e deleve para dhe i fuste në shelgjishtet buzë Drinit.

Aty takohet me Lekën dhe qëndronin bashkë deri vonë, kur dielli humbiste matanë. Maria atë mëngjes u ngrit nga gjumi si e trullësuar. Në darkë nëna i kishte treguar se e kishin fejuar në fshatin Murrizë, një fshat ky fare pranë Gjurrasit. Kjo fjalë për Marien erdhi si diçka e papritur.

As e kishte menduar se do të futej dikush i panjohur mes saj dhe Lekës. Por ja që paska ndodhur! Tufa e deleve e kishte kaluar “Rrasën e Bollës” e po kullosnin qetë-qetë në shelgishte e Maria akoma nuk kishte zbritur “Kodrën e Murrizë”. Fjalët e nënës e kishin dërrmuar keq. Akoma nuk e besonte se tashmë ajo ishte cucë e fejuar dhe si e tillë duhej të kishte kujdes. Dashurinë e saj me Lekën nuk ia kishte treguar askujt. Bile dhe motra e saj Marta e kishte pikasur se tufën e deleve gjithmonë e çonte në shelgishte në breg të Drinit.

Një ditë e kishte parë bashkë me Lekën tek bisedonin të shkujdesur pa u ruajtur nga syri i hallkut, por motra nuk i tregoi askujt. Por ama Mariës i kishte thënë:

- Mos ia mba fshehur motrës tënde dashurinë që ke me Lekën se ndoshta të duhem ndonjë ditë! E sot këto po mendonte Maria tek zbriste poshtë Kodrën e Murrizë. Motra e ndiqte nga pas se e kishte dëgjuar bisedën që kishte bërë me nënën në mëngjes.

- Do t'ia them të gjitha Lekës, sapo të bije në breg të Drinit. Do të dal në va e do të shkoj tek ai, atje ku kullot delet. Me këto mendime në kokë ra poshtë kodrës. Drini atë ditë ishte i turbullt dhe vinte gjithë zhurmë e potere, duke marrë para gurë dhe drurë të mëdhenj. Aq i inatosur ishte Drini, saqë nuk pyeste as për vaun ku dilte Leka më këmbë e takohet me Marien.

Ishte fry aq shumë, saqë vau nuk dukej më. Maria, kur e pa se tufa e deleve nuk e kishin ndërmend të dilnin nga shelgjishtja, u afrua afër vaut, pikërisht aty ku Leka dilte përherë në këmbë dhe filloi të thërrasë me sa zë kishte:

-Lekë! O Leeekë!

Zhurma e Drinit nuk e linte zërin e saj të kalonte matanë. Maria nuk e ndjente fare se ujët e turbullt të Drinit i kishin mbuluar kërcinjtë e këmbëve dhe ekui-libri i saj nuk po qëndronte dot më. Sakaq, një dallgë tjetër e fuqishme e rrëmbeu dhe e mori me vete. Motra e pa gjithë këtë skenë tragjike që i ndodhi Mariës, por ishte e pafuqishme që ta ndihmonte. Kur vajti në breg të Drinit, çdo gjë kishte marrë fund.

Vetëm delet kullosnin qetë-qetë sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Atëherë mallkoi Drinin: “Dri, o Dri, u bafsh i zi!” Mallkimin e motrës për motrën e dëgjuan të gjithë e, që në ato kohë, i mbeti Drini i Zi.

Bukla

Në Dibër këtë kafshë të egër e të rrallë e thërrasin Bukël, Një emër eufemik shumë i gjetur. Pra, “E bukura”. Kështu është quajtur e kështu quhet edhe sot ajo kafsha e rrallë, banore e mureve dhe trojeve të braktisura, që shikohet shumë rrallë. Tani besoj se kuptohemi që bëhet fjalë për një kafshë të egër, të ngjashme me macen, një gjiatar me gëzof të kuqërremtë e bark të bardhë.

Ndoshta pse shihet rrallë, ndoshta pse ka bërë ndonjëherë zullume të egra si kafshë mishngrënëse që është, populli ka thurur për të shumë tregime, duke e veshur me cilësi të veçanta çuditëse e fatndjellëse.

Më së shumti qëndron nëpër muret e shtëpive, në rrënoja muresh e në pirge guri, por ndodh që gjendet dhe në kopshte pranë shtëpive. Bukla, zakonisht, nuk është e dëmshme, por rrallëherë ka ndodhur që ka bërë dëm në bagëti dhe në njerëz. Më së shumti han gjinjtë e bagëtive. Që të mos bëjë dëm, shpesh vendosin një furkë me një shtëllungë leshi, por dhe bukë në një dritare ku ka bagëti.

Thonë se bukla, kur vijnë në dritare me u fut tek bagëtitë nuk bën dëm, por merr furkën e tjerr lesh si dhe ha bukën që gjen në dritare. Bukla më së shumti është një gjallesë që i sjell mbarësi shtëpive ku ndodhet. Ajo shtëpi që nuk ka një bukël thonë se nuk ka mbarësi. Kjo e paston shtëpitë nga minjtë si dhe zvarranikët e tjerë të frikshëm. Ajo është roje e shtëpive ku banojnë njerëz.

Po si ka ardhur tek ne legjenda për këtë gjallesë disi të çuditshme?

Njëherë e një kohë në një fshat matanë Drinit jetonin tre vëllezër dhe që të tre u martuan. Shkonin kaq mirë me njëri-tjetrin edhe pasi u martuan, sa shumë shpejt filluan të futen në gojë e fshatit për mirë. Ishte një familje e madhe, por model në fshat dhe më larg. Pas pak kohësh vëllai i vogël shkoi në kurbet larg familjes.

Në shtëpi u la amanet vëllezërve gruan e djalin e vogël. Nusja e vëllait të vogël ishte më e bukura dhe më e zgjuara ndër kunatat. Këtë e shikonin edhe vetë kunetërit, e shikonte dhe gjithë fshati. Mirëpo kjo bukuri dhe zgjuarsia po i bënte xhelozë kunatat. Atyre u verbonte sytë kjo bukuri, ku dhe vetë katundi fjalët më të mira thoshte për të.

Meqenëse burrin nuk e kishte në shtëpi, filluan që t'i nxjerrin dhe fjalë në fshat për çështje nderi, që ajo në fakt ishte krejt e pastër. Opinioni që ishte krijuar për të mirë, nuk prishej lehtë. E panë se e kishin të vështirë me fshatin, atëherë në bashkëpunim me burrat e tyre përdorën një djallëzi tjetër. Burri po vonohej e djali ishte i vogël. Një ditë e morën kunatën dhe e mbyllën në bodrumin e shtëpisë me dry. Në atë errësirë askush nuk e shihte. Këtu do të vdiste dalëngadalë dhe gjurmët do t'i mbulonin më vonë.

Djali ende ishte i vogël dhe nuk kuptonte gjë. Sapo kishte filluar të belbëzonte fjalët nënë e babë. Djalin kunatat e mbanin mirë dhe e trajtonin njëllë si fëmijët e tyre. Nuk e linin asnjë ditë vetëm. Ai belbëzonte sa belbëzonte duke kërkuar nënën e babën dhe më së fundi e zinte gjumi. Një ditë, ashtu këmbadoras afrohet tek dera e bodrumit, ku qëndronte prej disa ditësh nëna e tij e kyçur. Dryni i ndryshkur u shpërthye vetë e dera e rëndë prej druri u hap kat e m'kat. Djali këmbadoras filloi të futej brenda në bodrum. Në një qosh pa një kafshë disi të çuditshme.

U afrua dhe më shumë dhe, duke e përkëdhelur e lozur me të, filloi të shqiptojë për herë të parë fjalën bukël. Djali nuk e shqiptonte dot fjalën bukur, por thoshte vetëm bukël. E kjo gjallesë e re, e urtë e linte djalin që ta përkëdhelte.

E ku ta dinte djali i vogël se kjo gjallesë që po lozte e vetme në bodrum, ishte vetë nëna e tij, e cila ishte kthyer në një gjallesë disi ndryshe, që nuk ishte parë! Kështu thotë legjenda për bukël e populli i ka krijuar aq tregime e kënduar dhe këngë.

Nusja e bukur dikur, e mbyllur në bodrum u kthye në bukël. E këtë emër ia ngjiti vetë djali i saj, kur belbëzoi fjalën ‘bukël’ në vend të fjalës “Bukër” - “E bukur”.

(Marrë nga vëllimi “Currat e Korabit”, Botimet “Emal”, Tiranë2012).

Pas sfidave të vështira në malet e Dibrës, Shqipërisë dhe Ballkanit, “Mjeshtri i sportit” ia del të sfidojë edhe sëmundjen e rëndë dhe tashmë është jashtë rrezikut për jetën.

Nga **DEFRIM METHASANI**

E pabesueshme, por e vërtetë. Besnik Kica, është dibrani që ia doli në Itali të mposhtë sëmundjen e globit dhe më të rrezikshëm, Covid -19. Vetëm një muaj më parë, marr një mesazh nga dyert e spitalit nga Besniku që me zërin që i dridhej më tregoi që kish dalë nga situata e vështirë e intubimit dhe tashmë ndodhej në pavijon me mjekimet e radhës. Testi i fundit i bërë rezultoi negativ dhe Besniku ishte njëri nga ata heronjtë e heshtur dhe shpëtimtarë të sëmundjes së tmerrshme dhe vdekjeprurëse.

Postimi asokohe bëri bum-in e radhës dhe qindra e mijëra mbështetës i jepnin kurajo kampionit të maleve të mposhte edhe këtë sëmundje të rëndë. Vetëm pak ditë më parë, Besniku sërish më telefonoi, por tashmë në një situatë krejt tjetër jashtë dyerve të spitalit, ku nipërit dhe mbesat i këndonin edhe këngë dhe vallëzonin me të. Vërtet një lajm i bukur



në kohën e zymtë dhe të vështirë që po kalojmë ku dëgjojmë çdo ditë për humbje jete dhe të tjerë që hyjnë e dalin në dyert e spitalit. Por cili është Besnik Kica për ata që nuk e njohin?

Ishin vitet 1963, kur ai ishte nxënës në shkollën “Demir Gashi”. Ishte jo më shumë se 10 vjeç dhe mësues kishte legjendën e sportit dibran Taxhedin Shehu. Profesori, si një nuhatës i mirë, kupton dëshirën e Besnikut për t’u angazhuar me sport. Kësisoj, alpinisti më i vogël që do t’i bashkohej grupimit të madh të Korabit në këtë sport ishte Besniku dhe kësioj nisin edhe ngjitjet e para.

Fillimisht Besniku iu bashkua ngjitjes në malet e Lurës dhe liqenet e saj. Në vitin 1964 Besniku kujton se jo pak, por 15 ditë me radhë ata shijuan një kamping të bukur në atë perle të natyrës shqiptare me shumë liqene por edhe me male të larta, majat e të cilëve dukej se puthnin edhe qiellin. Natyra piktoreske dhe vende të tilla mahnitëse e bënë për vete djalosin Kica që do të vijonte tashme stërvitjen tek kepi i Ilixhave dhe ai shkëmb që njihej prej të gjithëve. Do të kalonin 9 vjet dhe në vitin 1973 pas një



pune intensive ai do t’i bashkohej ekipit të “Korabit” drejt malit e Korabit në ngjitjet e vështira dhe kuptimplotë të malit më të lartë në Shqipëri.

Por tashmë grafiku vijonte me ngjitje të tjera dhe alpet e Shqipërisë ishin fusha e mejdanit për çdonjërin që merrej me alpinizëm.

Majat e hekurave, Jezerca dhe mjaft maja të tjera, kishin rrezikun brenda. Kështu vitet ecnin dhe bashkë me të edhe Besniku afirmohej krahas mjeshtërve të tjerë dibranë që nën drejtimin e profesor Taxhit kishin krijuar emrin e bukur në gjithë vendin. Qemal Hakorja ishte njëri prej mjeshtërve dhe sportistëve të guximshëm të ekipit Korabi, por po kaq të mirë ishin edhe Rushit Reçi, Adil Manga, Zabit Tusha, Abdulla Mërdini, etj. Në vitin 1978, Besnik Kica do të shpallej edhe sportisti më i mirë në anketën e zhvilluar në klubin “Korabi” me dhjetë sportistët më të mirë të vitit dhe fotografia e tij qëndroi në mes të qytetit për një kohë të gjatë. Së bashku me Taxhin, Rushit Reçin, Adil Mangën dhe Zabit Tushën, krijuan një grup të fuqishëm që pushtuan edhe malet e Bullgarisë në një aktivitet ndërkombëtar që

mbeti në kujtesën e secilit dhe u konsiderua sukses për kohën.

Besniku kujton edhe majën e Arapit dhe vështirësitë e problemet që pati në alpe, ku u aksidentuan edhe disa alpiniste, ndërsa tregon të respektojë. Krahas shumë emrave të mëdhenj të alpinizmit, ai kërkon të respektojë në këtë shkrim, Minella Kapon, njëherësh edhe drejtues i kësaj federate, Aleksandër Bojaxhi të ish “17 Nëntorit”, Vangjel Ristanin e “Tomorrit” të Beratit dhe mikun e tij të vyer, Nuredin Secin e “Valbonës” së Tropojës me të cilin ruan edhe këto vite miqësi familjare.

Në vitin 1995, ai fiton edhe titullin Mjeshtër Sporti, për të gjitha këto merita dhe cilësi të fituara përmes një karriere me shumë se 25 vjeçare në sportin e bukur të alpinizmit. Ky shkrim është një detyrim moral për sportin dhe sfidat e viteve të tij, por edhe mbi të gjitha për luftën e fituar së fundmi me Covid 19. Besniku tashmë jeton në Itali në Trento dhe i gëzohet shëndetit, ndoshta edhe falë atij vullneti dhe atij karakteri që fitoi në sportin e bukur mes malesh e luginash të pafund, pra sportin e alpinizmit.



Botimi i gazetës është punë vullnetare, ndaj çdo pajtim vjetor ose dhurim, është i mirëpritur. Dhurimet pranohen vetëm përmes llogarisë bankare që gjendet më poshtë dhe për çdo rast ai do të bëhet publik.

**Raiffeisen Bank, Rr. Kavajës, Tiranë. Swift code: SGSBALTX.
IBAN(ALL): AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640**

Mehmet Kaloshi dhe Nanë Sibja u larguan nga kjo botë me zemrat plot, jetuan e punuan me nder, vuajtën e hoqën me nder, krenarë e faqebardhë duke lënë pas, jo një, por dy katunde me pasardhës të mbarë...

Për misionin e Enver Kaloshit, arketipin Llan Kaloshi dhe Irfanin - një Kalosh

PROF. DR. BAJRAM XHAFA

(vijon nga numri i kaluar)

Nënë Sibes me pamjen tipike të gruas mbi të cilën kishin rënë dhe ishin përplasur gjithë rrebeshet e shtëpisë, të burrit e të babës, iu kthye gazi. Bijë e Llan Destan Ndregonit, asaj iu desh të përballojë si burrneshë vrasjen si burrat të babës, Llanit, kreshnikut nga Lukani i Qafë Murrës dhe heroit të luftës së 1918-1921 me serbët, ndër kontribuesit e shtetndërtimit të Shqipërisë së pavarur, kur më 1946 bashkë me burrin e saj, Mehmetin, u përballën me një batolion të tërë të forcave të ndjekjes së diktaturës. Simbol i vuajtjeve dhe stoicizmit deri tek s’(m)bân, siç është gruaja dibrane, siç janë Nanat Shqiptare, Sibja, me atë ballin e lartë dhe hundën pak të thyer që e bënte t’i shëmbëllej Vojsavës së Kastriotit të përshkruar nga Noli, iu desh për 15 vjet të mbajë shtëpi e të rrisë fëmijët me kryet nga dera në pritje të kthimit të burrit nga burgu apo frikën e lajmësit për një fund të frikshëm.

Sina ishte zonë e thellë malore e Dibrës dhe sistemi i kooperativës bujqësore endë nuk kishte mbërritur deri atje, megjithë rrëmbimin e ethshëm e gërryes me të cilën ecte revolucioni agrar dhe çdo gjë shkatërrimtare në Shqipërinë e Enverit Hoxhës. Tokën e kishte të mirë Meta, jepte prodhim. Edhe zabele kishte, edhe bagëti mbante. Në familje shpërthyen energji të reja dhe trokitën reze shprese e përtëritjeje. Djemtë e shpisë si diva, ishin të hallallit dhe po ecnin në rrugë të mbarë, kah e “përpjeta”. Dukej se shtëpia shkonte termâ. Kishte ra “paqja”. “Paqja”!!!!

Edhe diktatura nga ana e saj i kishte zbutur pak temat. Ajo bomba e Moskës mu në mes të Kremlinit më 1960 shyqyr e kishte shkëputur Shqipërinë nga B. Sovjetik, por sikur e kishte lënë pezull e në udhëkryq, mendonte Meta. Shqipëria i shkëput nga Jugosllavia dhe Rusia, por nuk po jepte shenjë se po shkonte andej nga e deshte Kaloshi. Nuk dihej mirë se si do të merrnin e nga do të merrnin punët e Shqipërisë. Sidoqoftë, një devër tjetër dukej se po vinte, por kur, çfarë devri dhe sido të vinte. Enver Hoxha deklaroi më 1961 se *në vend ishte ndërtuar baza ekonomike e socializmit, se marrëdhëniet socialiste kishin “triumfuar” në të gjitha fushat e ekonomisë e jetës së vendit, se klasat shfrytëzuese ishin zhdukur e se nuk kishte asnjë rrezik për kthim mbrapa në kapitalizëm*. Pasi mendoï se rreziku kaloi, diktatura filloi të merrte frymë, por me veshetë përpjetë e këmbët në havâ. *Nuk i dihej, ç’bjen dekiku nuk bjen moti*, - mendonte Kaloshi. Ngado që ta kthesh, mullini bluante më butë. Kalosh, gëzoju çastit, gëzoju kësaj që ke nëpër dorë se po të ikën koha.

Edhe djemtë e Kaloshit, fjalën e kam vetëm për të Mehmet Kaloshit, filluan të hapen, të promovojnë lirinë. Mbase të ekspozojnë në publik lirinë e shumëmunguar, e t’i thonë botës se çfarë ka kaluar nuk duan ta shohnin më, se do të shohin përpara e jo mbrapa. T’i thonë botës se edhe ne jemi si ju. Nuk jemi të burgut, jemi të punës, jemi të shkollës, të qetësisë, të paqes, të ndërtimit. Prandaj, të shtunat ose të dielat i shihje shpesh djemtë e Kaloshit e të Sinës të dilnin shëtitje bashkë në bulevardin e Peshkopisë. Tërhiqnin edhe ndonjë tjetër, për solidaritet. Përzihesha edhe unë me ta nganjëherë. Pa u thelluar, më kândeje muhabeti.

Irfani na i qenkësh vënë edhe mësimit të frengjishtes. Eh! Po ky ku don të shkojë me këtë frengjishte? Ne edhe një rusishte që e kishim në programin mësimor e kishim samar mbi gungë. Meqë u prenë edhe shpresat për studime në Bashkimin Sovjetik, rusishtja na bëhej si zgjebe. Një copë mësues në katund do të ishim, sa për t’u ba idaire. *Nuk duhet të shohësh shumë lart se e then qafën*. Kështu këshillonte urtia popullore. A nuk thoshte edhe Migjeni *“Ilene Zenelin të rrojë jetën stërgjyshore... mos e merr në qafë me e hypë ndër majat e nalta nga mund të thejë qafën i dëshpruem tue pa të vetët të dashtun tepër ultë”*. Ndërsa Irfani na paska kapur edhe

një frengjishte. Ç’i duhej? Apo për t’ia treguar vorrit.

Provimet e maturës erdhën. I pari, hartimi, ku do të zgjidhnim njërën nga dy temat. E para ishte për 20-vjetorin e çlirimit që do të vinte shpejt, ishte jubilarë, ndërsa tjetra për Naim Frashërin. Irfani kishte marrë temën e parë... Hartimi i tij u vlerësua më i miri për të dy maturat. Një material i ngjeshur, i pasur në ide, shkruar me stil dhe plot figura, siç e komentoï drejtori. Tema e çlirimit mua më dukej si fjalimet që mbaheshin nëpër tribuna. Ato s’i kisha qejf fare. Pastaj nuk dija edhe se ç’të thosha, nuk më punonte fort mendja, sepse edhe nuk kërkoja për to. Ato, temat e luftës e të lirisë vinin vetë apo na i sillnin përditë e me bollëk nga të gjitha anët. Iu shtërngova Naimi Frashërit se shumë vargje nga veprat e tij i dija përmendësh. Sidomos nga “Historia e Skënderbeut” me të cilat të mbaja një ditë të tërë. Mendoja se kështu profesori do të sugjestionohej me vullnetin tim. Shkruaj vargje pa fund dhe bëj nga një sqarim si punë komenti, për Skënderbeun e për Kamanin, për Shqipërinë e për sulltanin, atë viranin e atë katranin, për ato dy persët e urryer që Skënderbeu i shtriu përtokë e plot të tjera, “baj e bjer”. Shkurt muhabeti, hartimi im, një thes me dushke lisi për t’ua shtruar dhenve në ahnin e bërë bërrakë nga bajgat.

Por Irfanit nuk i piu ujë as hartimi i shkëlqyer e as diploma e mësuesit që mori. Nuk e emëruan mësues qoftë edhe më ndonjë shkollë në zonat e thella të Dibrës. Jo vetëm Irfanit, por edhe Enverit që ishte mësues, i gjetën sebebën dhe e larguan nga puna.Madje i ndërprejnë edhe studimet e larta. Ky kishte qenë apogieu i Kaloshit. Tani fillonte tatëpjeta, diagrama e Nastradinit: Pas të përpjetës, tatëpjeta, e teposhta. Partia e Punës, alias Partia Komuniste e Shqipërisë filloi të karikojë bateritë e thellimit të luftës, luftës së klasave, me popullin e vet, se imperializmit t’i rruante... atë menderin.

Mehmet Kaloshi u hodh në retrospektivë, filloi bilancet e jetës, bënte sintezën politike. Filloi të thellohej në to. Gjatë 15 vjetëve, shumë prej shokëve të burgut, herë pas here patën ulje të dënimit, amnistira dhe falje. Me rënien e grupit armiqësor të Koçi Xoxes pati shumë të liruar si viktima të tij, por Kaloshi jo. Pati data jubilarë të 10-vjetorit të partisë dhe të çlirimit që u shoqëruan me lirime nga burgu e falje, por Kaloshin nuk e kapte lapsi. Edhe detanta hrushoviane që e zbuti fort luftën e klasave në gjithë Bllokun Komunist i kaloi tangent, pa e prekur Mehmetin. Pati edhe një lëvizje të fuqishme ndërkombëtare të partizanëve të paqes shoqëruar parullat “Rroftë paqa në botë!”, që na ranë duart duke i shkruar kudo nëpër faqe kodrash si dhe ato “pëllumbat e paqes” që vizatoheshin ngado e kudo, nuk e trazuan statusin e tij si i burgosur.

Kaloshi u bind se pikërisht burgu i tij dhe i shokëve të sojit të tij ishte kredia dhe pengu shqiptar i “Paqes” për Ballkanin e Evropën. Ishte ujdja e Madhe e të Mëdhenjve. Shqiptarët do të paguanin edhe për luftën edhe për paqen. Për Kaloshin dhe nacionalistët si ai kishte lista të veçanta të burgosurish, lista që ishin të paprekshme. Nacionalizmi ishte “krimi” më i rëndë, më i pafalshëm në asnjë rrethanë. Ishte krim “ndërkombëtar”. Fashizmi e mori faturën të ndëshkimit me gjyqe ndërkombëtare. Ndërsa nacionalizmi ishte ne ndëshkim permanent dhe pa gjyq. Prandaj Babë Meta i bëri 15 vjetët e burgut pa luajtur nji centim. Në burg kishte hyrë për Shqypninë, për “Çështjen Shqiptare”. Ishte burg “i brendshëm”, jo në Yenkulë të Stambollit, as në Kalanë e Shkupit, as në kazamatet e Jugosllavisë që Beogradi i kishte mbushur me shqiptarë, por në Bodrum-Kala të Gjirokastrës ku frynin “bilbilat e Kristaqit me shokë”, burg në “vendin e vet”. Aty Meta pa edhe sivëllezërit e tij burra të Shqypnisë: djemtë e bajraktarit të Lurës, Ali Mena me vëllezërit e tij, Mexhitin e Ramizin, (se vëllanë tjetër, Isanë e kishin çuar në Tiranë); me Et-hem Haxhiademën - poet e dramaturg, Muharrem Dashin, Qamil Xhajën, Arshi Pipën, Islam Ndreun, vllaznit Pira e Xhafer Kurtin, me

Deme e me Kaloshë, Selim Cekën dhe doktorin Luigj Radoja (“Mehmet Kaloshi, Portrete”, M&B, 2017, f. 105-107).

* * *

Pasi mbaruam maturën, me Irfanin nuk u pamë. Si çdo verë, unë përsëri shkova në Rruga-Ura për të fituar ndonjë lek me të cilët kaloja në “vetëfincim”, për harxhet emergjente, pa iu bërë barrë shtëpisë. Në fund të gushtit seksioni i arsimit thirri të gjithë arsimtarët për të komunikuar caktimin e kuadrit në të gjithë rrethin dhe të drejtat e studimit në shkollën e lartë. Mbledhja u bë në një sallë të madhe në “Demir Gashi”. Mua më doli e drejta e studimit në Univesitetin Shtetëror të Tiranës. Bashkë me të, edhe bursa e shtetit, 3000 lekë në muaj për dhjetë muajt e shkollës. Irfanit nuk i doli emërimi. Morëm rrugë të ndryshme dhe nuk u pamë.

Kisha kaluar në vitin e dytë të studimeve në Universitet kur aty nga dimri i 1966-s u takova me Irfanin në Teatrin e Estradës së Tiranës gjatë seancës së pushimit të shfaqjes. U pyetëm me njëri-tjetrin por jo “përzemërsisht”. M’u duk i ftohtë, pak i përhmbur. E pyeta për punën dhe më tha diçka që e harrova. Nuk kishte qejf të fliste. - Epo, ftohen, - mendova, - aq më tepër, që ai ka edhe biografinë. Ai me shkollë si unë, por pa punën e mësuesit, unë në shkollën e lartë. Nuk vonoi dhe mora vesh se Irfani ishte arratisur. - Gjë e pritshme, - mendova.

Irfani qe i pari që e ndjeu mbi kurriz “kthesën” e diktaturës. U soll nga u soll dhe kishte gjetur më së fundi një punë, në Fabrikën e Çimentos në Fushë-Krujë. Edhe vëllai i madh, pas iu ndërpre mësuesia iu vu ustallëkut, mur, llaç e gëlqere, me universitet. Diktatura e kaloi pikën e rrezikut dhe nxorri shpatën për “fazën” tjetër të revolucionit e të luftës së klasave. Në mars 1966 doli “Letra e Hapur” e KQ të PPSH që bënte thirrje për “luftë kundër burokratizmit”: Kjo qe dallëndyshja e parë e shpatës së zhveshur të revolucionit në thellim. Por kjo ishte fare pak. Në nëntor të ‘66-ës kongresi i V e bëri të qartë se tani që u zhdukën klasat shfrytëzuese, lufta e klasave nuk do të pushojë. *“Ajo (do të) zhvillohet dallgë – dallgë e me zigzage, herë ngrihet e herë ulet, herë acarohet e herë zbutet, por kurrë nuk ndërpritet e nuk shuhet”*. (PPSH, “Dokumente kryesore V”, Tiranë, 1974, f. 152).

Periodha e “detantës” edhe për luftën e klasave mbaroi. Diktatura hoqi pritën dhe mprehu shpatën. Dallga e parë e saj do të binte mbi ish “klasat shfrytëzuese” dhe pastaj, siç na mësonte edhe Mao Ce Duni, do të shpërvjelej mirë “në gjirin e popullit” (f. 55). Shpejt do të vinte *Fjala e 6 Shkurtit 1967* e shokut Enver që do të sillte “stuhinë revolucionare”, me tamtame e tramandame: kolektivizimin total të vendit, pra edhe të zonave të thella malore, (përfshirë Sinën), luftën kundër fesë, ideologjisë fetare e zakoneve prapanike, emancipimin e gruas (daljes së saj në punë të detyrueshme). Tre dynymshi u bë 1 dynym për çdo anëtar, pastaj u kthye në gjysëm dynymi e në çerek dynymi me ndarje kunorësh. Buka e gojës hyni në dry, llapa e gojës nën dhambë, “liria” e fjalës dhe e besimit ishin vulosur me dyllë. Shqipëria socialiste?! Nanë moj nane. Devër dynjaja. Por devri i Shqipërisë, më i ziu, më i mbrapshti. Ngado që ta kthesh, Irfanit nuk i dilte llogaria, nuk pati derë dhe asnjë grimë shprese. Iku, theu kufirin, u arratis, bafti i Zotit. Shkoi...në Amerikë. Të shtëpisë,... Zoti i pshtoftë! Kanë nafaken e vet.

EPILOG

Kur në fillim të të ‘90-ve ra diktatura, që Shqipërisë veç se i ndërroi lëkurën e gjarpërit, edhe Irfani, si shumë të arratisur, u kthye (me na pa e me u pa). Gjithë mall e kureshtje u takuam e u pyetëm. Mendja ime kishte mbetur endë tek ato vjershat, letërsia. Pa fillur mirë Irfani e kuptoi: *“I kam lanë krejt ato punë. Njeriu në jetë ka halle shumë. Pak kush e ka fatin dhe luksin*

t’u shkojë mbrapa prirjeve.” I dhashë të drejtë, aq më tepër, Irfanit. Por kur në librin **“Mehmet Kaloshi, Portrete”** lexova pjesën **“Heroi im”** të shkruar nga Irfani, qava. E kishte shkruar thjesht, bukur dhe me ndjenjë. Ishte ai Irfan që dinte të përjetonte dhimbjet e t’i përcillte emocionet direkt nga zemra në letër. Vërtet kishte plot gjëra për të thënë, ishte vetë subjekt romani, por edhe dinte se si ti thoshte. Ishte aty ai dell i dikurshëm i letrarit që kishte ndenjur i fshehur, por që u zgjua edhe pse i pakultivuar. Pse kjo prirje nuk u zhvillua më tej? Ku ta kultivonte Irfani dhuntinë e falur nga Zoti? Në Shqipëri? Shqipërisë po i përgatisnin gropën, jo më të rrije e të bëje edhe poezi. Krijime e këngë vaji e dhimbjeje mund edhe të bëje, por ku të veje me to? Kujt t’ia tregoje dhe pse? Të rrish e të qash natë-ditë me vjersha!

Më pas mora vesh se Irfani kishte ardhur nga Amerika dhe shkova ta takoja, në shtëpi, tek Enveri. Prindërit i kishte gjallë. Kishte ardhur disa herë nga Amerika por nuk kishim ndenjur përveç një rasti, edhe atëherë në këmbë. Më ndali për drekë. Të llafosemi më gjatë e të çmallemi. Ishte edhe Babë Meta aty, edhe Nanë Sibja, në konakun e ri e të bukur në Fushë Krujë, me një oborr të gjatë e lulishtë përpara mbushur me lule. Ndenjëm në sallon. Mehmeti zgosti më shihte e më fliste plot kënaqësi, si “bashkidealist” dhe më përgëzonte për shkrimet që kisha bërë për Legalitetin e Mbretin. Më thoshin se për Mbretin Zog Meta nuk linte kënd të lehte e të cingërinte.

Erdhi Enveri dhe, pasi u përshëndetëm, më kërkoi leje sa të rruajë pak babën. Si duket e kishte detyrë funksionale. Unë nuk e bëja një gjë të tillë me babën tim, sepse jetonim larg, ai në Dibër e unë në Shkodër. Atëherë nuk mendova më gjatë, por kur edhe baba im u largua nga kjo botë, them me vete: “Si nuk e bëra një gjë të tillë me babën tim edhe unë siç bënte Enveri.” Edhe sikur mos të më lejonte vetë ai apo të tjerët, bëje pa pyetur kënd, tregohu këmbëngulës. Lum Enveri për atë gjest dhe për shërbimin që i bënte babës së vet. Merr bekimin sa nuk është vonë, është investim hyjnor. Është ibadat që i bëhet Allahut. Sa mangut kemi qenë.

Nënë Sibes i qeshnin sytë. Pse jo? I ishte mbushur shtëpia. Zemra plot e shtëpia plot. Më i largëti, ai që jetonte atje në Amerikën e largët, në anën tjetër të dheut, Irfani i dashtun, ishte aty.

Shtëpia dritë. Djemtë e nipat, hyn e del; nusët e nipave e vajzat e tyre, gjithashtu. Nusja e shtëpisë, e nipit të madh, bënte drekën. Dhe nanë Sibja me fytyrë të çelur, ndërsa shihte nga mysafiri plot gaz e mirësi shokun e vjetër të djalit të saj, i lutej Zotit ta merrte prej kësaj dynjaje kështu siç ishte, e ta linte të paprekur mbi tokë gjithë këtë mirësi që Ai i kishte falë, këtë gëzim e begati në Konakun e ri.

Me Irfanin dolëm në dhomën tjetër të kapim muhabetet tona e të kujtojmë. Politika dhe pesha e rëndë e halleve që kishin mbuluar vendin nuk na lanë për pak kthim mbrapa në kohë, për pak nostalgji për kohën e rinisë së pakthyeshme, veç me ca pak kujtime sa për relaks. I lamë mënjanë edhe ato më të bukurat e së kaluarës dhe u kapëm për aktualet që Shqipërisë nuk i mbarojnë kurrë. Megjithëse të një krah u politik, prapë se prapë bisedat dhe përfundimet qenë me jo pak zeher. Më shumë helmatisja unë me prurjet nga historia politike e diplomatike e çështjes shqiptare. Sidoqoftë, atmosferën dhe shëndetin i kishim shumë të mira dhe drekën e hëngrëm plotë shije, mbledhur të gjithë bashkë në një tryezë të madhe.

Kur të rinjtë martohen, në Dibër urimi që shkon për ta është: **“Qoftë për hajër (dobi)! U trashëgofshin e u shumofshin me djem e vajza, me nipër e mbesa e u bafshin një katund.”** **Mehmet Kaloshi dhe Nanë Sibja u larguan nga kjo botë me zemrat plot, jetuan e punuan me nder, vuajtën e hoqën me nder, krenarë e faqebardhë duke lënë pas, jo një, por dy katunde me pasardhës të mbarë, të shpërndarë në dy kontinente, në Evropë dhe në Amerikë si dhe emrin e nderuar e të madh të pacënuar asnjë fije, këndeje dhe andej oqeanit: KALOSHI.**

personalitete

NË 85-VJETORIN E LINDJES: Për gazetarin, shkrimtarin dhe mësuesin shembullor që bëri aq shumë për Gollobordën dhe Dibrën

Velo Cfarku, kryeredaktori më jetëgjatë që i dha jetë “Ushtimës së maleve”

Nga Halil RAMA

Në 85-vjetorin e ditëlindjes, gazetarin dhe mësuesin e shquar Velo Cfarku, e urojnë për zemërsisht, jo vetëm familja e tij e mrekullueshme, por gjithë elita intelektuale dibrane, pjesë dinjitoze e së cilës ai ishte dhe është, si dhe miqtë dhe shokët e tij të shumtë në Tiranë, Peshkopë, Elbasan dhe sidomos në fshatrat e Gollobordës. Në memorien dhe vlerësimin e tyre, ai është gazetari dhe mësuesi shembullor, që bëri aq shumë për Gollobordën dhe Dibrën.

Velo Cfarku u lind më 5 maj 1935 në Gjinovc të Gollobordës. Mësimet e para i mori në fshatllindje (1946-1949) me mësues z.Sefedin Shabani. Të mesmem në shkollën Pedagogjike “Ndrec Ndue Gjoka” (1951-1955) dhe për plotësim në Shkollën Pedagogjike “8 Nëntori” Peshkopë (1957).

Ka kryer Institutin Pedagogjik “Aleksandër Xhuvani” në Tiranë për matematikë-fizikë (1963-1964). Ka punuar si mësues në fshatin e lindjes (1955-1956) dhe në shkollën 7-vjeçare “10 Dëshmorët e Trebishtit” (1956-1963), drejtor i shkollës 7-8 vjeçare “Spiro Velko të Klenjës dhe njëkohësisht drejtor zone në lokalitetin e Klenjës.

Mbas kryerjes së Shkollës së lartë të Partisë (1970-1972) ka qenë instruktor në aparat në sektorin e edukimit.

Nga muaji gusht 1973 ka drejtuar gazetën “Ushtimë e maleve” si kryeredaktor i saj për 17 vite, gazetë kjo që ka qenë tribuna e vetme media-tike e Qarkut të Dibrës për gjatë regjimit, që për afro 23 vjet me radhë ka promovuar ngjarjet, personazhet dhe problemet më të spikatura të trevës dibrane në të gjitha fushat. Kjo gazetë ka promovuar një armatë të tërë shkrimtarësh, të cilët kanë lënë dhe po lënë gjurmë të mëdha në historinë e medias shqiptare.

“Ushtimë e maleve” që Velo Cfarku e drejtoi me kompetencë e profesionalizëm të lartë, për afro dy dekada ka përcjellë mbi 9 milionë kopje, ku kanë marrë pjesë me shkrime rreth 25 mijë anëtarë, bashkëpunëtorë e korrespondentë të saj, midis tyre intelektualë e kuadro të rangjeve të ndryshme, shkrimtarë artistë e sportistë që shkruan dhe u afirmuan falë saj.

Në vitet 1981-1982, Velo Cfarku ka kryer kursin e lartë të Filozofisë dhe ka punuar në vijim 3 vjet instruktor për arsim-kulturën në rrethin e Dibrës, për t’u rikthyer sërish në prill 1985 kryeredaktor i “Ushtimës së Maleve”.

Është dekoruar me Distinktivin “Mësues i dalluar”, me Medaljen “Naim Frashëri” më 1961 për rezultate të mira në mësim dhe me Urdhërin “Naim Frashëri” të Klasit II më 1986, për punë të mirë në drejtimin e gazetës “Ushtimë e Maleve”. Më 15 Prill 2014 është shpallur “Qytetar Nderi” i komunës Trebisht.

Velo Cfarku ka botuar librat “Golloborda në optikën e kohës”, “Një jetë mes dibraneve”, “Të parën kemi Dibrën”, “Intelektuali emblematic i Gollobordës” (monografi gjithëpërfshirëse e figurës së tij si vlerësim dhe produkt i Unionit të Shkrimtarëve të Tiranës) dhe “Mozaik episodesh e ngjarjesh, rrjedhës së Drinit të Zi”. Për këtë të fundit,



“Ushtimë e maleve” që Velo Cfarku e drejtoi me kompetencë e profesionalizëm të lartë, për afro dy dekada ka përcjellë mbi 9 milionë kopje, ku kanë marrë pjesë me shkrime rreth 25 mijë anëtarë, bashkëpunëtorë e korrespondentë të saj, midis tyre intelektualë e kuadro të rangjeve të ndryshme, shkrimtarë artistë e sportistë që shkruan dhe u afirmuan falë saj



Foto e çiftit Cveta e Velo Cfarku, 1972.

studiuuesi, shkrimtari e publicisti veteran Faik Xhani, ndër të tjera shprehet: “Impresionues, i veçantë dhe polivlerash është kontributi i Velo Cfarkut, si gazetar profesionist, si kryeredaktor i gazetës “Ushtimë e Maleve”, si studiuues e kritik letrar, por edhe si shkrimtar”. Madje sipas studiuesit e shkrimtarit Xhani, librat e botuar me autorësinë e tij, e vendosin plotësisht dhe denjësisht Velo Cfarkun në fronin e shkrimtarëve dibranë dhe shqiptarë. I japin atij, me meritë “Shengenin” e shkrimtarit për të lëvizur kudo e për të zënë vend nderi në bibliotekat e lexuesve dhe kodikët e bibliografisë e Bibliotekës Kombëtare.



Profesorë, akademikë, dhe publicistë të njohur e kanë vlerësuar Velo Cfarkun si një personalitet i kulturës në verilindje, me një biografi të begatë letrare. Kështu, Prof.dr.Shaban Sinani, akademik, kujton kohën kur ka nisur të shkruaj si nxënës për të përjavshmen “Ushtimë e Maleve” qysh në vitin 1974 (kur kryeredaktor i saj ishte Velo Cfarku) dhe kur ka botuar aty rregullisht dhjetra shkrime. Madje një vit ka marrë dhe një çmim të dytë për një fejtton, si dhe një honorar modest, që siç pohon vetë “e ktheva menjëherë në libra...”

Ndërsa Xhelil Gjoni, politikan dhe publicist, nisur dhe nga titulli i librit “Partizani i vogël Velo”, e konsideron Cfarkun partizan të të emancipimit të shoqërisë dibrane, kolegull dhe shokut e singertë, si publicist dhe propagandist.

Për poetin Qazim Shehu “Velo Cfarku është një shembull i gazetarisë investiguese që e merr lëndën nga jeta, nga kontaktet me njerëzit. Gazetaria e tij është një gazetar që vlerëson njerëzit e thjeshtë, vlerat e tyre, jo bujën e çastit të vipave, siç ndodh sot me gazetarinë shqiptare...”

Si një personalitet të njohur të kulturës në verilindje, me një biografi të begatë letrare që ka shkruar një barrë me libra, jo si qëllim më vete, por me misionin e ndriçimit e kulturimit të brezave, e vlerëson Velo Cfarkun edhe poeti Ilir Balili

“Materialin fizik, Cfarku na e jep me anë të vëzhgimit, reportazhit, personazhit, skicës, reflektimit mbi ngjarje e figura, qofshin

VLERËSIME:

Prof.dr.Shaban Sinani, akademik:

“Kam nisur të shkruaj si nxënës për të përjavshmen “Ushtimë e Maleve” qysh në vitin 1974 (kur kryeredaktor i saj ishte Velo Cfarku) dhe kam botuar aty rregullisht dhjetëra shkrime. Madje një vit kam marrë dhe një çmim të dytë për një fejtton, si dhe një honorar modest, që e ktheva menjëherë në libra...”

Xhelil Gjoni, politikan:

“Velos së ‘vogël’, partizanit të emancipimit të shoqërisë dibrane, kolegull dhe shokut të singertë, si publicist dhe propagandist, në shenjë respekti dhe felenderimi për punën e qetë e gojën e ëmbël në dobi të njerëzve”

Qazim Shehu, poet:

“Velo Cfarku është një shembull i gazetarisë investiguese që e merr lëndën nga jeta, nga kontaktet me njerëzit. Gazetaria e tij është një gazetar që vlerëson njerëzit e thjeshtë, vlerat e tyre, jo bujën e çastit të vipave, siç ndodh sot me gazetarinë shqiptare...”

Ilir Balili, poet:

“Velo Cfarku është i njohur si një personalitet i kulturës në verilindje, me një biografi të begatë letrare. Ai ka shkruar një barrë me libra, jo si qëllim më vete, por me misionin e ndriçimit e kulturimit të brezave...”

Hyqmet Hasko, shkrimtar:

“Materialin fizik, Cfarku na e jep me anë të vëzhgimit, reportazhit, personazhit, skicës, reflektimit mbi ngjarje e figura, qofshin të përditshmërisë, duke i veshur ato me një petk të mirëfilltë letrar”.

historike, qofshin të përditshmërisë, duke i veshur ato me një petk të mirëfilltë letrar”, shprehet shkrimtari Hyqmet Hasko.

Në 85-vjetorin e ditëlindjes, Velo Cfarku i përcjell urimet më të mira edhe kryesia e OBVL, duke e vlerësuar si një ndër pasardhësit dhe veprimtarët aktivë e më të denjë të kësaj organizate me histori suksesi.

Me këtë rast edhe unë dua t’i shpreh mirënjohje pa kufi dhe ta uroj për zemërsisht, të jetojë sa më gjatë dhe i lumtur, jo vetëm për ndikimin që ka patur në formimin tim si gazetar gjatë kohës që drejtonte “Ushtimën e Maleve” (kur me mbështetjen e tij u afirmova dhe botova qindra reportazhe, skica e fejtone), por edhe për vlerësimin që bëri në promovimin e librit tim “Memoria historike e Kombit”, ku në praninë e elitës krijuese të kryeqytetit në sallën e madhe të Akademisë e Shkencave në Tiranë, ai e vlerësoi librin tim si një vlerë të shtuar në letërsinë tonë dokumentare dhe në historinë e lavdishme të Shqipërisë.



Velo Cfarku mes familjarëve

Mësues Xhelali është një bletërritës shumë i kujdesshëm e pemëtar që din të shartojë, krasisë e kryejë të gjitha shërbimet kulturore. Ai është i dhimbshëm e njerëzor...

Nga Dr. SELMAN MEZIU

Pikërisht aty ku mbaronte toka e fillonte ura u ndal autobusi i vogël. Mëngjesi ishte shfaqur me rrezet e diellit mbi kodrën e Gjarecës. Ato i jepnin reflekse edhe ujit gjarpërues të lumit Drin e Murrës. Ndërsa kodra e Shënë Diellit veshur me shkurre e lule të verdha na përshëndeste të gjithëve. Një emërtim që përfaqëson një shejtëri pellazge.

Në vendin e parë, njoha sakaq mësuesin tim të historisë. Pasi e përshëndeta me për-mallim u ula afër sediljes të fundit. Mësuesi më pyeti përsëri për shëndetin, familjen, punën etj. Kuptohet ju përgjigja dhe bëra edhe unë të njëjtin respekt. Ndërsa autobusi i vogël ecte mbi asfaltin, ku nuk i mungonin gropëzat, kanalet e për rrjedhojë, tronditjet. Mua më vinin si shkurmetza të bardha kujtimet ledhatuese shkollore. Vërtet kisha së paku mbi tridhjetë e pesë vjet pa u takuar, pyetur, çmallur e shpurpurisur kujtimet. Nuk e di pse ai m'u duk i afërt, gojëamël, i qetë, e sikur më thirri emrin për në dërrasë të zezë. Sakaq unë fillova t'i flas për Mesopotamin e lashtë, për Zhan Dark, për kryengritjen çar-tiste angleze, revolucionin rus, Jul Çezarin, Garibaldin, Spartakun e Romës dhe Aleksan-drin e madh të ashtuquajtur, Maqedonas. Kaq shumë kisha humbur në kujtime sa që nuk pashë se kur zbritën bashkë fshatarët e mi. Pasi pagova, dola jashtë dhe ftova mësuesin tim Xhelalin bashkë me Kapllan Pirën për kafe. U ulëm në një nga kafenetë e qytetit të Peshkopisë. Fatmirësisht ato në demokracinë tridhjetë vjeçare nuk mungo-jnë. Në çdo pjesëz të ditës do ti shikosh plot e përplot.

Ndër të tjera mësuesi im tanimë me kapele me strehë, i veshur hijshëm, pastër, plot nur. Vetëm fytyra e tij gjatoshë e dy sy që lëviznin qetësisht nuk i mungonin ende. Ndërsa qëndrimin serioz e si mësues autoritar nuk po e dalloja. Ruante atë kulturë e edukatë prej mësuesi qëkur e njoha unë, në vitin 1971. Kur filloi të flasë, m'u kujtua zëri i tij, kur shpjegonte në dërrasë të zezë (veçse atëherë ai ishte më i hollë e me plot muzikalitet), me titullin e mësimit e disa çështje kryesore të tij që i shkruante në dër-rasë të zezë me shkumësin e bardhë. Hera herës merrte shkopin e hollë me majë dhe një lidhëse në pjesën e trashë, e na tregonte në hartën fizike, zhvillimin e betejave të ndryshme. Mësues Xhelali e filloi kështu bisedën:

-Edhe pse kemi shumë që nuk jemi takuar, unë ndjek shkrimet tuaja te gazeta "Rruga e Arbërit", të cilën e blej çdo fund muaji. Më pëlqen shumë ajo. Gëzohem, që një ish nxansi im shkruan. Kam të drejtë të mendoj se në formimin tuaj është plazmuar edhe puna ime mësimore dhe edukative.

- Sigurisht,- ju përgjigja, - edhe unë krenohem me mësuesit e mi, sot u çmalla me juve, edhe pse duhet të ndahemi për arsye pune. Por dëshiroja të vija në provë, se sa i mban mend mësuesit tuaj, karakterin e sjelljen e tyre.

Ndërtesa e shkollës fillore në Kalivaç u ndërtua gjatë viteve 1945 - 1946. Unë (Lindur 02.05.1945) e fillova klasën e parë me mësues Bajram Ndreun nga Zall Dadha, gjatë viteve 1950 - 1951, zani i tij ishte kumbues dhe kur i shqiptonte shkronjat, i ndante fjalët në rrokje, ato të hynin vetëvetiu në tru. Më pas vazhdova me Sadik Toçin nga Luznia, Beqir Loshën nga Kishaveci dhe e mbylla vitin e katërt (1953- 1954) me mësuesin Ramadan Lika, bashkëfshatarin tim nga Shehri i Vajmdheve. Ato visheshin mjaft thjesht, edhe me opinga e veshje kombëtare, por në mësim ato sillleshin si mësonjtor të zellshëm e edukues të mirë.

Klasën e pestë e fillova në Fushë - Muhur, gjatë viteve 1956 – 1957 me drejtor shkollë

Mall dhe krenari për mësuesin tim



Muhamet Xhembulla. Ndërsa djalin e tij Nebiun e kam patur koleg, pas viteve '90 i cili jepte landën e letërsisë. I ngjante shume babait, prandaj unë kisha respekt të madh. Më dukesh se kisha pranë ose koleg ish drejtorin tim.

Më kujtohen edhe mësuesit e tjerë, në shkollën shtatë vjeçare, por, do të veçoi mësuesin e matematikës Lutfi Pira nga Kishaveci, mësuesin e Gjuhë - Letërsi Hysni Bruçi, i cili ishte nga Lukani e më vonë u ba i muhurak, ndërsa Histori - Gjeografinë, na jepte Rexhep Bardulla nga Peshkopia dhe së fundi Muzikën ma mësonte Bedri Shehu nga Dibra e madhe me banim në Peshkopi. Ku secili prej tyre kishte veçorit e veta në shp-jegim e sjellje. Mësues Lutfiu ishte i rreptë, të gjithë e kishim frikë, por, shpjegonte mirë. Kurse Hysniu përpiqesh të shpjegonte qart, rregullat gramatikore dhe nuk të falte gabimet në hartime. Ndërsa Bedri Shehu i binte violinës.

Rezultatet shumë të mira në shtatë vjeçare dhe provimet përfundimtare, më hapën udhën e studimeve në shkollën pedagogjike Peshkopi, ku gjeta nxanës të ardhur nga Mati, Librazhdi, Mirdita, Kukësi, Hasi e Dibra. Fillova shkollën për mësuesi, gjatë viteve 1961- 1965 me Drejtor Zenel Sula.

Ndërsa nuk mund të mos përmend mësuesit e disiplinave, ma të randësishme, që mësonim në shkollë, si Pedagogji me mësues Kolë Tahiri, ku mësova elementët e reja të një shkence që do të më shërbente në profe-sionin e mësuesisë. Matematikën na e jepte

Të shkruash për mësuesin është e vështirë, se ai është psikolog, ku njeh mirë karakteret e din të sillet me secilin prej tyre, duke të imponuar respektin e dashurinë. Kështu ishte mësues Xhelali. Sigurisht edhe metodist e gjithmonë i përgatitur për të shpjeguar leksionet e radhës. Ndaj, kur thuhet se nxënësi është pasqyrë e mësuesit, kështu vërtet ishinqindra breza që përgatiti mësues Xhelali nga Grykë Noka, në Fushë Muhur, Sinë, Arras e së fundi në gjimnazin e qytetit të Peshkopisë.

Ismail Erebara dhe më vone Kadri Zhulali, në vazhdim landën e fizikës me Nikoll Radën, gjuhë letërsinë ma mësonte Lutfi Hankun, i cili tani është autor i disa librave me tregime dhe romane. Së fundi muzikën e mësonim me Osman Turja. Nga të gjithë këto shken-ca, nga shpjegimi me plotë art e mjeshtri, nga mësuesit e mësipërm, të mrekullueshëm, unë mësova artin e të dhanurit mësim, u edu-kova dhe u pajisa me njohuri të reja, i aftë t'i transmetoja tek nxanësit e mi të ardhshëm.

Por, akoma nuk kam mbaruar, se nga 105 nxanës, e mbaruam shkollën pedagogjike 104, sepse nxansi Dedë Doda mbeti për vjeshtë. Dhe më tej, vetëm shtatë prej tyre, shkuaam në universitet si Kujtim Leka nga Zogjejt e Dibrës, Kapllan Harizaj, Fadil Marku,e ndonjë tjetër dhe unë, Xhelal Meta nga krahina e Muhurit.

Nuk munda t'iu përballoj mësuesi im. Paskeni kujtesën shumë të fuqishme,- e ndërpreva unë,- të lutem ma jepni të shkruar veprimtarinë tuaj si mësues.

Dhe kështu vepruam. Pasi mbaroi fakulte-tin Histori - Gjeografi mësuesi i sapo diplo-muar Xhelal Meta u caktua të punoi për dy vjet në Grykë - Nok të krahinës së Çidhnës. Ku filloi t'iu jap jetë studimeve të marruna në shkolla. Pedagogjinë e psikologjinë, artin e mesimdhanjes, dhe landën e historisë që nga prehistori, ajo antike, e lashtë, e kohës së mesme dhe deri në ditët tona.

Nuk vonoi shumë dhe në vitin 1971 kthe-het në shkollën tetëvjeçare "Nexhat Agolli,, Fushë - Muhur ku jep landën e historisë deri

në vitin 1977. Djaloshi i ri gjashte ditët e javës bante rrugën Sheher - Fushë Muhur, në kam, shkuarje dhe kthim. Pas dite përgatiste ditarin, korrigjonet provimet kur ato ishin dhe ndiqte me korrektësi orarin, por, kjo nuk ishte e gjitha. Ai punoi plotë zell, përkushtim e pasion në përgatitjen e stendave të historisë për muzeun e krahinës së Muhurit që ishte brenda shtëpisë të kulturës. dhe në përgatit-jen e grupeve artistike etj.

Pastaj për trembëdhjetë vjet ai ban me kam Sheher në mes dy Sinave ku ishte shkol-la tetë vjeçare. Atje, jo vetëm jepte mësimin e landës së historisë por edhe fizkulturë dhe muzikë. Dhe jo vetëm, por, u aktivizua në ngritjen e Muzeut të Kastrotëve në Sinë të Poshtme. Vlerat e tij shprehen me plotë energji, në cilësitë e artistit e organizatorit në përgatitjen e grupeve artistike. Sigurisht konkurronin me të gjitha shkollat e rrethi të dibrës e më tej.

Mësuesin Meta, tanimë, me një përvoje pune të gjatë në mësuesi, me rezultatet e mira në kalueshmëri, me një mësimdhënie korrekte e lartësi pedagogjike, dërgohet në shkolla të ndryshme. Ne vitin 1990- 1992 rikthehet në shkollën tetë vjeçare në Fushë - Muhur, më pas përsëri në Sine. Vetëm një vit atje dhe ne vitin shkollor 1993-1994 emërohet drejtor shkollë në fshatin ku kishte kryer shtatëvjeçaren.

Por detyra e mësuesit, edukatorit të brezit të ri, nevoja për atë e detyron seksionin e arsimit Peshkopi ta dërgojë mësues historie etj., si dhe zv/drejtor në shkollën tetë vjeçare në Arras nga viti 1994 - 2000. Duke kryer me sukses detyrën dhe përballuar situata e vështira të tranzicionit ekonomik e politik që ishin manifestuar edhe te rina shkollore ne sjelljet e tyre.

Përsëri rikthehet, tani ma me detyrën e drejtorit në shkollën tetë vjeçare Fushë - Muhur, për katër vjet. Dhe së fundi e mbyll punën e zellshme e plotë pasion të mësuesit, edukatorit në gjimnazin e Peshkopisë nga viti 2004 - 2007. Duke përballuar lodhjen fizike dhe përgatitjen e përditshme, për të dhanun mësim, tanimë në gjimnaz e Pes-hkopisë ku kërkohej përgatitja më e thellë dhe sistematike në disiplinën e historisë dhe gjeografisë.

Por portreti i tij është më i gjerë. Ai është i mbushur me mjeshtri nga ma të ndryshmet. Kuptohet ia kërkonte jeta e fshatit, familja që duhesh krijuar e çuar përpara. Kur mu-ratorët i ndërtuan shtëpinë e re, mësuesi Meta u kthye në një suvatues i shkëlqyer. Jo vetëm që përdorte e dinte të bënte fashat por edhe t'i suvatonte e në tavane bëri lule të ndryshme ndërsa në ballin e oxhakut ai skaliti shqiponjën.

Ndërsa nuk mund të lemë pa përmendur që ai është një bletërritës shumë i kuj-desshëm e pemëtar që din të shartoi, krasis e kryej të gjitha shërbimet kulturore. Mësues Xhelali është i dhimbshëm e njerëzor. Ai kërkon të argëtohet nëpërmjet gjuetisë ku akoma ka çiften të mbajtur pastër e me kujdes dhe xherdanin me kapsollat e saja.

Te shkruash për mësuesin është e vështire se ai është psikolog ku njeh mirë karakteret, e din të sillet me secilin prej tyre duke të imponuar respektin e dashurinë, kështu ishte mësues Xhelali. Sigurisht edhe metodist e gjithmonë i përgatitur për të shpjeguar lek-sionet e radhës. Ndaj kur thuhet se nxënësi është pasqyrë e mësuesit, kështu vërtet ishinqindra breza që përgatiti mësues Xhelali nga Grykë Noka, në Fushë Muhur, Sinë, Arras e së fundi në gjimnazin e qytetit të Peshkop-isë. Ai mbeti shembulli vyer për kolegët me të rinj, ndihmësi dhe kolegu përherë i respektuar.



Molla Vebi Ferati, enciklopedist i rrallë, figurë popullore

Nga Dr.Fejzulla GJABRI

Molla Vebi Ferati i njohur si Hoxhë Çernjeva apo Hoxha i Madh, personalitet që bashkon Rilindjen Kombëtare me kohët moderne

Molla Vebia ishte dhe mbetet ndër figurat kryesore fetare dhe më tej këtyre figurave më të njohura e më të përmendura të viseve veriore dhe të Komunitetit Mysliman Shqiptar. Edhe në ditët e sotme, megjithëse kanë kaluar 70 vjet nga ndarja e tij nga jeta, thuhet: “Ka thënë Molla Vebia”. Ata që e kanë njohur, jo vetëm nxënësit e tij, por gjithë ata që e njohën e dëgjuan fjalët e tij, (ndër të cilët edhe Abaz Zaimi) flisnin me respekt dhe e quanin “gojëbilbili ynë”.

KOHA

Në rrafshin historik, jeta e Molla Vebi Feratit, përkon me periudhën kur populli shqiptar kërkonte të shkëputej nga Perandoria Osmane, jo vetëm si shtet më vete, por edhe si mentalitet tashmë me vetëdije kombëtare.

Në këto kushte ndihej nevoja e emancipimit shkencor dhe qytetar europian, ndonëse ende nuk ishte e aftë shoqëria e asaj kohe ta kapërdinte dhe udhëheqësia ta drejtonte në atë rrugë. Në anët tona, me Dibër, Lumë e më tej, me Kosovë e vise tjera shqiptare, popullit iu desh që së pari të përballohej agresioni i fqinjëve, nga Veriu në Jug.

Pikërisht në këto vite jetoj dhe punoi Molla Vebi Ferati. Ai jetoj dhe u shkollua në kohën e Turqisë e më pas provoi kohën e zisë së Nemces, luftoi kundër serbëve e krahas përballimit të vështirësive, ndihmoi në zhvillimin kulturor në kohën e Mbretërisë, duke kaluar Luftën e Dytë Botërore, për të provuar dhe vitet e para të komunizmit, deri në kërcënim të jetës, pasi parashikoi sundimin komunist: “O katërdhjetë ditë, o katërdhjetë vjet do i kemi në shpinë këta”.

Vebi Ferati, lindi në Cernjevë më 1886 dhe u rsimua në Stamboll për drejtues (imam), jurispondencë islame dhe mjekësi. Njihet ndër imamët më aftë, më të diturit dhe më të urtët në Kala të Dodës dhe në fshatrat përreth. Kudo që punoi ai ka lënë emër të mirë në ligjërimin që jepte. Pranë xhamisë me emrin e tij në Çernjevës, për disa vite ka funksionuar mejtepi - shkollë katër klasëshe, e drejtuar nga Molla Vebia. Vepra e tij emancipuese ka qenë në konflikt me formimin ditorur dhe mjedisin e kohës, veçanërisht pas vitit 1944. Disa herë deshën ta dënonin. Ndërroi jetë në vitin 1949.

SHKOLLIMI

Molla Vebi Ferati në rininë e tij, mori mësimet e para kryesisht fetare në vendlindje, ku dallohej për dhunti në interesin e dijeve. Për dhuntitë e ligjërimin dhe të interesit për dije, çka tregonte se me shkollim, do ishte më vonë një intelektual e dijetar i shquar.



Molla Vebi Ferati

Mësuesit a atyre viteve (se në Radomirë kishte shkollë katër klasëshe nga viti 1900), panë te Vebiu i ri shkëndija të një dijetari të ardhshëm dhe kërkuan që familja ta dërgonte në shkollë. Dimë se në Radomirë kishte një shkollë që hap në vitin 1902 (1318), me mësues Hafuz Nexhipin, me arsim teologjik. Në këtë shkollë mësohej dije fetare, kryesisht nga Kurani. Pas vitit 1909 në këtë shkollë jepeshin disa lëndë, si Abetare arabisht, lexim Kurani, dije fetare, gramatikë (për mësimin e Kuranit), histori osmane, njohuri gjeografie, aritmetikë elementare, ortografi dhe bukurshkrim. Aty nisi dijet Vebi Ferati, për ta njohë edhe shkolla në Stamboll, edhe Kalaja e Dodës, Luma, Dibra, Shkodra e më tej, për të dhënë kontribut edhe në Komunitetin Mysliman Shqiptar, si një nga juristët më të përgatitur.

Mësuesit e asaj kohe, Vebiun e kishin mes nxënësve të grupit të pare pra ndër më të mirët, prandaj i sugjeruan familjes që të vazhdonte shkollën më tej. Më 1886 nis shkollën Ruzhdije në Stamboll dhe pas katër vitesh kryen arsimin e lartë po në Stamboll për drejtues (imam) dhe jurispondencë islame. Krahas këtyre degëve, kreu dhe fakultetin e Mjekësisë. Pra, mori përgatitje të shumanshme. Megjithëse u përgatiti si imam, ai studioi më së shumti jurispondencë. Përveç gjuhës amtare, ai zotëronte edhe disa gjuhë të huaja si turqisht, arabisht, persisht dhe frëngjisht dhe ishte njohës i thellë dhe shtjellues i shkencave të natyrës dhe i atyre shoqërore.

MËSUES, FILOZOF DHE SHKENCËTAR

Dituritë e tij ishin të gjithanshme, ndër të cilat, dhe si shkoqitës i dukurive dhe fenomeneve natyrore e shoqërore. Pas formimit si hoxhë me dije dhe kulturë islame lindore, molla Vebiu i shtriu interesat e tij për dije shkencore. Studimet në mjekësi

Molla Vebia mbetet një shkencëtar dhe dijepërhapës i tyre, enciklopedist i rrallë, që edhe sot, pas 70 vjetësh nuk është përsëritur, duke mbetur një figurë e përmasave kombëtare, që rrallë dalin. Jeta e tij është një mësim që ka vazhduar për një gjysmë shekulli me urtësinë e tij, për të mbetur dijetar dhe mësues i vendosur, enciklopedist i rrallë, figurë e dashur popullore.

dhe jurispondencë ndikuan në mbi formimin me dijet dhe shkencat perëndimore europiane. Studioi në shkencat e natyrës dhe ato shoqërore, pa lënë aspak pas dore studimet në lëndët fetare. Më vonë, sipas bashkëkohësve, do thoshte vetë në ligjërimet e tij, “se ato (shkenca dhe feja) janë të lidhura fort me njëra tjetrën). Nxënësit e tij, thonë, se na fliste për dijetarë e shkencëtarë të botës (të Islamit dhe të feve të tjera), ndër të cilët dhe për një shqiptar nga Çamëria, që, kur i përpërmendte emrin, i thonte ‘dijetari ynë i madh’ Hoxha Tasin. Njëri nga nxënësit e tij që më vonë kreu Medresen në Tiranë thotë se “Molla Vebia kishte disa libra të Hoxha Tahsinin, nga ku citonte fjalë nga veprat e tij, si “Historia e qenies, ose e krijimit”, “Sekretet e ujit dhe të ajrit”, pjesë nga “Psikologjia” e tij, nga dijeve filozofike, shkencave të natyrës, matematikës, astronomisë etj.” Kur u njoftua se njeriu zbriti në hanë (në vitet 1960), e pyetën ‘se a asht e mundur’ ai kishte argumentuar mundësitë jo vetëm të këtij zhvillimi, por edhe për zbulime të tjera shkencore.

Dituritë dhe fjalat e tij emancipuese ka qenë në konflikt me formimin ditorur dhe mjedisin e vendit ku shërbeu dhe jetoj. Ai njihej si Hoxha i Madh, pasi kishte edhe të tjerë imamë që drejtonin xhamitë e mësonin fëmijët ndër mejtepe.

Jeta e këtij hoxhe nuk është veçse një mësim që ka vazhduar për një gjysmë shekulli; ai e kaloi gjithë jetën duke lexuar dhe duke mësuar të tjerët. Përpjekjet dhe dëshira e tij e zjarrtë përqendroheshin në dy gjëra: E para, dëshironte t’i shtonte njohuritë që kishte fituar, duke hedhur përherë e më shumë nga një hap përpara, për t’iu afruar “së vërtetës”.

Duke përmendur e cituar njerëz të dijes si Hoxha Tahsinin, me fjalën e tij të ëmbël, tërhiqte shumë njerëz të krahinës, mes tyre dhe me tituj të lartë fetarësi hafizë e krahinarë me detyra drejtuese të kohës.

Molla Vebia me dituritë e tij, mbetet në krye të dijetarëve të Kalasë Dodës e më tej. Rrallë si ai, përveçse, zotëronte dituritë e lëmit fetar, zotëronte dhe dinte të shpjegonte dhe dije nga shkencat e natyrës e ato shoqërore. Për këto të fundit nxënësit e tij transmetonin pjesë nga ligjëratat e tij. Molla Xhemali, edhe pse thonte se “nuk di”, kur vinte fjala për Molla Vebinë, përmendte një pjesë nga thëniet e tij, si “Mbarë njerëzimin, të cilin e shikojmë dhe e njohim, Molla Vebia thojte se janë si një familje e përbashkët. Të gjithë njerëzit i shikonte si vëllezër të një gjaku. Molla Vebia mërzipte kur dëgjonte grindje ndërmjet njerëzve apo kur shihte fukarenj. Thonte se “njerëzimi në ka shumë nevojë për përmirësime të gjendjes së tij dhe për zhvillim”.

Molla Vebia mbetet një shkencëtar dhe dijepërhapës i tyre, enciklopedist i rrallë, që edhe sot, pas 70 vjetësh nuk është përsëritur, duke mbetur një figurë e përmasave kombëtare, që rrallë dalin. Themi figurë e përmasave kombëtare, pasi kaloi pothuajse në çdo rreth të Shqipërisë në shërbim të Komunitetit Mysliman Shqiptar, anëtar i të cilit ishte. Për shumë vite ndihmoi për zgjidhjen e problemeve mes fshatrave apo rretheve, duke i trajtuar problemet juridikisht. Kur vendoste Molla Vebia, të gjithë heshtnin.

Jeta e këtij hoxhe nuk është veçse një mësim që ka vazhduar për një gjysmë shekulli. Ai e kaloi gjithë jetën duke lexuar dhe duke mësuar të tjerët me dije gjithënjëzore.

Duke përmendur e cituar njerëz të dijes si Hoxha Tahsinin, me fjalën e tij të ëmbël, tërhiqte shumë njerëz të krahinës, mes tyre dhe me tituj të lartë fetarë, si hafizë e krahinarë me detyra drejtuese të kohës. Molla Vebia me dituritë e tij, mbetet në krye të dijetarëve të Kalasë Dodës e më tej. Rrallë si ai, përveçse zotëronte dituritë e lëmit fetar, zotëronte dhe dinte të shpjegonte dhe dije nga shkencat e natyrës e ato shoqërore. Për këto të fundit nxënësit e tij i transmetonin pjesë nga ligjëratat e tij. Njëri nga ata, Molla Xhemali, edhe pse thoshte se “nuk di”, kur vinte fjala për Molla Vebinë, përmendte një pjesë nga thëniet e tij, si: “Mbarë njerëzimin, të cilin e shikojmë dhe e njohim, Molla Vebia thojte se janë si një familje e përbashkët. Të gjithë njerëzit i shikonte si vëllezër të një gjaku. Molla Vebia mërzipte kur dëgjonte grindje ndërmjet njerëzve apo kur shihte fukarenj. Thonte se se “njerëzimi në ka shumë nevojë për përmirësime të gjendjes së tij dhe për zhvillim”.

Molla Vebia mbetet një shkencëtar dhe dijepërhapës i tyre, enciklopedist i rrallë, që edhe sot, pas 70 vjetësh nuk është përsëritur, duke mbetur një figurë e përmasave kombëtare, që rrallë dalin. Jeta e tij është një mësim që ka vazhduar për një gjysmë shekulli me urtësinë e tij, për të mbetur dijetar dhe mësues i vendosur, enciklopedist i rrallë, figurë e dashur popullore.

Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?

SHKRUANI NË GAZETË!

dërgo email në:
rrugaeearberit@gmail.com

Sulejman Mustafa Shehu, i njohur si Sheh Sula i Zërqanit lindi në fshatin Zërqan të rrethit Bulqizë, Dibër, në vitin 1833.

Sheh Sula i Zërqanit, kleriku patriot, pjesëmarrës në të gjitha lëvizjet kombëtare të kohës

Nga HYSEN LIKDISHA

(Vijon nga numri i kaluar)

Ndërkohë që Lidhja Shqiptare e Prizrenit, përpiqej ta shtrinte autoritetin e saj, në viset shqiptare, ishte rritur dukshëm, rreziku i copëtimit të trojeve nga fqinjët. Një situatë e tillë, bëri që të mblidheshin në Stamboll, nën kryesinë e Abdyl Frashërit, Komiteti i Stambollit, ku mori pjesë edhe Sheh Sula i Zërqanit, anëtar i këtij komiteti. Komiteti diskutoi domosdoshmërinë për krijimin e një vilajeti shqiptar, me ushtrinë e vet kombëtare , administratë e shkolla në gjuhën shqipe, si dhe mbrojtjen e çdo pëllëmbë tokë shqiptare.

Fillimisht vendimet e Komitetit të Stambollit, u shtruan për diskutim në Degën e Lidhjes së Prizrenit të Dibrës, që padyshim, ishte nga më aktivet në vend, duke u bërë kështu edhe qendra e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në një situatë të tillë, krerët dibranë, ju vunë punës për organizimin e një kuvendi të jashtëzakonshëm në Dibër, ku përpos aktivistëve të tjerë dibranë, të Degës së Lidhjes së Prizrenit, një rol të rëndësishëm luan edhe Sheh Sula i Zërqanit. Fakti që në këtë kuvend morën pjesë delegatë nga Fusha dhe Malësia, bënte të besueshme se Sheh Sula i Zërqanit, pati dukshëm ndikim, në organizimin e këtij kuvendi. Ja ç’farë shkruan Kristo Frashëri, në librin Historia e Dibrës: “Në Degën e Lidhjes për Dibrën, krahas Iljaz pashës (Qokut,shënimi im) qendronte edhe përfaqësuesi kryesor i maleve, Sulë Zërqani, biri i Sheh Mustafait, ky i fundit një nga udhëheqësit e shquar të luftës së Gjoricës”.

Kuvendi i Dibrës i mbajtur më 14 tetor 1878, miratoi Rezulutën e Komitetit të Stambollit, që drejtohej kundër vendimeve të Kongresit të Berlinit dhe posaçërisht kundër copëtimit të trojeve shqiptare. Menjëherë më pas nis puna për mbajtjen e një kuvendi më të gjerë, po në Dibër. Në përmbushje të këtij zotimi, Sula i Zërqanit, zhvilloi një punë të madhe, duke organizuar takime me banorët lokalë, për sensibilizimin e tyre, në lidhje me nevojën e mbajtjes së këtij kuvendi të madh, i cili u zhvillua më 1nëntor 1878. Rozoluta e miratuar nga kuvendi, evidentonte qartë rrezikun që i kanosej Shqipërisë, prej copëtimit të saj nga monarkitë fqinje..-Ndër personalitetet më të shquara që u solidarizuan me këtë rezolutë dhe e nënshkruan atë, ka qenë edhe Sheh Sula i Zërqanit (Kristo Frashëri, Historia e Dibrës, faqe 268).

Në këtë periudhë, Dibra bëhet dukshëm epiqendra e aktiviteteve të Lidhjes së Prizrenit, duke u bërë njëherësh jo vetëm vatra kryesore e rezistencës kundërosmane, por edhe e rrezikuar nga copëtimi prej fqinjëve.

ABDYL FRASHËRI, NË ZERQAN, TEK SHEH SULA

Lidhja Shqiptare e Prizrenit, pas formimit të saj, dukshëm e zhvendosi qendrën e veprimit të saj, në Dibër, duke e bërë atë një qendër të sigurt, të veprimtarive të saj. Kështu eventet e zhvilluara në Dibër, nuk munguan, ku nga 20-24 tetor 1880, u mbajt në Dibër, një tjetër kuvend i madh, ku morën pjesë 300 delegatë të siguruar nga 5000 vetë të armatosur. Ndër vendimet më të rëndësishme të këtij kuvendi ishte edhe ai për krijimin e një vilajeti të vetëm autonom shqiptar, me një qeveri të përkohshme. Në këtë kuvend mori pjesë edhe Abdyl Frashëri, i cili gjatë kthimit për në Jug, bujti një natë në Teqenë e Zërqanit, tek Sheh Sula. Kjo vizitë e atdhetarit dhe ideologut të lëvizjes sonë kombëtare, veç traditës, ishte një vlerësim për Grykën e Madhe, si zonë e sigurt për atdhetarët. Por natyrisht, qendrimi i Abdyl Frashërit, tek Sheh Sula i Zërqanit, ishte njëherësh edhe një vlerësim për kontributin që kjo teqe, kishte dhënë në dobi të kombit.

Sipas traditës, mikut të largët dhe të nderuar, ju siguroa një mikpritje e ngrohtë. Atë natë, teqeja u mbush plot me burra nga Gryka e Madhe dhe më gjrë, të cilët kishin ardhur për të biseduar me mikun e veçantë për vendimet më të fundit të marra në Kuvendin e Dibrës. Të nesërmen i shoqëruar nga njerëz të sigurtë, Sheh Sula e përcolli mikun e nderuar për në Okshtun tek Hasan (Hoxhë) Moglica.

Që këtu Abdyl Frashëri udhëtoi për në Elbasan, ku edhe u arrestua nga autoritetet ushtarake turke. Ndërkohë Dibra, nën veprimtarinë e patriotëve të lëvizjes kombëtare, ishte ngritur në këmbë, kundër administratës osmane . Në të tilla kushte, valiu i Kosovës, duke e pranuar këtë realitet, kërkon nga Stambolli, që të dërgojë në Dibër, një autoritet të lartë, për ta larguar popullin nga Lidhja Kombëtare Shqiptare. Sheh Sula i Zërqanit, me njerëzit e tij nga Gryka e Madhe dhe Bulqiza, u vu në ballë të rezistencës, për mbrojtjen e administratës, që Lidhja kishte ngritur në këto anë.



INTERNIMI NË TURQI, ATJE KU SHUMË VITE MË PARË, ISHTË INTERNUA I ATI

Forca të shumta ushtarake turke, arritën të shtypin këtë lëvizje të dibranëve, ku më pas autoritetet turke, arritën ta arrestonin edhe Sheh Sulën, të cilin e nisën për në Turqi, në internim, atje ku vite më parë ishte internua edhe i ati.

Në kujtimet e lëna nga i nipi, Sheh Hajredin Shehu, thuhet: “Pas shtypjes së Lidhjes, i ndjeri Sheh Sula, u kap dhe u internua atje ku shume vite më parë ishte internua i ati, Sheh Mustafa, organizatori dhe udhëheqësi i luftës së Gjoricës, më 1844, kundër Hajredin Pashës. Shehu vuajti shumë vite në internim, por nuk i shkëputi në asnjë moment lidhjet me Komitetin Shqiptar të Stambollit. Shehu vuajti për rreth dy vite në internim.. Gjatë viteve të internimit në Stamboll, Shehu nuk e ndërpreu aspak lidhjen me veprimtarët e lëvizjes kombëtare shqiptare, sidomos me Komitetin e Stambollit, ku ishte edhe pjesë e anëtarësisë së tij. Në këtë kuadër, një nga diskutimet që shtrohej për zgjidhje nga Lidhja, ishte dhe mbetej hapja e shkollave private shqipe. Hapja e shkollave shqipe, ishte një kërkesë e kahershme, nga ana e Komitetit të Stambollit, që para mbajtjes së Lidhjes së Prizrenit, krahas asaj për pavarësinë e Shqipërisë dhe moscoptimin e trojeve shqiptare. Kështu Sheh Sula, priste me padurim të lirohej nga internimi, për tu rikthyer në vendlindje Zërqan, për të realizuar misionin e shumëpritur për hapjen e shkollave shqipe. Rreth vitit 1885, kthehet në vendlindje Zërqan.

Ishte moment kur autoritetet turke, kishin nisur përpjekjet për hapjen e shkollave turke, në vendin tonë, gjë që e bënte emergjente për veprimtarët e rilindjes kombëtare shqiptare, hapjen e shkollave në gjuhën shqipe, për të realizuar pavarësinë e Shqipërisë. Në përpjekjet e qarqeve osmane, në sanxhakun e Dibrës, arritën që më 1887, të hapen 11 shkolla private sabiane (turke). Përpjekje për hapjen e shkollave turke, bëheshin edhe në Grykën e Madhe (Zërqan), ku dhe u hap një shkollë e tillë. Autoritetet osmane, në përpjekje për hapjen e shkollave turke, kërkonin të siguronin edhe mbështetjen e autoriteteve vendore, nga radhët e pleqësisë. Kështu në ceremoninë e hapjes së shkollës fillore turke, në Zërqan, u ftua edhe Sheh Sula, prania e të cilit ishte e rëndësishme, si prijës i Grykës së Madhe, njeri me kulturë të gjerë, autoritar e klerik i shquar.

Sipas kujtimeve gojore, të lëna nga një prej grave të ndjera, të shehlerëve të Zërqanit, Xhemile Shehu, që thirrej nënë Tija, (kujtime të mbledhura nga Fadil Shehu), thuhet se Shehu e shfrytëzoi këtë rast, ku duke marrë fjalën theksoi: “Edhe kjo shkollë kulturë jep, por do të ishte më mirë të hapej në gjuhë shqipe”.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Arsimit të Perandorisë Osmane, mësohet zyrtarisht se kjo shkollë fillore turke, në Zërqan, u hap më 1893.

Në këto momente Shehu i shtoi përpjekjet, në realizimin e misionit, për hapjen e shkollave shqipe, në Zërqan. Kështu, ai shton ecejaket, në Dibër të Madhe, ku takohet me Said Najdenin dhe Shaqir Dacin dhe atdhetarë të tjerë, të cilët kishin shtuar përpjekjet për hapjen e shkollave shqipe në Dibër. Shehu bëhet një pjesëmarrës tepër aktiv, në veprimtaritë për hapjen e shkollave shqipe, sidomos në Grykën e Madhe dhe Grykën e Vogël.

SHEH SULA, DREJTUES I SHKOLLËS SË PARË SHQIPE NË ZERQAN

Edhe pse autoritetet turke, ishin hedhur në sulm të hapur, kundër çdo përpjekje për hapje të shkollave shqipe, Sheh Sula, vijon luftën pa u ndalur për këtë qëllim.

Pas shumë përpjekjesh, Shehu arriti që më 1893, të hapë në Zërqan të parën shkollë private fetare, në gjuhën shqipe. Por kjo nuk mjaftonte, pasi duheshin shkolla të mirëfillta shqipe. Ndaj Shehu, vazhdonte të punonte pa u lodhur për këtë qëllim. Kështu nën kujdesin e tij, fillon mësimi i gjuhës shqipe fshehura, nëpërmjet abetareve që silleshin prej Stambollit. Më 27 shkurt 1899, u mblodh Kuvendi i Madh i Dibrës, në

fushën e Qernanicës, afër Sheherit, aty ku mblidheshin zakonisht kuvendet ndërkrahinore të dibranëve, ku si gjithmonë i pranishëm edhe Sheh Sula. Në Kuvendin e Qernanicës morën pjesë më shumë se 1000 vetë, mbase edhe 1500 vetë (Kristo Frashëri, Historia e Dibrës faqe 306). Ndër detyrat e shtruara në këtë Kuvend, krahas të tjerave ishte edhe ajo e lëvrimin të gjuhës amtare, nëpërmjet hapjes së shkollave shqipe (Kristo Frashëri, Historia e Dibrës, faqe 307). Gazeta “Dita”, Sofje, shkruante më 30 nëntor 1901, se veprat shqipe, të botuara jashtë vendit, vinin në Sheher, nëpërmjet Shkupit, shpërndaheshin në fshat me anën e bazave të krijuara në Zërqan, Bulqizë, Homeshe, Bllacë, Bohmovë, Lurë, Gollobordë, Rekë e gjetkë (K.Fashëri, Historia e Dibrës faqe 318). Sheh Sula tepër aktiv, predikonte ndër banorë se vetëm me gjuhë mbrohet atdheu, me shkolla mirësohet kombi. Ndaj e gjithë veprimtarisë e tij në këtë periudhë, ju përkushtua përhapjes së shkrimit shqip..

Kongresi i Dibrës, i vitit 1909, ndër të tjera shtroi nevojën e hapjes së 250 shkollave fillore në gjuhën shqipe. Në Grykën e Madhe, hapja e këtyre shkollave, kishte mbështetjen e madhe të Sheh Sulës, i cili vijonte punën prej vitesh për këtë qëllim. Në një raport nga Durrësi, që mban datën 11 maj 1910, nr. 16, mësojmë se Fuat Beu (Dibra), kishte hapur dy shkolla fillore private, një në Tiranë dhe një në Zërqan. Më tej në këtë raport shënohet se drejtimi i shkollës së Zërqanit, është në duart e Shehut Sula. Kështu ndërtimi i godinës dhe e gjithë veprimtaria mësimore e kësaj shkolle, u bë nga Sheh Sula. Godina ka shërbyer si shkollë për vite me radhë dhe mbas çlirimit të vendit, ka shërbyer si PTT, aktualisht edhe sot qëndron në këmbë. Shehu ishte njeriu më i gjetur në këtë



detyrë, dashamirës, kontribues, mbi të gjitha falë kulturës së gjerë, një drejtues i vlefshëm. Shkolla shqipe e Zërqanit, ishte ndër filizat e para, të arsimit shqip, në zonën e Dibrës dhe më gjerë. Pas kësaj përpjekjet e Sheh Sulës, në fushën arsimore vijuan më tej. Shehu i shtoi lidhjet me atdhetarë nga Dibra e Madhe, veçanërisht me Haziz Menzelxhiun, Iljaz Pashë Qokun etj. Nga ata siguronte libra në gjuhën shqipe, që fshehurazi vinin në Zërqan. Në këtë periudhë lufta për hapjen e shkollave shqipe, kishin përfshirë dy Dibrat, Malësinë dhe Matin. Hapja e shkollës së parë shqipe private në Zërqan, ishte kurorëzim i përpjekjeve të kahershme të banorëve të kësaj krahine, nën drejtimin e Sheh Sulës. Kjo ishte ndër filizat e para, të arsimit shqip, në këtë zonë, ku terrori i pushtetit turk, ishte shumë i

Dega e Lidhjes së Prizrenit në Dibër, nga më aktivet në vend, ku Sheh Sula i Zerqanit, luan një rol të rëndësishëm

egër.. Shtypi i asaj kohe shkruante se dibranët kërkojnë 500 abetare shqip, sepse i kanë hyrë mësimit të gjuhës shqipe, që është aq e mirë, aq e bukur. Në këto përpjekje, përveç Sheh Sulës, ndihmesë dhanë edhe veprimtarë të tjerë nga gryka e Madhe si, Ismail Kurti, Riza Shehu, Hajdar Sula, Mustafa Sula, Ram Ceka, Mehmet Myrtezai, Ali Kaçani etj. Shkolla shqipe e Zerqanit nuk e pati jetën e gjatë, vetëm dy muaj, pasi u mbyll nga ndërhyrja represive e forcave ushtarake turke, të Shefqet Tërgut Pashës. Masat represive që ndërmorën osmanët, nuk e tërhoqën Shehun për asnjë moment, në përpjekjet e tij, për arsimin shqip. Përkundër kësaj ai vazhdon luftën kundër përpjekjeve të autoriteteve turke, për hapjen e shkollave me arfe arabe.

SHEH SULA, REFUZON FTESËN E SULLTANIT, PËR NË STAMBOLL

Kthimi i Sheh Sulës, nga internimi, në vendlindje Zerqan, përkoi me përpjekjet që bëheshin, për thirrjen e Kuvendit të Dibrës, 1899. Komisioni nismëtar që merrej me thirrjen e tij, kishte tek Sheh Sula një njeri të sigurtë, i cili u ofroi atyre gjithë mbështetjen e tij.

Kuvendi formoi një Beslidhje, nga ku u krijua edhe Komiteti i Lidhjes. Gjatë viteve 1900-1901, Porta e Lartë mori një sere veprimesh të ashpra, për shtypjen e beslidhjes së Dibrës. Për zbutjen e situatës, Porta e Lartë, ndërmori një sërë reformash, ndër ta edhe lidhjen me rrugë të Dibrës me Manastirin. Po në këtë kuadër, më 1901, Sulltani, ftoi në Stamboll, krerët e Dibrës, ndër ta edhe Sheh Sulën e Zerqanit. Fakti që në Stamboll, së bashku me krerët e tjerë të Dibrës, ftohej edhe Sheh Sulejman Zerqani, dëshmon se tashmë ai vlerësohej ndër krerët më me influencë, në sanxhakun e Dibrës. Jo vetëm Sheh Sula, por edhe krerët e tjerë, kishin shprehur mosbesim, ndaj reformave që po ndërmernte Porta e Lartë. Ata nuk mund të harronin rastet kur krerë të tillë të ftuar nga autoritetet e larta turke, kishin përfunduar të asgjësuar fizikisht, në pusirat e ngritura ndaj tyre. Kështu ftesa e Sulltanit, u bë object diskutimesh, në takimet krahinore. Për këtë arsye, populli i krahinave, reciprokisht nuk dha pëlqimin, për vajtjen e tyre në Stamboll.

PJESËMARRËS NË LËVIZJET ATDHETARE, TË FILLIM SHEKULLIT TË 20-TË.

Pas Kuvendit të Dibrës 1909, Sheh Sula e zgjeroi veprimtarinë atdhetare, veçanërisht në prag të kryengritjeve të mëdha të viteve 1909-1912.

Në prill të 1910, Sheh Sula me vullnetarë nga Gryka e Madhe (Zerqani), shkon në ndihmë të Kosovës, kundër ushtrisë turke, të drejtuar nga Shefqet Tërgut Pasha. Gjatë vitit 1911, Shehu i teqes së Zerqanit, bëhet inicues i disa takimeve, ku diskutohet për të ardhmen e vendit. Sipas trashëgimisë gojore, të teqesë, mbledhur nga Fadil Shehu, mësohet se një takim i tillë u organizua e zhvillua nga shehu i Zerqanit, në teqen e tij, në mars të vitit 1911. Erdhën aty për të marrë pjesë krerë nga Gryka e Madhe, Gryka e Vogël, Bulqiza, si dhe njerëz të thjeshtë, atdhetarë të lëvizjes për pavarësi. Autoritetet turke, sapo mësojnë për këtë takim, ndërhyjnë për ta kthyer atë në favorin e tyre. Ndërkaq debatet mes tyre ashpërsohen së tepërmi. Për ta zgjidhur situatën, Sheh Sula, bisedon me Zenel Hoxhën e Gjurasit, i cili u merr leje të pranishmëve dhe del jashtë. Pas pak, Zeneli rikthehet në dhomë ku debatet vazhdonin. Në kokë mbi qeleshen e vjetër, kishte vënë një të re, bardh si bora. Të pranishmit e kuptuan alegorinë e këtij veprimi, që përkthehej; “se tani e mbrapa, ata duhej të kapeshin mbas të resë (lufta për pavarësi), e të flaknin tutje të vjetrën, që për ta ishte pushteti turk. Myslim Shehu, në kujtimet e tij shkruan; - “Sheh Sula qe i pari që ngriti 12 katundet e Grykës së Madhe dhe të Bulqizës, kundër turqëve të rinj, t’u kërkuar të drejtat kombëtare, kërkesa këto të njëjta me ato të Kosovës”.

Gjatë pranverës së 1912, tubimet e parisë dibrane, pasojnë njëri tjetrit. Kështu një i tillë zhvillohet në mars të 1912, tek varret e Shupenzës, që ndryshe njihet si “itifaku i Shpenzës”. Edhe këtu, Shehi i Zerqanit, spikat me fjalën dhe fuqinë e mendjes.

Autoriteti i padiskutueshëm, në radhët e krerëve dhe njerëzve të thjeshtë, ishte i nevojshëm, për mbajtjen e këtyre kuvendeve, pasi fjala e tij kishte shumë peshë. Të dërguarit e mytesarifit të Dibrës, në këtë kuvend, i kërkuar besë Shehut të Zerqanit. Përgjigja e tij ishte e prerë: “Ne e kemi lidhur një itifak me Turqinë dhe për këtë jemi marrë vesh. Po u respektuan kërkesat tona

dhe ne jemi në itifak”.

Autoritetet turke, në këto takime, nuk arritën asnjë farë marrveshje, përkundrazi në këto lëvizje, dibranët gjithnjë e më shumë ndërgjegjësoheshin në rrugën e kryengritjes së armatosur. Lëvizjet politike, ku prania e Sheh Sulës, ishte shumë e rëndësishme, arritën kulmin, me kuvendin e madh tek Gropa e Ujkut në Homesh, në maj të 1912. Ja ç’farë thuhet për këtë kuvend në Historia e Shqipërisë vol II Tiranë 1984 fq. 196: “Malësorët e Dibrës lidhën besën në kuvendin e dhe’ut, për t’i dëbuar turqit nga treva e tyre”. Në Historinë e Popullit Shqiptarë Vol. II. Tiranë 2002 fq. 478 shkruhet: “Malësorët e Nëntë Maleve të Dibrës së Epërme e Dibrës së Poshtme, thirrën kuvendin e Dhe’ut te vendi i quajtur Gropa të Ujkut. Këtu u kërkuar largimi i forcave ushtarake dhe postave të xhandarmërisë, hapja e shkollave shqipe, anulimi i detyrimeve të vegjëlisë dhe kryerja e shërbimit ushtarak në vend.

Në kryengritjen e përgjithshme dibrane të 1912-ës, Sheh Sula, mbështetësi më i flaktë i kryengritësve nacionalistë të Dibrës. Fillimi i kryengritjes së përgjithshme dibrane në 1912-ën, u shoqërua me dezertime në masë, në radhët e ushtrisë turke. Komitetet e fshehta, në malet e Dibrës, zhvilluan një propagandë të gjithanshme, duke ndikuar kështu drejtpërdrejt në fenomenin e kësaj braktisje, të ushtrisë turke. Në këtë situatë Sheh Sula, përveç kontakteve me krerë kryengritës, e shndërron Grykën e Madhe, në bazë ku gjejnë mbështetje ushtarakët e arratisur. Gryka e Madhe, kishte një pozicion të rëndësishëm strategjik, si atë të hapjes drejt perëndimit, përmes Qafës së Buallit, ashtu edhe drejt Shengjergjit, nga Tërnova.

Myslim Shehu, në kujtimet e tij familjare shkruan: “Më 1912 të gjithë ata oficerë shqiptarë, 14-15 syresh, që ishin në ushtrinë turke, në Dibër të Madhe, u larguan nga ushtria dhe erdhën në teqe, tek Sheh Sula, ku dhe ishin më të sigurt. Ndërsa Haki Stërmilli shkruan: “Të gjithë kryengritësit e Dibrës së Epërme, u tërhoqën në Grykë të Madhe, qendër e kryengritësve caktuar për ta”.

Sheh Sula ishte njeriu më autoritar dhe që gëzonte mbështetjen e kryengritësve, në gjithë Dibrën e Epërme. Me Luftërat ballkanike që nisën në korrik të 1912, çuan në zhvillime të reja, ku vendi rrezikonte copëtimin, si pasojë e lakmive të fqinjëve. Në këto zhvillime të reja, Sheh Sula edhe pse në moshë të thyer, mbi 75 vjeç, ishte koordinatori i rezistencës, të çetave të Grykës së Madhe e Bulqizës.

Myslim Shehu shkruan: “Sheh Sula gjatë luftës ballkanike, me rastin e mësymjes së ushtrisë serbe në vendin tonë, ku Gryka e Madhe ishte porta hyrëse, organizoi mbrojtjen e vendit në dy pika; ura e Spiles, me forcat e Grykës së Madhe, Bulqizës dhe Gollobordës dhe ura e Topojanit me forca të Grykës së Vogël, të udhëhequra nga Mersim Dema. Me formimin e qeverisë së Vlorës, ku pjesëmarrja e Shehut, nuk u mundësua për shkak të moshës së thyer, dilte me rëndësi bashkimi i krahinave rreth saj. Natyrshëm që fjala e Sheh Sulës, ndikonte shumë në këtë drejtim, jo vetëm në Grykë të Madhe, por edhe më gjerë. Për këtë Shehu, kishte gjithë mbështetjen e qeverisë së Vlorës.

Në 1913 e në vijim, aksionet serbe, me sulme të fuqishme ushtarake, në drejtimet Dibër e Madhe - Gollobordë dhe Dibër e Madhe - Zerqan, ndeshën në qëndresë të fortë mbrojtëse, nga banorët e këtyre zonave. Sheh Sula, si gjithmonë, edhe pse mosha nuk ja lejonte, vihet në organizimin e një qëndrese të vendosur, nëpërmjet çetës së Tush Shehut, Hajredin Shehut, nipi i Sheh Sulës, Ymer Previzit dhe Destan Pucës. Kështu në një sulm të trupave serbe dhe mercenarëve të Esat pashë Toptanit, Tush Shehu me çetën e tij, u zuri pritë atyre në Zerqan, për tu dhënë kështu mundësi largimit të fëmijëve dhe pleqve, për të shmangur vrasjet e tyre. Edhe pse fuqitë e lanë, për shkak të moshës së thyer, Sheh Sula, deri sa mbylli sytë, më 1917, në moshën 84 vjeçare, nuk u dorëzua në qëndresën e tij, në mbrojtje të vendit, ku me veprimtarinë dhe bëmat e tij, e ktheu teqenë e Zerqanit, në qendër të nacionalizmit

Veprimtaria e Sheh Sul Zerqanit, për liri e pavarësi, edhe pse u zhvilluan në kuadër të një udhëheqësi krahinor, të Malit të Grykës së Madhe, Zerqanit, e tejkaluan këtë pozicion, duke e radhatur atë përkrah atdhetarëve të mëdhenj të kohës kur jetoi. Për veprimtarinë e tij patriotike, në udhëheqje të malësorëve, në beteja kundër pushtuesve osmanë, si dhe në hapjen e shkollave shqipe, në Grykën e Madhe (Zerqan), është dekoruar, si para ’90, nga ish Presidiumi i Kuvendit Popullor, ashtu edhe pas ’90, nga ish Presidenti i Republikës z. Sali Berisha, në vitin 1993.

EKSPOZITË KUSHTUAR HEROIT KOMBËTAR GJERGJ KASTRIOTI - SKËNDERBEUT

“Lirinë e gjeta këtu”



Foto: Pamje nga ceremonia e hapjes së ekspozitës

Nga **VALDRIN VLESHA**

Në datën 2 dhe 3 mars 2020, në hollin e Pallatit të Kulturës “Haki Stërmilli” Dibër, u hap ekspozita me titull “Lirinë e gjeta këtu”. Kjo ekspozitë përmbante piktura, dorëshkrime, libra, revista etj, kushtuar jetës dhe historisë së Heroit Kombëtar, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu.

Rrugëtimi i kësaj ekspozite ka nisur fillimish në datën 17 janar 2018 në Bibliotekën Kombëtare “Pjetër Bogdani” me rastin e vitit mbarëkombëtarë “Skënderbej”, dhe nga Prishtina ka marrë rrugën për në qytete të tjera të Kosovës, e më pas është ekspozuar në Ulqin dhe Kroaci.

Bashkëpunimi midis Bibliotekës Universitare të Zagabit dhe asaj të Kosovës arritën ti shtojnë kësaj ekspozite dy vepra të autorit Marin Barletit. Botimi i vitit 1533 në gjermanisht i Ausburgut dhe botimi në latinisht i vitit 1473 i shtypur në Zagreb në shtypshkronjën e shquar të Mbretërisë së Kroacisë nga Gjon Pagëzuesi.

Kjo ekspozitë përmbante rreth 358 njësi bibliografike, nga të cilat 158 janë libra monografikë dhe pjesa tjetër janë shkrime të ndryshme.

Ekspozita u bë e mundur falë bashkëpunimit të Muzeut të Kastriotëve dhe Bibliotekës Kombëtare “Pjetër Budi” Kosovë. Vlen për tu theksuar se kjo ekspozite ka karakter ndërkombëtar dhe për të parën herë mbahet në vendlindjen e heroit tonë, në Dibër.

Personi përgjegjës nga Biblioteka e Kosovës, znj. Zaide Krapit bashkë me stafin e saj prej 7 vetash, u pritën nga Valdrin Vlesha, njëkohësisht organizator dhe cicëron në Muzeun e Kastriotëve, në praninë e tre studiuesve dibranë. Ai ju bëri një guidë në vendet ku mbajnë toponiminë me emrat e familjes së Kastriotëve. Miqtë u njohën dhe me shumë legjenda dhe mësuara rreth fushës së Torviollit, ku u zhvillua beteja e parë mes Skënderbeut dhe Sulltanit. Vizitë emocionuese për miqtë ishte në Muzeun e Kastriotëve.

Të pranishëm në këtë ekspozitë ishin autoritet më të larta të rrethit të Dibrës. Të gjithë këto të pranishëm përshëndetën këtë ekspozitë madhështore, ku emocionet shfaqeshin dukshëm te çdo pjesëmarrës. Të pranishmit patën mundësinë që të shohin nga afër libra, piktura, gravura dorëshkrime që u ekspozuan në hollin e Pallatit të Kulturës.

Biblioteka Kombëtare e Kosovës dhuroi 200 tituj nga autor të ndryshëm për pasurimin e Bibliotekës së Qytetit të Peshkopisë, ku dhe ndërmjet të dy institucioneve u bë e mundur binjakëzimi dhe një bashkëpunim 3 vjeçar me të drejtë rinovimi midis tyre.

Botimi i kësaj gazete është punë vullnetare, ndaj çdo pajtim vjetor ose dhurim, është i mirëpritur. Dhurimet pranohen vetëm përmes llogarisë bankare që gjendet më poshtë dhe për çdo rast ai do të bëhet publik. **Raiffeisen Bank, Rr. Kavajës, Tiranë. Swift code: SCSBALTX. IBAN(ALL): AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640**

88 vjet nga Dibra, me tirqit, xhubletën dhe kuslën e bardhë e dibranit, deri te uniforma e ushtrisë amerikane dhe trashëgimia e tij patriotike e atdhetare.

Nga BEQIR SINA – Phoenix Arizona

Në Shtetet e Bashkuara – New York ndërroi jetë në moshën 88 vjeçare një nga veprimtarët e njohur të komunitetit shqiptaro-amerikan, Jonuz Ndreu, ka njoftuar “Zëri i Amerikës”.

“Zëri i Amerikës”, e cila ishte e para që dha lajmin mbi vdekjen e tij, tha se zoti Ndreu vjen nga një familje e njohur patriotike dhe e persekutuar nga regjimi komunist në Shqipëri. Ai është djali i Cen Elezit dhe nip i Elez Isuf Ndreut.

Që në moshë të re, në vitin 1946, kur ishte vetëm 14 vjeç, familja e tij u internua fillimisht në Berat, prej andej në kampin famëkeq të Telepenës dhe më tej u dërgua në fshatrat e Gramshit me punë të detyruar.

Pas tre vitesh internimi, në fund të vitit 1949, ai arrin të arratiset nga Shqipëria, fillimisht shkon në Jugosllavi, prej andej në Itali dhe në vonë në Gjermaninë Perëndimore, ku shërben për 5 vjet me forcat ushtarake amerikane dhe në fund të shërbimit ushtarak emigron në Shtetet e Bashkuara.

Në Amerikë zoti Ndreu ka qenë veprimtar i shquar dhe anëtar i kryesisë së organizatës së njohur “Vatra” të komunitetit shqiptaro-amerikan.

Ceremonia e varrimit u zhvillua ne kushtet e masave te koronavirusit Covid-19, të martën më 7 prill, në shtetin e Nju Xhersit. Në këto kohë të pazakonta për shkak të pandemisë së koronavirusit, në ceremoni, për shkak të ndalimit të grumbullimit të njerëzve, morë pjesë vetëm familjarë,tha “Zëri i Amerikës”.

Lajmi i dhimbshëm preku përveç familjes dhe miqve, të gjithë vatanët, veprimtarët, patriotët e atdhetarët e vërtetë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Familja Ndreu, të afërmit e tij, miqtë e dashamirët humbën njeriun e tyre më të dashur.

Ndërsa shokët, bashkëluftëtarët e pakompromis të luftës disaveçare në mërgim, së bashku me Nuzin, si i thërrisin ata, ata që u rroptuan dhe rrezikuan në atë kohë, në luftën e tyre kundrejt mortajës së kuqe – sllavo-komunizmit e veglave të tyre në diasporë, humbën bashkëluftëtarin.

Humbën një anti-komunist të përбетuar, humbën aktivistin e përkushtuar, anëtarin e këshillit të “Vatrës” për dekada, i cili me aktivitetin dhe bujarinë e vet iu gjet diasporës dhe vendlindjes së tij, pa u kursyer, me donacione dhe ndihma derisa dha shpirt nga shpirti i tij.

JONUZ NDRU NË RRJEDHË TË VITEVE...

Gjenerata e këtyre shqiptarëve në mërgim kujtohet sot e kësaj dite, ka shumë arsye të jetë një gjeneratë e veçantë dhe shumë e nderuar, e respektuar në të gjitha këndshikimet e saj. Mbasi, ajo ka lënë gjurmë jashtëzakonisht të pashlyera, për të gjitha gjeneratat e shqiptarëve në diasporë, në sajë të këtyre burrave, të cilët një pjesë e tyre ikën nga mosha, ndërsa, ata që kanë mbetur dhe janë shumë pak janë duke kaluar vitet e pleqërisë, pranë familjes së tyre dhe larg komunitetit.

Ndërkohë, që për shumicën e mërgimtarëve, është paksa e vështirë të mendohet se mund të rikthehet në diasporën tonë një brez burrash të tillë: kaq atdhetarë, patriotë, demokratë e me aq përkushtim për kombin tonë, pasi edhe vetë kohërat ndryshuan, ishin të tjerë burra, ishin të tjera situata që ndoshta i bënë ata edhe më burra. Mirëpo, padyshim, që ata janë shumë dhe sa herë na vjen një rast jo vetëm i kujtojmë, por tani dhe përulemi përpara veprës së tyre dhe përpiqemi edhe ne të ecim sadopak në gjurmët e tyre.

Jonuz Ndreu ishte një nga ikonat e diasporës ndër vite, mbasi ai është edhe djali i Cen Elezit, nipi i Elez Isufit (Arushës së Malit). Nuz Ndreu, siç i thërrisin, është biri i denjë i njërës prej familjeve më të mëdha shqiptare e njohur si – Familja e Derës së Madhe së Ndreut të Slllovës. Deri në çastet e fundit ai ishte me mendje të kthjelltë dhe me një kujtesë të rrallë, gjithmonë i qeshur dhe bujar, mikpritës, i interesuar dhe konsekuent me çështjen kombëtare.

Në shtëpinë e tij, e cila është një vilë me dhjetëra hektarë tokë, brenda saj ai mbante të

Jonuz Ndreu, aktivist i njohur i mërgatës politike shqiptare



Jonuz Ndreu ishte një nga ikonat e diasporës ndër vite, mbasi ai është edhe djali i Cen Elezit, nipi i Elez Isufit (Arushës së Malit). Nuz Ndreu, siç i thërrisin, është biri i denjë i njërës prej familjeve më të mëdha shqiptare e njohur si – Familja e Derës së Madhe së Ndreut të Slllovës. Deri në çastet e fundit ai ishte me mendje të kthjelltë dhe me një kujtesë të rrallë, gjithmonë i qeshur dhe bujar, mikpritës, i interesuar dhe konsekuent me çështjen kombëtare.

gjitha simbolet kombëtare, prej flamurit kuq e zi, distiktiva me shenja kombëtare, libra, kaseta e videokaseta, revista të gjitha shqip, deri dhe një veshje popullore burrash të Dibrës, tirq, xhubletë dhe kuslë të bardhë.

Ndërsa në tokën përreth shtëpisë e ka një bahçe dibrane, me kumbulla, rrush, arra dhe mollë, rrënjët e të cilave i ka marrë në Dibër.

Jonuz Ndreu njihej nga të gjithë në diasporë si një shembull i pakrahaseshëm gjatë gjithë jetës aktive. Një shqiptar shembullor, patriot, atdhetar, demokrat, familjar, mik e shok i mirë, me gjithë gruan zonjën e nderuar Balen, vajzat që janë bërë me një tufë nipër e mbesa. Jonuz Ndreu ishte një nga simbolet e diasporës shqiptare në Amerikë.

ARRATISJA NGA SHQIPËRIA

U arratis nga skëterra komuniste në vitin 1949 nga kampi i internimit në Rrogozhinë, ku punonte në punë të detyrueshme, në hapjen e rrugës Elbasan – Korçë. Ai i “preu shiritin” e inaugurimit disa kampeve të internimit si në Berat, Kuçovë në vitin 1948, dhe në një kamp afër Tiranës, ku punoi edhe atje në ndërtimin e rrugës Tiranë – Durrës.

“Këtu punuam deri në nëntor të këtij viti, - kujton Nuzi, - pasi më pas na futën në kampin e Valiasit afër Tiranës. Aty si skllëvër kemi hedhur themelet e para të fermës atje, pasi ne të internuarit punonin në kanalizimin dhe sistemimin e tokave”. Në vijim të kujtimeve të tij, ai thotë se: “Në vitin 1949, më 6 maj, kur u arratisëm nga Rrogozhina, ishim nëntë vetë. Gjatë tentimit për kalimin e kufirit rrugës ramë në përpjekje me forcat e ndjekjes. Kemi qenë 9 vetë dhe disa prej tyre sot nuk janë më, si i ndjeri Esat Dineja e Abdulla Kaloshi. Së bashku me ne ishin Muhamet Kadria, Muhamet Begu, Xhelal Dine, Esat Dine, Nikoll Gjon Marku, Tafil Ndreu, Selim Haxhia nga Puka dhe një emigrant kosovar, siç u thërrisnin atëherë shqiptarëve të Kosovës, në Shqipëri.

“AVENTURA” NË BOTËN E LIRË - NJË ËNDËRR E HIDHUR

“Udhëtuam për tre ditë e tre net. Humbëm edhe rrugën, duke rënë në përpjekje në malet e thata e të egra të Skraparit. Gjatë përpjekjeve me forcat e sigurimit të shtetit na mbeti i vrarë

një shok yni i ngushtë, Esat Dineja. U plagos edhe ai djali nga Kosova, që fatkeqësisht nga koha e gjatë nuk ia mbaj mend emrin. Selim Haxhija, që ishte udhëheqësi i grupit tonë, u dorëzua, pasi siç mësuam më vonë, ai kishte qenë kontigjent i sigurimit të shtetit.

Ndërkaq, ne që shpëtuam, pra, vetëm gjashtë vetë, ndërruam drejtim për t’u arratisur, duke ndryshuar rrugën për nga Llixhat e Elbasanit. Aty mbërritëm nga mesnata, duke u ndarë në dy grupe. Grupi i parë isha unë, i ndjeri Abdulla Kaloshi dhe Tafil Ndreu. Grupi i dytë, me Muhamet Kadriun, Xhelal Dinen dhe Nikoll Gjon Marku (i biri i kapëdanit të Mirditës Gjon Mark Gjonit)”, - rrëfen Jonuz Ndreu. Në kujtimet e arratisjes, ai tregon: “Kur mbërritëm në Dibër, studiuam mirë terrenin dhe kaluam natën kufirin ndërshtetëror, duke dalë në tokën e Maqedonisë - katundet e Dibrës së Madhe.

Aty pa pasur kontakte me asnjë njeri, ramë në duart e forcave ushtarake të ish “Jugosllavisë”. Të tre na futën në burg. Në burg si komandat i tij ishte një shqiptar i quajtur Staf Lleshi. Me urdhër të tij qëndruam 21 ditë në izolim dhe po me urdhër të tij, pasi Staf Lleshi bashkëpunonte edhe me Tiranën, na dorëzuan në pikën kufitare Bllatë, te autoritetet shqiptare”.

“Në Shqipëri, - vazhdon duke treguar ai, - qëndruam rreth gjashtë muaj, derisa u arratisëm përsëri, të tre, pa ditur dhe kurrë një gjë, rreth tre shokëve të mbetur që lamë pas në Shqipëri, në tentativën e parë. Ka qenë vjeshtë e vitit 1949, tetor ose fillim nëntori, me sa mbaj mend unë tani, kur ka ardhur djali i Sheh Haxhisë nga Peshkopia, Selami Shehu, duke kërkuar të takohet me ne. Ne ia pranuan takimin që të na tregonte se ku ndodheshin shokët tanë. Ai kishte dijeni dhe na i tregoi të gjitha, pasi ata ndodheshin të fshehur në shtëpinë e tij në një fshat afër Peshkopisë.

Qëndruam aty edhe ne të fshehur nëpër fshatrat e Peshkopisë, derisa ramë në kontakte dhe arritëm një marrëveshje me Fik Maliqin, nëpërmjet njerëzve të tij që ishin në Maqedoni, që të arratiseshim përsëri e të dilnim pa u dorëzuar atje. Sapo dolëm në anën tjetër të kufirit ata na kapën dhe na dërguan për shtatë muaj në një kamp afër një fshati i quajtur Tra-shevë. Prej këtu na transferuan në Sarajevë, duke na punësuar atje në ndërtimin e Sarajevës, e shkatërruar nga lufta. Qëndruam atje rreth

një vit, deri në fund të vitit 1950, duke punuar derisa na kthyen përsëri në Maqedoni në Gos-tivar dhe prej aty na dërguan në Panqevo-Serbi.

Mbas dy a tre muajve na erdhi një oficer policie serb i quajtur Ziko Sharkiq dhe e njihte shqipen shumë mirë, së bashku me dy xhaxhallarët e mi të liruar nga burgu serb. Ata erdhën për të na njoftuar se Cen Elezi, Dan Kaloshi kishin “vdekur”, por ne e mësuam më vonë se i kishin pushkatuar forcat komuniste serbo – sllavë në bashkëpunim me agjentët e tyre shqiptar, që punonin për OZNA dhe UDB.

Pasi qëndruam rreth gjashtë vjet nëpër ish-“Jugosllavi”, në vitin 1955 fituam një farë lirie të shkojmë ku të duam.

Ky lloj vendimi i jugosllavëve na erdhi si i papritur. Duke mos pasur shumë besim tek serbo-sllavët, u regjistruam menjëherë për të dalë në perëndim. Aty, pas një procedure 18 mujore, në vitin 1955 kaluam në kampin e refugjatëve në Kapo të Italisë, nën administrim-in e anglo-amerikanëve”.

EMIGRIMI NË SHBA DHE USHTAR ME SHËRBIM NË USHTRINË AMERIKANE

Junuz Ndreu rrëfen në këtë bisedë se emigrimi i tij qe një dhimbje e madhe dhe ishte i hidhur për të gjithë të arratisurit e asaj kohe. Por, që ishte e vetmja mënyre për të shpëtuar gjallë, pasi fati i tyre do të ishte si në Jugosllavi dhe në Shqipëri, ashtu si i mijëra të vrarëve, të persekutuarve, të internuarve e të burgosurve. “Megjithëse me një sakrificë sublime, unë zg-jodha lirinë, për të hapur rrugën time. Fillimisht, në jetën e emigrantit në Itali, mbasi mbusha dokumentet për në SHBA, u regjistrova në një formular për të shërbyer në ushtrinë amerikane”. Dhe, sapo u aprovua kërkesa për pranim në Amerikë, atë e dërguan si ushtar menjëherë nën uniformë. Duke shërbyer kështu si ushtar i ushtrisë së SHBA, për pesë vjet. Dhe, sot, ai mban statusin e veteranit të ushtrisë amerikane.

Duke sjell kujtimet e tij në 11 Nëntorin, Dita e Veteranëve të Luftës, Jonuz Ndreu kujton shërbimin ushtarak në ushtrinë amerikane.

“E kreu në forcat e këmbësorisë, fillimisht në një bazë ushtarake në Karolinën e Jugut . Pas 8 muajve të parë nën rrobën ushtarake, kalova me shërbim në Fort Devis të Kolorados. Dhe, mbas përgatitjes së ushtruar në këtë bazë, transferohem me shërbim të gjatë në një bazë ushtarake amerikane në Berlinin perëndimor në Gjermani”. Dhe vazhdon, se gjatë shërbimit në Gjermani gjendja e tij shëndetësore u keqësua, duke ju nënshtruar regjimit spitalor dhe një urdhri për t’u kthyer me shërbim në Islandë, në veri të Anglisë.

Mbas një viti me shërbim atje, vjen rik-thimi në SHBA, në bazën ushtarake Fort Er në Maseçustes në Divizionin e Dytë të Këm-bësorisë, derisa e transferuan sërish në Berlin të Gjermanisë Perëndimore. Aty kryen edhe 18 muajt e fundit që i kishin mbetur në ushtrinë amerikane. “Në ushtrinë amerikane kam shër-byer me zell të madh, - shprehet Nuzi. Ushtria amerikane më ka vlerësuar lart shërbimin dhe më ka bërë shumë krenar si shqiptar që shër-beva për flamurin e Amerikës.

Unë isha në atë kohë ndër të paktët ushtarë, që pa qytetarinë amerikane, të shërbeja në këtë armatë, dhe ndoshta nga të parët që u gradova”. Ai kujton sot në Ditën e Veteranëve në Shtetet e Bashkuara, e cila këtë vit përkonte edhe me 90 vjetorin e Luftës së Parë Botërore, gradimin me gradën Kapter i Parë, një dekorim për merita në këmbësori një dekoratë me shumë vlerë i ushtrisë amerikane. Veterani i ushtrisë amerikane ka disa certifikata zyrtare ushtarake, e dhurata të ndryshme nga personalitetet më të larta të Ministrisë së Mbrojtjes Amerikane (DoD), me motivacionin e quajtur “God Conduct”. Rastësia-ushtria e solli atë që me uniformën e trupave amerikane të ishte shok

Jonuz Ndreu përjetoi edhe dy momentet më të veçanta të jetës së tij: atë kur Shqipëria u çlirua nga zgjedha komuniste dhe demokracia lindi edhe në Shqipëri; dhe atë kur Kosova u çlirua mbas një shekulli, duke u bërë e shqiptarëve.



ushtrie në bazën ushtarake amerikane në Frankfurt me Elvis Presley, i cili ishte një aktor dhe këngëtar amerikan me famë botërore, një ndër figurat kulturore më të shquara të shekullit të 20-të dhe njihet edhe si “Mbreti i Rock and Roll-it” apo thjesht “Mbreti”. Jonuz Ndreu ishte nga ata shqiptarë, të cilët sot janë veteranët e ushtrisë amerikane të cilët patën respekt dhe nderim të lart nga të gjithë ushtarët dhe komandantët ku ata shërbyen në uniformën dhe flamurin e SHBA.

JETA DHE AKTIVITETI POLITIK NË MËRGIM

“Këtu, - thotë Jonuzi, - më duhet të kujtoj edhe kontaktet e para me personalitetet shqiptare në mërgim. Në kampin e Kapos, – Itali, pas Isa Ndreut, erdhën disa përfaqësues të Komitetit Shqipëria e Lirë, me qendër në Romë – Itali, të kryesuar nga Sahit Kryeziu. Më pas në kamp vumë kontaktet e para me përfaqësues të partive të para politike shqiptare, në mërgim, përfaqësuesit e Bllokut Kombëtar të kryesuar nga Ernest Koliqi me Kol Bibë Mirakën, Partia e Ballit Kombëtar, Organizata Kombëtare Lëvizja e Legalitetit, Partia Katundare dhe përfaqësues të tjerë.

Ndërsa, kur erdha në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pasi shkela për herë të parë me 11 shtator të 1957-tës dhe më 11 shtator të 1962, për herë të dytë, kur u lirova nga ushtria pasi shërbeva për 5 vjet, kam qenë i angazhuar në Partinë Katundare, e cila udhëhiqej atëherë nga Isa Ndreu. Më vonë u angazhova në shumë aktivitete në organizatën e quajtur “Tripalëshi”, ku bënin pjesë Partia Katundare – Bashkimi dhe Rezistenca antikomuniste.


Në 1962, Mbreti Leka I, i cili donte të bashkonte të gjithë shqiptarët dhe i thirri të gjitha forcat nacionaliste në diasporë, në Madrid – Spanjë, thirri edhe “Tripalëshin”, ku bënin pjesë Partia Katundare – Bashkimi dhe Rezistenca antikomuniste. Meqenëse organizimi i quajtur “Tripalëshi” mori pjesë aktive në takimin e Madridit, të përfaqësuar në Isa Ndreu e Lec Shllaku, ju kërkua që ajo të shkrihej në partitë e tjera, duke formuar një parti të vetme. Mbas mbledhjes së mërgatës shqiptare në Madrid (Spanjë), u vendos që ajo të zhvillonte një takim tjetër në Nju Jork (SHBA).

Në Nju Jork, takimi i forcave politike antikomuniste në mërgim udhëhiqeshin atëherë nga Xhaferr Deva, në të cilat, pothuajse mora pjesë në çdonjërin prej tyre. Mbas Xhaferr Deva u tërhoq në një takim, kryetar i takimit të Nju Jorkut u zgjodh një ish oficer i gardës mbretërore, Masar Pustina, duke rifilluar edhe një herë bisedat për riorganizimin e mërgatës në SHBA. Blloku Indipendent u tha se nuk mundi të marrë pjesë, pasi aty ishte edhe Partia e Rezistencës, e cila, konsiderohej si degë e shkëputur nga Blloku Indipendent.

Kështu që, për të futur edhe bllokun në këtë grup, menduam që të tre partitë të shkrihen në një të vetme. Mirëpo Partia e Rezistencës e udhëhequr nga Ndue Pjetër Gjon Marku, e kundërshtoi dhe kështu që gati dështoi takimi. Kryetari i Partisë Bashkimi Kombëtar Loro Stajko, u bëri thirrje pjesëmarrësve, duke thënë

se, nëse pengesë e kësaj mosmarrëveshje për njëjtësimin e partisë jam unë, atëherë mund të jap edhe dorëheqjen, dhe kaloi në Partinë Katundare. Diskutimi i Stajkos u prit me duartrokitje nga të deleguarit”, rrëfen Jonuz Ndreu.

“Ky ka qenë momenti kur, mbasi u bënë të gjitha tratativat, u mbërrit në një mirëkuptim ideal – te të gjitha partitë e grupuara në “Tripalësh”, që të mbanin një kongres të përbashkët, ku të zgjidhej një kryetar”. Jonuz Ndreu tregon gjithashtu se: “Mbas disa përpjekjeve disavjeçare që bëri vëllai im, Isa Ndreu, me



mikun e tij, publicistin e njohur të mërgatës antikomuniste shqiptare, Lec Shllaku, ata arritën që t’i merrnin mikut të tyre Zhak Shirak, që asokohe ishte në funksionin e kryetarit të Bashkisë së Parisit, miratimin për t’i dhënë një sheshi në qendër të kryeqytetit francez, emrin e Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeu. Shllaku me Isain e kishin mik të ngushtë politikanin e famshëm francez Zhak Shirak dhe ata e kishin ndihmuar atë në fushatat e ndryshme elektorale, kur ai kandidonte për postin e Kryeministrit apo të Kryebashkiakut të Parisit. Pas shumë bisedimeve që Isai me Lec Shllakun zhvilluan me mikun e tyre të ngushtë Zhak Shirak, ai mbledhi Këshillin Bashkiak të Parisit, i cili më datën 10 korrik të vitit 1978, me rastin e 100-vjetorit të Lidhjes së Prizrenit, mori vendimin zyrtar dhe i akordoi emrin e Skënderbeut, njërit prej shesheve në qendër të Parisit,

Jonuz Ndreu, biri i Cen Elezit, nipi i Elez Isuf Ndreut, do të mbahet mend përgjithmonë si një atdhetar i shquar, që e deshë Shqipërinë, Kosovën dhe vendlindjen e tij, Dibrën. Dhe për këtë nuk pushoi asnjë çast në mërgim.

i cili më parë quhej ‘Villa Lumier’. Pas marrjes së atij vendimi, ceremonia zyrtare për dhënie e emrit ‘Skënderbej’ atij sheshi, u zhvillua më datën 6 dhe 7 maj të vitit 1980, ku morën pjesë me dhjetëra e dhjetëra personalitete të mërgatës antikomuniste shqiptare nga shumë vende të botës. Në atë ceremoni madhështore mungoi vetëm ambasadori i Shqipërisë, i cili nuk mund të vinte dot aty për shkaqe që tashmë dihen. Pas kësaj në shenjë mirënjohjeje dhe respekti, Lec Shllaku me Isa Ndreun, i akorduan një medalje ari zotit Shirak, e cila iu dhurua me një ceremoni madhështore në Paris, ku morën pjesë personalitete nga e gjithë mërgata antikomuniste shqiptare”.

PARTIA BASHKIMI KOMBËTAR

Bashkimi Demokrat Shqiptarë, u përgatit të mbaj kongresin e saj të parë në Firence-Itali, ku ajo u kurorëzua me emrin që ajo mban sot, pra “Bashkimi Kombëtar Shqiptar- BKSJH”. Kryetar

z.Isa Ndreu dhe sekretar z. Lec Shllaku dhe dy n/kryetar Adem Hodo e Loro Stajko. Vijoi të dalë rregullisht revista “Koha Jonë”, një organ i BKSJH, e cila vazhdoi punën e saj për 40 vjet.

“Unë vazhdimisht, - thoshte me krenari Jonuz Ndreu, - kam qenë anëtar i kryesisë së Bashkimi Kombëtar Shqiptar dhe mendoj se kam luajtur një rol të madh në këtë parti, sidomos, këtu në SHBA. Kam qenë hambari i Partisë Bashkimi Kombëtar Shqiptar. Kam punuar pa u lodhur dhe duke sakrifikuar që të çoj në vend të gjitha obligimet e mia që dilnin nga partia. Punova me të gjitha organizatat, shoqatat dhe entet fetare komunitare, duke pasë marrëdhënie të mira, si me Bllokun, Legalitetin, Ballin Kombëtar dhe Vatrën, si me Kishën dhe Xhaminë. Kam përfaqësuar në çdo aktivitet me karakter kombëtar dhe politik partinë time, të cilën e udhëhoqa për disa vjet në Amerikë. Duke marrë pjesë si i deleguar nderi në të gjitha kongreset e Legalitetit, takimet e Ballit Kombëtar dhe të Komitetit Shqipëria e Lirë, dhe të shoqërisë “Vatra” qysh nga viti 1960. Kam marrë pjesë si përfaqësues i partisë BKSJH në të gjitha festat e flamurit, demonstratat e protestat kundër regjimit komunist në Tiranë dhe ato për lirinë dhe të drejtat e shqiptarëve në Kosovë e të gjitha trojet etnike.”

FAMILJA, PUNA DHE SHOQËRIA

Ndërkohë, duke folur, për familjen dhe shoqërinë, Jonuz Ndreu thotë se për herë të parë punën në Amerikë e kishte filluar në kompaninë Daglas Managment. Një kompani kjo, e cila më pas ndërroi disa emra, por jo bosët. Këtu ai punon nga 1968 – dhe deri sa del në pension në 2005, pra, 37 vite pune. Në vitin 1982 Jonuz Ndreu pëson një aksident të rëndë komunikacioni, dhe kompania Daglas Managment i vë në dispozicion të gjitha shpenzimet spitalore, deri në shërimin e plotë, një shumë e madhe kjo që ai e meritonte për punën e bërë. Ndërkaq, nipi i bosit të madh të kompanisë Daglas Managment, me rastin e daljes në pension (maj 2005) i dhuron atij një çek me vlerën e 25 mijë dollarëve. Nga të gjitha kujtimet e tij, një nga momentet më të bukura dhe të lumtura të jetës së tij është dalja në botën e lirë.

AI E KA PJESË TË PANDARË GJATË GJITHË JETËS SË TIJ, KOMBIN SHQIPTAR

Ka jetuar gjithmonë me hidhërimet e sundimit sllavo-komunist nga regjimi diktatorial i Enver Hoxhës, në Shqipërinë komuniste. Përjetoi shumë keq sundimin dhe represionin e egër serbo-sllav ndaj shqiptarëve në Kosovë e trojet shqiptare. Por, gjithashtu, përjetoi edhe dy momentet më të veçanta të jetës së tij: atë kur Shqipëria u çlirua nga zgjedha komuniste. Komunizmi ra dhe demokracia lindi edhe në Shqipëri; dhe atë kur Kosova u çlirua mbas një shekulli, duke u bërë e shqiptarëve.

Këto dy momente historike Jonuz Ndreu, si çdo shqiptar i ka përjetuar sikur të kishte lindur edhe një herë. Prej vitit 1992, kur edhe u hap Shqipëria, ai e ka vizituar vendin e tij rreth 13 herë. Në vitin 1992 shkon për herë të parë pas 50 vjetëve në vendlindjen e tij, në Sllovën e rrethit të Dibrës, një katund malor në kufi me Kukësin. U gëzua, se gjeti gjallë edhe më të moshuarit e fisit të madh të Ndreut: Xheladinin, Rexhepin, Baftjarin, Lazamin, Bexhetin e të tjerë.

“Shqipëria na e ka hëngër gjithë jetën, trupin e kam këtu, por mendja dhe zemra janë në Sllovë, janë në Shqipëri, në Kosovë”, - thoshte Jonuzi. Në festën e daljes në pension, Shoqëria “Vatra”, ku shërbeu për më shumë se gjysmë shekulli, i dhuroi një pikturë me figurën e Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, me emblemen e “Vatrës”. Jonuz Ndreu ka marrë shumë medalje, dekorata dhe mirënjohje për kontributin e tij për Pavarësinë e Kosovës, Demokracinë e Shqipërisë, Çështjen Çame dhe zgjidhjen e çështjeve shqiptare në të gjitha trojet etnike.

* * *

Jonuz Ndreu, biri i Cen Elezit, nipi i Elez Isuf Ndreut, do të mbahet mend përgjithmonë si një atdhetar i shquar, që e deshë Shqipërinë, Kosovën dhe vendlindjen e tij, Dibrën. Dhe për këtë nuk pushoi asnjë çast në mërgim.



Dr ENVER HALILI
Melburn, Australi

(vijon nga numri i kaluar)

Të bazuar në mësimet dhe praktikat e lashtësisë, princat arbëror të udhëhequr nga Gjergj Kastrioti u mblodhën në Kuvendin e Lezhës, më 2 Mars të vitit 1444 për të vendosur për fatin e vendit. Me **“besë-lidhjen kombëtare”** si akti më sublim kombëtar u arrit bashkimi i pjesës dërrmuese të princave epirot me qëllim që të bashkëpunojnë në çdo fushë për çlirimin e vendit, ndërtimin e shtetit dhe mbrojtjen e etnisë arbërore. Kuvendi i Lezhës vuri bazamentin historik në të cilin do të krijohet, kultivohet dhe ngrihet vetëdija individuale dhe kolektive kombëtare shqiptare.

Veçoritë kryesore evetëdijës kombëtare shqiptare janë atdhedashuria, besnikëria (besa-besë), uniteti, urretësia, drejtësia, largpamësia dhe mençuria. Këto virtyte të larta njerëzore mundësuan bashkimin e princave arbëror në një front të përbashkët i cili solli çlirimin e vendit, krijimin dhe ndërtimin e shtet-mbretërisë arbërore në tokën e lashte iliro-pellazge. Fryma e tolerancës, bashkëpunimi ndërprincor, vurja e interesit kombëtar mbi atë personal e rajonal ishin fondamenti kryesor i strategjisë kombëtare në kohën e Gj. Kastriotit. Vetëdija e lartë kombëtare e princave epirot mundësoi që ata të pajtohen dhe unanimisht njëri prej tyre të zgjedher udhëheqës i të gjithë princave. Pajtueshmëria dhe besueshmëria reciproke në mes të princave epirot mundësoi bashkimin e të gjitha forcave nën një komandë të përbashkët të udhëhequr nga kryetrimi Gjergj Kastrioti. Kur princat arbëror arritën të vejnë interesin e përgjithshëm kombëtar mbi atë lokal dhe individual atëherë u arrit jo vetëm të çlirohet vendi por edhe të krijohet shtetit si institucion kryesor i etnisë shqiptare në kohën e re.

Princat epirot arritën që t’i ulin interesat e tyre personale e rajonale në të mirën e interesit të përgjithshëm kombëtar. Mendja racionale e udhëheqësve të principatave arriti që interesat e tyre personal t’i vejë në shërbim të interesit të lartë të atdheut. Vetëm një nivel i lartë i vetëdijes arriti që në periudhën e mesjetës t’i sakrifikojë interesat personale e rajonale të princave epirot dhe t’i vejë nën shërbim të interesit sublim kombëtar. Atëherë kur vetëdija e prijesit arrin të udhëhiqet nga një arsye a lartë aty kemi një harmonizim të interesave personale e rajonale me interesat e përgjithshme kombëtare. Në këso rastesh interesi personal është një interes racional dhe është në pajtueshmëri të plotë me interesin e përgjithshëm. Besueshmëria reciproke dhe konvergjenca e interesave në mes të princave arriti t’i eliminojë të gjitha infomatat asimetrike brenda pushtetit shtetëror si atij qëndror, atij rajonal dhe lokal. Eliminimi i informatave asimetrike në hierarkinë vertikale shtetërore (ndërmjet dikastereve të ndryshme) dhe atë horizontale shtetërore (në mes të lokaliteteve dhe rajoneve) i mundësoi Mbretërisë Arbërore të funksiononte me sukses për më se tri dekada e gjysmë.

Në Kuvendin e lavdishëm të Lezhës kemi për herë të parë në historinë tonë dhe më gjerë kalimin nga praktika e ndërtimit në modelit të trashëguar të principatës rajonale si formë e shtetit në atë të “shtetit-komb” me një qendër të vetme, kësaj radhe në qendrën e Kastriotëve në Krujë. Kruja u be epiqendër gravituese e të gjitha nën-qendrave dhe principatave të tjera epirote. Kruja u bë qendra e parë kombëtare e cila arriti ta përfaqësojë interesin e përgjithshëm të viseve të çliuara dhe atyre të cilat mbetën jashtë kontrollit të Mbretërisë Kombëtare. Në Krujë u vendos

Epoka e Gjergj Kastriotit, bazament i vetëdijes kombëtare shqiptare

administrata qëndrore shtetërore përfshirë strukturat ushtarake, politike, diplomatike, administrative, ekonomike dhe kulturore. Aty qëndronte Mbreti, Kuvendi i Fisnikëve, aty marshonte Garda Mbretërore, aty ishte Arka e Shtetit dhe në Portën e Kështjellës së Krujës valonte flamuri kombëtar “kuq-e- zi”, simbol i shtetit të lirë Arbëror. Për 25 vjet me radhë nën udhëheqjen e Kastriotit dhe 10 vjet të tjera nën udhëheqjen e Lek Dukagjinit në Krujë do të hartohen planet strategjike ushtarake, politike, e diplomatike për avancimin e çështjes kombëtare shqiptare. Administrata shtetërore e përqendruar në Krujë do ta iniciojë, hartojë dhe harmonizojë strategjinë kombëtare dhe administrojë të gjitha punët dhe veprimet për realizimin e planeve dhe kryerjen e detyrave në raport me interesin e gjerë kombëtar.

Në Epokën e Kastriotit u arrit një avancim i vetëdijes shoqërore e cila shënoi një ngritje në një shkallë më të lartë nga ai lokal e rajonal në atë kombëtar. Kështu u arrit të krijohet shteti si një mjet mbrojtës i interesave për të gjithë pjesëtarët e etnisë shqiptare. Me kalimin e kohës do të arrihet që të krijohen ligjet, kodifikohen rregullat dhe zakonet e etnisë shqiptare në aktin më të lartë zakonor, i njohur si “Kanuni i Lek Dukagjinit”. Në “Kanun” fare mirë shtjellohet vija, rruga dhe shkalla e krijimi të kombit shqiptar duke filluar nga familja (e përbërë nga anëtarët e saj), farefisit, flamurit e më gjerë. Andaj, kombi shqiptar mund definohet si një bashkësi shoqërore e individëve të bashkuar në familje e vëllazëri të cilët e kanë një gjak, një gjuhë, doke dhe kulturë historike të njëjtë dhe jetojnë në një atdhe të shtrirë në një territor kompakt gjeografik të trashëguar nga periudhat e hershme historike dhe parahistorike (iliro-pellazge).

Vetëdija kombëtare e ndërtuar mbi bazën e konceptit të **‘familjes si qelizë’** fillestare e kombit shqiptar arriti që me sukses t’u rezistojë fatunave të ashpra historike duke ruajtur, kultivuar dhe zhvilluar kulturën kombëtare dhe mbrojti me sukses qëniën etnike shqiptare. Familja është ‘qeliza’ fillestare e shoqërisë shqiptare e cila i ka rrënjët thelle në historinë iliro-pellazge. Familja ishte vendi ku paraardhësit tanë krijuan, kultivuan dhe zhvilluan fuqinë punëtore, forcën luftarake dhe intelektuale gjatë epokave të ndryshme të historisë. Në familjen arbërore krijohet edukata bazuar në kulturën tradicionale e cila edukoi luftëtarët më të mëdhenj të historisë si Aleksandri Madh, Pirro i Epirit, Gj. Kastrioti, M. Boçari, L. Bubulina, O. Kuka, I. Boletini, D.Gj. Luli, Shote e Azem Galica e deri te Adem e Hamzë Jashari. Në familjen shqiptare u ruajt dhe kultivua mësimi dhe kultura arsimore kombëtare nga e cila dolën shkollarët e njohur si M. Barleti, P. Bogdani, rilindësit e mëdhenj, doli Gj. Fishta e F. Konica e deri te Ferid Murati, I. Kadare dhe dijetarë të tjerë të cilët sot punojnë dhe kontribuojnë në institute, universitete dhe akademi të ndryshme rreth e rrotull globit tokësor.

Kultura kombëtare e mbështetur në “familjen e fortë” arriti t’u parballojë dallgëve të egra të shekujve dhe u mundësoi shqiptarëve të mbijetojnë në trojet e tyre jashtë shtetit shqiptar. Familja e shëndoshë shqiptare ishte faktori kryesor e cila u mundësoi shqiptarëve jashtë atdheut të mbijetojnë ndër shekuj si Arbereshët në Itali dhe shumë shqiptarë të tjerë në Turqi, SHBA, vendet Europiane dhe kontinentet tjera. ‘Familja e fortë’ ishte faktori kryesor i cili u mundësoi çamëve dhe arvanitasve të mbijetojnë nën pushtetin grek. Arvanitasit janë shembull i shkëlqyeshëm i trimërisë dhe krenarisë shqiptare të cilët kishin rolin kryesor të luftës nacionalçlirimtare të 1821-shit (Llala, 2011; 2019). Ata pavarësisht dhunës dhe persekutimit të gjatë duke i falenderuar kulturës së lashte dhe familjes së shëndoshë arritën ta ruajnë substancën e vet kombëtare deri në kohën tonë. Familja e shëndoshë arbëreshe dhe arvanitase lindi dhe rriti luftëtarë dhe intelektualë patriotë të shquar si De Rada, Z. Serembe, Dh. Kamarda, J. Diogardi, L. Bubulina, M. Boçari, A.Kryezi, T. Kollokotroni, A. Kola, e shumë të tjerë.



Skanderbeg, by Dominicus Custos, Foto ilustruese

Shqiptarët vërtete nuk patën fat në ruajtjen e shtetit kombëtar pas Epokës së Kastriotit por duke kultivuar vetëdijen dhe kulturën e ruajtjes së familjes si qelizë kryesore të shoqërisë dhe forcimin e saj brenda fare-fisit dhe rajonit arritën me sukses të mbijetoje gjatë periudhave dramatike ndër shekuj deri në ditët e sotme. Familja pati rolin kryesor në ruajtjen e kombit shqiptar në diktaturën komuniste dhe nën pushtimin barbar serb. Ta marrim një shembull konkrete, gjatë periudhës së pushtimit të egër serb në shumicën e rajoneve dhe lokaliteteve ku jetonin shqiptarët, në lagje, fshatra e më gjerë gati se mbi 80% deri në 90% e familjeve shqiptare ishin të shëndosha, të rregullta, bënë një jetesë të organizuar, zhvillonin një jetesë normale, ishin shumë kompakte dhe moralisht të pastra. Nëse 80-90% e familjeve shqiptare bënë një jetesë të organizuar, ishin të shëndosha dhe të forta atëherë rrjedh se mbi 90% e pjesëtarëve të kombit shqiptar ishin në gjendje të rregullt dhe normale. Nëse rreth 90% e pjesëtarëve të kombit bënë një jetesë të organizuar, të harmonizuar dhe të ekuilibruar do me thënë se ai popull vërtetë është i fortë dhe mund t’u përballojë valëve të egra të kohës.

Kultura tradicionale e ruajtjes së familjes mundësoi ndërlidhjen ndërmjet e regjioneve ku jetonin shqiptarët dhe u bë elementi kryesor i cili realizoj bashkëpunimin e fortë dhe shume funksional të të gjitha veprimeve ndërmjet popullsisë pavarësisht ndarjes dhe copëtimit të rajoneve dhe krahina të ndryshme me kufijtë artificial që bënë armiqtë tanë. Bashkëpunimi dhe bashkë-koordinimi i aksioneve dhe veprimeve në mes të familjeve të shëndosha në aspektin regional dhe krahinor u mundësoi shqiptarëve të operojnë me sukses në nivel të përgjithshëm dhe t’i tejkalojnë periudhat dramatike të historisë.

Bashkëpunimi dhe bashkë-koordinimi i aksioneve për interesa të gjera çdo herë është bërë në bazë të vijës së gjakut dhe fisit duke i funksionalizuar ndarjet e ndryshme jo vetëm rajonale por edhe dallimeve kulturore e fetare. Edhe pse shqiptarët u detyruan të marrin dhe zbatojnë besimet e ndryshme fetare ata çdo herë ishin të lidhur në mes vete në bazë të vlerës së etnisë shqiptare. Shqiptarët kanë jetuar si vëllazër pavarësisht ndarjeve fetare dhe do të jetojnë kështu gjithmonë, duan apo jo armiqtë e tyre potenconte Sami Frashëri (Frashëri, 1878). Organizimi i jetesës në bazë të principeve të kulturës kombëtare mundësoi që aspekti fetar te shqiptarët vazhdimisht të jetë në shërbim të interesit të përgjithshëm kombëtar. Shpesheherë gjatë historisë sonë pati përpjekje nga agjenturat

e ndryshme që t’i shfrytëzojnë besimet e ndryshme fetare si instrument perfid për të krijuar ndarje dhe përçarje në popull. Ndarjet fetare të popullit tonë çdo herë në mënyrë të vetëdijshme u tejkaluan duke i dhënë përparësi çështjes kombëtare në relacion me çështjen fetare.

Shqiptaret arritën t’i tejkalojnë problemet e ndarjes dhe përçarjes sepse ishin te prirur nga porosia e Kastriotit “të jeni gjithmonë të bashkuar” në luftë për çlirimin dhe mbrojtjen e vendit. Andaj Skënderbeu definitivisht u shndërrua në simbolin e bashkimit, pavarësisht nga besimi fetar (Repishti, 2004). Një rëndësi të jashtëzakonshme në ruajtjen dhe kalitjen e bashkëveprimit kombëtar do të luajnë sidomos mësimet monumentale të rilindësve tanë të shenjtë. Dijetarët e Rilindjes Kombëtare i kushtuan një rëndësi të veçantë edukimit të popullit në frymën e Kastriotit duke i vënë interesat e përgjithshme në plan të parë. Kështu që porosia e P. Vasës, “feja e shqiptarit është shqiptaria” u bë një moto jetike dhe shëndrrua në një mjet shume efikas në forcimin e unitetit ndërshtqiptar për çdo individ dhe bashkësi individësh apo familjesh kudo që ata jetojnë dhe punojnë.

Për shembull, shqiptarët në territoret e tyre të pushtuara nga jugosllavët vërtetë ishin të shtypur, të diskriminuar dhe të privuar nga e drejta e ndërtimit të shtetit të vet kombëtar. Vetëdija kombëtare shqiptare u ndërtua mbi konceptin e ‘familjes së fortë’, u kultivua dhe kalit në konceptin e kulturës së lashtë kombëtare, duke funksionalizuar dallimet regionale dhe diversitetin fetar. Arritja e harmonisë dhe ndërlidhshmërisë brenda kombëtare pavarësisht këtyre ndarjeve administrative (të instaluar nga armiqtë) u mundësoi shqiptarëve në këtë anë të Drinit, siç do të thoshte shkrimtari i nderuar D. Agolli, të qëndrojnë historikisht, ta ruajnë substancën etnike dhe te avancohen si faktor i rëndësishëm në rajonin e Ballkanit të sotëm. Si rezultat i kësaj qëndrese shekullore sot në hapësirën Ballkanike po funksionojnë dy shtete etnike shqiptare. Po ashtu është për t’u veçuar fakti që shqiptarët në hapësirën e Maqedonisë, Luginës së Moravës dhe rajonit të Tivarit, Ulqinit, Tuzit e te tjera çdo ditë po forcohen si element shtetformues.

3.1 PËRJETËSIMI I VEPRËS SË GJERGJ KASTRIOTIT

Në bazë të këtyre diskutimeve të prezantuara në ketë studim mund të nxirret përfundimi se figura e Gjergj Kastriotit është sa komplekse, aq interesante dhe mbi të gjitha është shume e rëndësishme jo vetëm për popullin shqiptar por për të gjithë popujt liridashës. Kompleksiteti i figurës së Kastriotit rrjedh nga format shumëdimensionale të ngritjes dhe ndërtimit të karrierës së tij ushtarake, diplomatike dhe shtetërore. Roli i personalitetit të Kastriotit qëndron në mënyrat të cilat ai arriti të iniciojë dhe realizojë bashkimin e princave arbëror si dhe metodën e bashkëpunimin e suksesshëm gjatë tri dekadave e gjysmë në mbrojtjen, ngritjen dhe ndërtimin e shtetit kombëtar. Po ashtu një rol jashtëzakonisht i rëndësishëm i Kastriotit qëndron në iniciativat dhe kontributin e tij në krijimin e aleancave rajonale dhe europiane sidomos në krijimin e miqësive me mbretëritë e Italisë.

Figura e Gjergj Kastriotit del aq madhështore sidomos kur analizojmë sukseset e vazhdueshme në luftë për çlirimin e vendit, mbrojtjen e lirisë dhe ndërtimin e shtetit arbëror dhe sukseset e tij në arenën europiane e më gjerë. Kastrioti arriti suksese kolosale si në fushëbetejë, po ashtu edhe në fushën politike dhe atë diplomatike kundër një super fuqie ushtarake e cila ishte sa e fortë aq edhe dhelpnake edhe e paparashikueshme në veprimet e saj. Ushtria osmane ishte një superfuqi ndër më të mëdhatë në histori dhe nuk respektonte ndonjë kodhuman të luftës. Ajo çdo herë silllej me dinakëri, agresivitet dhe barbari ndaj popujve të vegjël. Kjo ndikoi që ushtria e Kastriotit të ishte çdo herë vigjilente dhe të silllej me dinjitet si në fushatat luftarake ashtu edhe në periudhat paqësore.

Sukseset e “28 Nëntorit“ kanë vënë vulë të pashlyeshme në historinë e popullit tonë në tërë hapësirën e Gadishullit Ilirik dhe gjithkund ku jetonte e veprojnë shqiptarët. Andaj mund të thuhet lirish se Gjergj Kastrioti është bërë “Ikonë e lirisë së popullit shqiptar!

Mund të thuhet lirisht së vështirë është të gjendet në ndonjë vend tjetër një festë aq e lavdishme siç është “28 Nëntori” i Gjergj Kastriotit. Në këtë ditë të gjithë pjesëtarët e kombit tonë anë e kënde botës bashkohen për të festuar një kremte sa të lashtë aq edhe madhështore. Kjo ditë pas pesë shekujsh është materializuar me sukses gjatë historisë sonë.

Vlerën e figurës së Kastriotit e ngriti edhe më lartë gjithashtu vrulli i paparashikueshëm i rrjedhës së ngjarjeve në ato vitet e katrahurës në të cilat sollën shembjen e dy perandorive më të mëdha të historisë (Romake dhe Bizantine). Perandoritë e krishtera për shkak të divergjencave dhe mos harmonizimit të veprimeve në mes tyre ato nuk qenë në gjendje t’i përballojnë sulmeve agresive të forcave osmane. Forcat osmane shpejtë arritën ta pushtojnë tërë territorin e perandorisë së Bizantit si dhe një pjesë shumë të rëndësishme të Perandorisë Romake.

Fitoret e njëpasnjëshme të ushtrisë maqedono-epirote të udhëhequra nga Kastrioti dëshmuuan se lufta e drejtë e një populli të vogël mund të fitohet kundër një superfuqie ushtarake vetëm kur ai popull është unik dhe kur të gjithë udhëheqësit dhe komandantët e tij luftojnë së bashku për të çliruar dhe mbrojtur atdheun. Ushtria arbërore bëri një luftë gjigandeske, me përmasa europiane për mëse njëzet e pesë vjet nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit dhe për një dekadë tjetër nën udhëheqjen e Lek Dukagjinit. Fitoret epike të ushtrisë epirote arritën ta shndërrojnë Gjergj Kastriotin në simbol të luftëtarit për liri me përmasa globale! Në shenjë respekti, busti i heroit tonë qëndron krenar në shumë qendra të botës si në Gjenevë, Londër, Në York, Bruksel, Romë, Miçigan, Budapest, etj.

Gjergj Kastrioti ishte heroi më i madh në histori dhe askush, as në historinë e vjetër dhe as në atë të renë, nuk mund të krahasohet me të (Holberg, 1739). Andaj mund të thuhet se vërtetë ai ishte pasardhës i denjë i Aleksandrit të Madh të Maqedonisë dhe Pirros së Epirit. Vepra e Gjergj Kastriot shkëlqeu si rreze dielli dhe ndriçoi rrugët e lirisë jo vetëm të popullit tonë por të të gjithë popujve liridashës. Madhështia e veprës së Kastriotit do të bëhet faktor stimulues për të gjitha shtresat e shoqërisë në të gjitha periudhat historike që të luftojnë për çlirimin e vendit dhe krijimin e shtetit kombëtar shqiptar.

Gjergj Kastrioti krijoi Epokën më të lavdishme historike jo vetëm për popullin tonë por për gjithë popujt liridashës të Europës dhe më gjerë. Epoka e Kastriotit ishte shembull i mrekullueshëm i qëndresës së arbërve (Andoni, 1982). Kjo epoke u shëndrrua në një faktor motivues për çlirim kombëtar në të gjitha periudhat e mëvonshme kohore dhe për të gjitha gjeneratat duke përfshirë Gjon e Gergj Kastriotin e Ri, Pjetër Bogdanin, Ali Pash Tepelenën e Balshajt e Shkodrës, Sylejman Vokshin e Micë Sokolin, Marko Boçarin e Oso Kukën, Bajo e Çerçiz Topullin, Dedë Gjo Lulin, Isa Boletinin dhe Idriz Seferi, Shote e Azem Galicën, Shaban Polluzhën, Hysen Terpezën e Xhemë Gostivarin, dhe Adem e Hamzë Jasharin.

Epoka e historike e Kastriotit jo vetëm se arriti ta mbjellë përjetësisht ndjenjën e krenarisë kombëtare të populli shqiptare por edhe u shndërrua në një burim të pashtershëm për shollaret e të gjitha niveleve dhe të gjitha lëmive të cilët do krijojnë vepra me vlera të larta artistike dhe shkencore gjatë të gjitha periudhave të historisë. Andaj, siç thoshte shkrimtari Godo, po mos të ishte rezistenca historike e Kastriotit, shqiptarët do të ishin kthyer në një popull të nënshtruar. Rrezistenca titanike e Kastriotit mbolli thellë në ndërdijen e popullit tonë vetitë luftarake dhe krenarinë kombëtare e cila mundësoi që shqiptarët jo vetëm të mbijetojnë ndër shekuj por edhe të arrijnë të themelojnë dhe ndërtojnë dy shtete të pavarura në fillim dhe në fund të shekullit njëzet.

Rëndësia e Epokës së Skënderbeut duhet analizuar nga dy perspektiva kryesor të në atë

luftarake dhe politike e cila u realizua në dy rrafshe, në atë kombëtare dhe ndërkombëtar. ***Në rrafshin kombëtar***, rëndësia e e jashtëzakonshme veprës së Kastriotit qëndron në atë se ajo jo vetëm se arriti të krijojë shtetin e parë shqiptar por edhe se ajo u shndërrua në një fanar të pashuar e cila udhëhoqi mendjet e ndritura dhe luftëtarët e lirisë gjatë gjithë historisë sonë. Rëndësia e veprës së Kastriotit në aspektin kombëtar qëndron tri çështje:

- Themelimin e ***“28 Nëntorin Historik”***-ditës së Flamurit Kombëtar.
- Themelimin e Kuvendit si institucion themelor shtetëror.
- Krijimin e Mbretërisë/Shtetit Modern Shqiptar.

Në planin ndërkombëtar, rëndësia e veprës së Kastriotit qëndron në atë se fitoret në luftërat e pandërprera dhe humbjet katastrofale të ushtrisë turke në Epir arritën të ndalin hovin e otomanëve drejtë Europës. Arbëria e Gjergj Kastriotit u bë një digë mbrojtëse për popujt e liridashës të Ballkanit e më gjerë. Me të drejtë Papa Kaliksi III thoshte se “si një pendë a patundshme, Gjergj Kastrioti ndaloi furinë e sulmeve turke dhe e pengoi të zaptonte Europën Kristjane”. Kastrioti ishte njohës i mirë i forcës ushtarake osmane dhe me qëllim që ajo forcë të mposhtej Ai apelonte në krijimin e një armate nën një komandë të përbashkët e cila do të krijohej nga vendet europiane. Andaj krijimi i aleancave të Kastriotit me vendet e ballkanike dhe europiane duhet konsideruar si pararendës të Aleancës Perëndimore të kohës së re.

Epoka historike e Kastriotit u bë një faktor stimulues dhe do të përjetësohet nga shqiptarët në të gjitha periudhat e historisë si në fushë-betejë ashtu edhe në fushën administrative, diplomatike, politike dhe krijuese. Gjergj Kastriotit u shëndrrua në figurë motivuese për luftëtarët e lirisë, burrë-shtetasit, ushtarakët, diplomatët, politikanët, dhe shtet-ndërtuesit qëndror e lokal. Figura e Kastriotit u bë mburojë e fortë kundër valëve të asimilimit për shqiptarët që emigruan jashtë atdheut. Krijuesit në të gjitha periudhat kohore në Epokën e Skënderbeut gjetën një burim të pashterrshëm frymëzimi për të krijuar kryeveprat e tyre në fushën e letërsisë, historisë, politikës, filozofisë dhe artit. Siç thotë profesor Xhufi, Gjergj Kastrioti është një emblemë në historinë tonë. Prandaj mund të konkludohet se, vepra epokale e Kastriotit mbolli përjetësisht ndjenjën e krenarisë kombëtare dhe u bë ***bazament i vetëdijes kombëtare shqiptare!***

3.1.1Themelimi i“28 Nëntorin Historik”– Ditës së Flamurit Kombëtar

Kthesa historike në Nishin e Dardanisë, aty ku Gjergj Kastrioti i tha lamtumirën e fundit sulltanit, do shërbejë si një udhërrëfyes për patriotët shqiptarë të mesjetës dhe sidomos për ata të Rilindjes Kombëtarësi Abdy Frashëri, Sylejman Vokshi, Ymer Prizreni, Ismail Qemal Vlora, Isa Boletini, Luigj Gurakuqi, Hasan Prishtina, e të tjerë. Rilindësit e lavdishëm duke ndjekur rrugën e Kastriotit, thanë Jo-në historike, lanë parlamentin e Stambollin dhe u kthyen në atdhe për t’u vënë në ballë të lëvizjes për çlirimin e tokës së lashtë iliro-pellazge.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878) e udhëhequr nga A. Frashëri, ishte lëvizja e parë me përmasa gjithëkombëtare e organizuar në aspektin arsimor, kulturor, politik, ushtarak, adminstrativ dhe social. Qëllimi i kësaj lëvizje gjithëkombëtare ishte çlirimi atdheut dhe krijimi një shteti të pavarur shqiptar të bazuar në konceptin kombëtar të Skënderbeut. Përsëri, me 1899 u organizua Lidhja e Pejës nën udhëheqjen e Haxhi Zekës. Edhe pse Perandoria Osmane shtypi kryengritjet shqiptare të shekullit 19^e të udhëhequra nga Lidhja e Prizrenit dhe e Pejës ajo nuk arriti ta shuajë aspiratën e popullit për liri. Siç thoshte A. Frashëri “fara u mbuall” dhe rezultatet do të korren në të ardhmen e afërt!

Luftërat e përgjakshme shekulloret e popullit tonë arritën ta kurorëzojnë porosinë e Gjergj Kastriotit dhe idenë e Rilindjes Kombëtare për çlirimin e atdheut me “28 Nëntor 1912”, kur Ismail Qemali me patriotët shqiptarë ngriti Flamurin e lirisë në Vlorë. Ngritja e flamurit të Kastriotit në Vlorë më 1912 përfaqëson fitoren kombëtare të të gjitha trevave shqiptare, prej Tivarit e Sjenicës në veri, deri në Artë e Prevezë në jug, prej brigjeve të Adriatikut e Jonit në perëndim, deri në Manastir, Shkup, Kumanovë në lindje dhe Luginën e

Moravës deri në Nish në verilindje. Patriotët e të gjitha regjioneve shqiptare dhanë ndihmë kolosale për çlirimin kombëtar dhe ngritjen e Flamut Kuq e Zi në Vlorë.

Ashtu si vepruan dikur princat arbërore në krye me Kastriotin, ashtu edhe patriotët e Rilindjes si: Qemajli, L. Gurakuqi, I. Boletini, H. Prishtina, Çerçiz e Bajo Topulli, M. Grameno, D. Gj. Luli, B. Currit e shumë të tjerë shkrinë tërë pasurinë e tyre dhe dhanë gjithçka që patën për çlirimin e Shqipërisë. Por “Nëntor i Dytë” arriti të çlirojë vetëm një pjesë të atdheut dhe fatkeqësisht mbi gjysma e vendit dhe popullit tonë u pushtua nga forcat greke dhe sllave të ndihmuar nga Rusia imperialiste.

Dita e Flamurit, “28 Nëntori” u shndërrua në një festë të dhembjes krenare për popullin tonë. Nga viti 1912 brenda kufijve të Shqipërisë politike, “28 Nëntori” festohej duke bërë organizime të shumta shtetërore dhe kulturore për të përkujtuar heroizmin e popullit ndër shekuj dhe për të analizuar dhe gëzuar për sukseset vitit. Fatkeqësisht, pjesa tjetër e kombit, shqiptarët në tokat e tyre të pushtuara nga sllavo-greket, “28 Nëntorin” e festonin me demonstrime e kryengritje të përgjakshme në shenjë kujtimi të kaluarës së sonë të lavdishme dhe duke shfaqur hapur aspiratat e tyre për liri. Krentimi i Ditës së Flamurit çdo herë do të jetë faktor inspirues si për Tiranën, Prishtinë, Shkupin, e qendrat tjera deri sa të arrihet porosia e Kastriotit- çlirimi përfundimtar i atdheut dhe bashkimin e të gjitha trojeve në një shtet të vetëm kombëtar.

Kthesa historike e Gjergj Kastrioti në Nish u bë forcë frymëzuese edhe për patriotët e Luftës së Dytë Botërore si Abaz Kupi, Shaban Polluzha, Hysen Terpeza, e të tjerëve. Abaz Kupi bashkëluftëtar i Bajram Currit, Elez Isufit e luftëtarëve patriotë të tjerë, më 7 prill të vitit 1939 si edhe herëve të tjera pa hezituar fare i pari i doli zot atdheut dhe ndezi luftën në Portin e Durrësit kundër pushtuesit italian. Majori patriot nga Kruja e lashtë e Kastriotit në atë mëngjes prilli siç pohon Gjoka (2019) organizoi mbrojtjen e Portit të Durrësit dhe u shëndrrua në ikonë të kryengritjes kombëtare. Porti i Durrësit ishte pjesa më e rëndësishme e Shqipërisë dhe njëheri ishte dhe vendi i vetëm në të cilin u organizua një mbrojtje e rëndësishme kundër invazionit italian (Fisher, 1943).

Të frymëzuar nga shembulli i Kastriotit, në vitin 1944 patriotët shqiptar në Kosovë, i thane jo tradhtisë serbo-komuniste dhe me luftëtarët e lirisë vendosen t’i mbrojnë trojet e atdheut. Në betejat epike kundër sllavo-komunistëve u ngrit djalëria shqiptare në Drenicë e udhëhequr nga Shaban Polluzha, në Ana-Morave nga Mulla Idrizi dhe Kosovën Jugore (në Ferizaj) nga Hysen Terpëza, Riza Goga, e prijës të tjerë. Po ashtu heroikisht luftuan kundër sllavo-komunistëve edhe grupet balliste të udhëhequra nga Xhemë Gostivari, dhe Mufailat kreshnikë në regjionin e Gostivarit, Kërgoves, Dibërës dhe Tetovës.

Pavarësisht rrethanave shumë të vështira të shekullit njëzet, lavdia e “28 Nëntorit” arriti të futet thellë në mendjen, dijen dhe ndërdijen e popullit tonë. Edhe pse dhuna dhe presioni i pushtueseve gjate historisë ishte shumë i vrazhdë, shqiptarët jashtë kufijve shtetëror çdo vit me krenari e festonin Ditëlindjen e Flamurit Kombëtar. Veçanarisht i rëndësishme është kremtimi i përgjakshëm i “Nëntorit të viti 1968” në Kosovë dhe viset tjera shqiptare i udhëhequr nga Metush Krasniqi e Adem Demaçi. Demonstratat e përgjakshme shqiptare kundër diktaturës serbo-komuniste të cilat ishin më të fortat në bllokun socialist pas Pranverës së Pragës i dhanë një shtytje përpara avancimit të faktorit shqiptar në strukturën konstituive të Federatës shumëkombëshe jugosllave të miratuar me Kushtetutën e vitit 1974.

Rezultatet e “Nëntorit të vitit 1968” do të kenë një shtrirje shumëdimensionale, duke përfshirë çdo sferë të shoqërisë në shumicën e trevave shqiptare. Një ndër sukseset epokale të shqiptarëve në trojet e Dardanisë antike ishte themelimi i Universitetit të Kosovës më 1970, Akadamisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës më 1975 dhe shumë Instituteve tjera shkencore, kulturore dhe shëndetësore. Universiteti i Kosovës, që unë do ta quaj “Shkolla e Prishtinës” luajti rolin kryesor në krijimin një forcë të pamposhtur intelektuale, kuadrove dhe eksperteve të cilët do ta orientojë me sukses arsimin, kulturën, artin, shkencën, politikën, ekonominë dhe shëndetësinë në tërë hapësirën shqiptare të ish Jugosllavisë. Shkolla

e Prishtinës luajti rolin vendimtar në krijimin e vetëdijes kombëtare shqiptare mbi bazën e Rindjes Kombëtare dhe principet e Doktrinės së Gj. Kastritotit në këtë anë të Drintit.

Në dekadën e fundit të shekullit 20, luftëtarët e lirisë, të edukuar nga Shkolla e Prishtinës ishin ndër të parët që i thanë Jo- armatës jugosllave dhe u rreshtuan në radhët e çlirimtarëve kroat dhe boshnjak duke luftuar kundër pushtuesit serb. Kur në Kosove erdhi ora e lirisë, rinia patriote si Agim Ramadani, Xheve e Fehmi Lladrovci, Bekim Berisha e shumë e shumë të tjerë me fluturim u nisën drejt tokës së lashtë të Dardanisë duke thyer kufirin famëqek ndërrshqiptar për t’u vënë në altarin e lirisë së bashku me Adem e Hamzë Jasharin. Dita e Flamurit, “28 Nëntori” u bë motivuese për luftëtarët e UÇK-së të cilët u ngritën në këmbë për t’i çliruar trojet shqiptare nga pushtuesit sllavë. Komandanti legjendar Adem Jashari ndihej i nderuar që kishte lindur në “Ditën e Flamurit”. Festa e Flamurit- “28 Nëntori i Kastriotit” i dha forcë dhe zemër çdo herë heronjve tanë. Është i rëndësishëm veçanërisht 28 Nëntori i vitit 1997 kur luftëtarët e lirisë me emblemë e UÇK-së në ballë i thanë Jo-ilegalitetit dhe me pushkë në dorë në Drenicën kreshnike dhanë kushtrimin e lirisë.

Populli ynë dhe sidomos diaspora shqiptare duke ndjekur shembullin e Kastriotit dhe Rilindësve tanë të mëdhenj ndanë djersën e ballit dhe grumbulluan shuma të mëdha monetare dhe mjete materiale për ta mbështetur luftën për çlirimin e Dardanisë dhe viseve tjera arbërore. Luftëtarët e lirisë ashtu siç këshillonte Kastrioti me ndihmën e aleateve perëndimore dhe sidomos SHBA-së arritën që më 10 Qershor 1999 ta çlirojnë Kosovën dhe në vitin 2001 ta konfirmojnë faktorin shqiptar në Maqedoni dhe Luginën e Moravës. Fatkeqësisht, edhe shumë treva shqiptare ende janë të pushtuara dhe “28 Nëntorin” historik edhe sot e festojnë me manifestime të përgjakshme.

Festa e “28 Nëntorit- Dita e Flamurit” është faktor kryesor i krenarisë kombëtare, e cila u mundësoi emigrantëve shqiptarë t’u rezistojnë dallgëve të asimilimit në kohëra dhe vende të ndryshme, siç janë arbëreshët në Itali, shqiptarët e emigruar në Rumania, Bullgari, Ukrainë, Greqi, Turqi, vendet perëndimore si në Itali, Zvicër, Gjermani, Angli, SHBA, dhe vendet e tjera. Arbëreshët e Italisë edhe pas 550 vjetësh e mbajnë të gjallë në kujtesën e tyre figurën madhore të Kastriotit. Festa e Flamurit Kombëtar për jetë e mot kremtohet me krenari nga shqiptarët kudo që ata punojnë dhe jetojnë në shenjë respekti për gjakun e derdhur dhe sakrificat mbinjerëzore të popullit tonë ndër shekuj.

“28 Nëntorit” i Gjergj Kastriotit si çdo herë edhe në vjeshtën e vitit 2019 u shëndrrua në faktor të unitetit ndërmjet shqiptarëve kudo që jetojnë dhe punojnë për t’u dalë në ndihmë vëllezërve të goditur nga katastrofa e tërmetit në Durrës dhe rrethinë. Shpirti solidar i popullit u vërtetua edhe këtë herë sidomos nga kosovarët të cilët ishin të parët që marshuan me ndihmë të llojlloshme drejtë Durrësit për t’u ndihmuar dhe lehtësuar dhimbjen vëllezërve tanë në ato ditë të vështira. Ashtu sikurse në kohën e Kastriotit, populli shqiptar anë e kënd botës hapi zemrat, hapi dyert për t’i strehuar të goditurit dhe hapi kuletat (dhe llogaritë bankare) për të mbledhur mjete monetare për ndërtimin dhe rindërtimin e shtëpive të rrënuara dhe dëmtuara. Yjet e kulturës si Rita Ora, Bebe Rexha, Dua Lipa, Emine Çunmulaj, e shumë e shumë të tjerë ishin të parët të cilat dolën publikisht duke ofruar ndihma të konsiderueshme. Qëllimi i tyre ishte që dëmet e shkaktuara të riparohen sa më shpejt dhe familjeve të goditura nga kjo fatkeqësi natyrore t’u ndërtohen shtëpitë dhe banesat e nevojshme dhe ata të kthehen në jetën normale.

Prandaj mund të thuhet lirisht së vështirë është të gjendet në ndonjë vend tjetër një festë aq e lavdishme siç është “28 Nëntori” i Gjergj Kastriotit. Në këtë ditë të gjithë pjesëtarët e kombit tonë anë e kënde botës bashkohen për të festuar një kremte sa të lashtë aq edhe madhështore. Kjo ditë pas pesë shekujsh është materializuar me sukses gjatë historisë sonë. Sukseset e “28 Nëntorit” kanë vënë vulë të pashlyeshme në historinë e popullit tonë në tërë hapësirën e Gadishullit Ilirik dhe gjithkund ku jetonte e veprojnë shqiptarët. Andaj mund të thuhet lirish se Gjergj Kastrioti është bërë **“Ikonë e lirisë së popullit shqiptar!**

(vijon në numrin e ardhshëm)

Ndahet nga jeta
Hekuran Vladi - Lura

homazh

Djali i Lurës, një profesionist me integritet

Më 18 prill 2020 u nda nga jeta Hekuran Vladi - Lura. Ai vuante nga një sëmundje e rëndë. Ai ishte Doktor i Shkencave Ekonomike në Fushën e Kriminalistikës.

Hekuran Vladi - Lura u lind në Lurë më 22 qershor 1973. Arsimin 8-vjeçar e përfundoi në Lurë, më vonë përfundon shkollën e mesme pedagogjike Peshkopi dhe pas përfundimit të saj punon si arsimtar në fshatin e lindjes në Lurë.

Vazhdoi studimet në Fakultetin Ekonomik “Dega Financë”, ku u cilësua në tre nivelet e arsimit si student shembullor, përfunduar me “Medalje Ari”.

Pas përfundimit të Fakultetit ushtroi profesionin e tij në radhët e Forcave të Armatosura në Degën e Financës.

Me vullnetin e tij dhe prirjet intelektuale u trajnuar brenda dhe jashtë vendit si financier ne drejtimin “Krimi i Organizuar dhe ai Ekonomik”.

Hekurani ka përfaqësuar Shtetin Shqiptar në ekipe të niveleve të larta parlamentare me objekt “Legjislacionin ndër Ballkanik dhe Evropian”, ku ka spikatur në thellësinë e mendimit shkencor në zgjidhjen e problemeve të kohës..

-I trajnuar në fushën e Sigurisë Kombëtare duke përfunduar “Kolegjin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes”, duke dhënë Kontribute të shquara intelektuale.



Gjithashtu Hekurani ka kryer detyra të rëndësishme Shtetërore si: Këshilltar i Ministrisë të Financave, Drejtor i Bankës Botërore për Zhvillim, Drejtor i Agjencisë së Sekuestros.

Hekurani Vladi - Lura ka qenë autor dhe bashkëpunëtor i disa studimeve tekniko - shkencore e profesionale. Bashkëpunëtor dhe analist i paseshtur në studiot e të gjitha televizioneve Shqiptare. Objektiv,

dashamirës, kritik dhe i ashpër për atë që ai shkencërisht e argumentonte.

Së fundi, Hekurani pati në dorë një dokument tepër shkencor “Për formën dhe mënyrën e organizimit dhe menaxhimit të krizave (luftarake), të luftës dhe korrupsionit”, e cila do të jetë së shpejti në proces botimi.

Hekurani Vladi - Lura u nda nga jeta duke lënë mbresa shumë të mira e interesante, jo vetëm te familja dhe të afërmit, por edhe te shokët e shoqet e panumërta dhe audiencën e pafundme që krijoi përmes mjeteve bashkëkohore të komunikimit.

Hekurani u nda fizikisht nga bashkëshortja Elisabeta, vajza e tij Hiluria, emër simbol i shpirtit dhe krenarisë së tij, si djalë, besnik e shpirt “ILIR”, siç e thoshte shpesh, një nga themeluesit kryesorë të “Unionit Lura”.

Hekurani ndahet fizikisht nga prindërit në moshë Daliu dhe Liria (me shumë brenga në jetë), vëllezërit dhe motrat e talentuar sa vetë ai, nga kushërinjtë e tij, miqtë dhe shokët.

Ai ndahet nga legjenda aktuale lurjane gjyshi i tij 102-vjeçar Demir Vladi, të cilit i referohej thajse në çdo bisedë.

Ti djalos i mrekullueshëm i Lurës dhe shumë më gjerë do jesh mungesë serioze dhe kujtesë e dhimbshme!

Lamtumirë Hekuran Vladi-Lura!
U prehsh në paqe!

A janë të pastra paratë e shqiptarëve?!

Nga HEKURAN VLADI - Lura

1. MORRAT E KOHËS SË TALLONIT.

Në fund të viteve ‘90, kohë që përveç të tjerash, shpalosi krizën ekonomike të akumuluar në shumë vite, ndodhi edhe një “shaka” e pistë në treg.

Sapuni, që normal merrej me tallonë e që nuk mjaftonte kurrë, doli me defekt.

Në vend që të ndihmonte për zhdukjen e morrave, ndihmonte në shtimin e tyre.

Se nga vinte kjo, mund ta shpjegojë ndonjë kimist, unë veç di se është e vërtetë.

Do t’jua them më vonë pse e fillova shkrimin me morra.

2. ÇFARË ËSHTË PASTRIMI I PARAVE?

Përkufizimi më përfshirës për pastrimin e parave është ai i fenomenit të kryerjes së një, ose shumë transaksioneve të aseteve (para, etj), në mënyrë që të ardhurat nga punë të paligjshme të duken si të ardhura nga punë të ligjshme.

Theksoj “të duken”, pasi diçka që bëhet, nuk mund të zhbëhet dhe përfitimet e paligjshme mbeten të tilla përgjithmonë.

Pra, termi “pastrim parash” është një togfjalësh, ku fjala “pastrim” nuk është në kuptimin e parë të saj, por në kuptimin “maskoj, fsheh të pistën”.

3. PASTRIMI I PARAVE NË SHQIPËRI.

Pastrimi i parave është një biznes që ka filluar vitet e fundit edhe në Shqipëri, më saktë 10-15 vitet e fundit.

Kjo, pasi përveç se të ardhurat e paligjshme vinin gjithmonë e në rritje, nuk ndjehej aspak domosdoshmëria, që këto të dukeshin të ligjshme.

Me antarësimin e vendit në organizata ndërkombëtare, ratifikimin e shumë konventave të rëndësishme, por sidomos fillimi i asocim-stabilizimit me BE, edhe Shqipëria filloi të perceptohej si vend me risk për paratë e paligjshme, kësaj filloi edhe pastrimi i parave.

Në fjalë të tjera, duke përsëritur veten, personat me burime të paligjshme pasurore filluan të bëjnë transaksione shtesë, në mënyrë që të pastronin ato.

Me shtimin e burimeve të paligjshmërisë në fitimin e parave, është zgjeruar edhe biznesi i pastrimit të parave.

Vlerësohet që sasia e parave kriminale në vend është rreth 25% e GDP e rrjedhimisht edhe turnover i biznesit të pastrimit të parave është pak më i vogël se kjo shifër, pra rreth 2.5 miliardë euro.

4. KU PASTROHET PARA?

4.1. Tregu i ndërtimit dhe ai i pasurive të patundshme.

Një nga format klasike të pastrimit të parave. Ajo që po vërehet me shqetësim aktualisht në Shqipëri është rritja e ndërtimeve në kushtet e uljes së kërkesës për apartamente.

Me mbajtjen lart të çmimeve të shitjes nga këta ndërtues, rregullat e tregut dalin jashtë përdorimit dhe lënia bosh e apartamenteve shpjegon “sin-qerisht” se aty po pastrohet para.

4.2. Bankat e nivelit II

Tregu i parave në vend është shumë dinamik. Me një ekonomi informale mbi 50% dhe përdorim të parave cash më të lartit në rajon, në pamje të parë duket sikur nuk ka shumë punë për bankat.

Në fakt ka punë për ta dhe disa shit-blerje të fundit, të kryera në gjysmë errësirë, i kanë shtuar dyshimet se disa prej bankave i kanë shtuar cv së tyre pastrimin e parave.

4.3. Shoqëritë financiare jo - bankare.

Shoqëritë e sigurimeve e kanë filluar pak më herët pastrimin e parave. Tashmë disa prej tyre e ofrojnë për të tretët.

Shoqëritë e kursim - kreditit janë në rritjen e biznesit të tyre dhe çuditërisht janë përfshirë edhe në pastrimin e parave.

4.4. Bastet, llotaritë dhe kazinotë

Për momentin ka një moratorium për lojrat e fatit. Megjithatë ligji ka një klauzolë për lejimin e kazinove në hotelet me 5 yje e lart.

4.5. Spitalet private, shkollat private, futbolli. Nuk zënë ndonjë peshë të madhe në totalin e vendit, por kanë pjesën e vet. Transaksioni më i fundit ishte blerja në Tiranë e disa magazinave të viteve ‘70, të adaptuara keq si spital.

4.6. Shpenzimet për bizhuteri, piktura dhe



gjëra të tjera të luksit.

Bëhet rëndom kudo në botë dhe është një nga format e kamufluara të pastrimit të parave.

Në Shqipëri nuk ka ndonjë shifër se sa ndodh, përveç tregut relativisht fitimprurës të bizhuterive dhe materialeve të çmuara, i cili nga ana e vet është një tregues i tërthortë i asaj për të cilën po flasim.

4.7. Mallrat e konsumit luksoz dhe jeta luksoze në përgjithësi.

Shpenzimet e pajustificuara të jetesës janë karakteristike e disa grupeve shoqërore në Shqipëri, ku mund të listohen elementë të krimit të organizuar, politikanë dhe familjarë të tyre, biznesmenë, etj.

Format më të dukshme të shpenzimeve të tyre të pajustificuara janë makinat e shtrenjta, restorantet luksoze që frekuentojnë, etj.

5. KUSH PASTRON PARA NË SHQIPËRI?

5.1. Trafikantët lokalë të drogës dhe qenieve njerëzore.

Shqipëria është tashmë furnitori kryesor i Europës me hashash të prodhuar në vend. Ky prodhim kontrollohet bashkë me eksportin nga banda kriminale me aktivitet brenda vendit.

Përveç hashashit, Shqipëria po zë një vend të rëndësishëm edhe në trafikun e heroinës dhe atë të kokainës.

Trafiku i qenieve njerëzore, kryesisht gra dhe

fëmijë, jashtë dhe brenda vendit, po njih sërish rritje vitet e fundit. Totali i të ardhurave nga këto biznese kriminale vlerësohet diku tek 1 miliardë euro/vitin e fundit.

5.2. Bandat kriminale shqiptare në Europë, UK dhe Amerikë.

Raportet e fundit nga këto vende tregojnë se shqiptarët janë ndërkohë të dalluar në trafikun e drogës dhe qenieve njerëzore.

Pamundësia e shqiptarëve për t’u integruar në punë të ligjshme ka bërë që në vite, një pjesë e tyre të bëjnë karrierë në fushën e krimit të organizuar.

Përsa i përket parave që fitojnë, mbeten “patriotë”, pasi shumicën e tyre i dërgojnë në Shqipëri e kjo sigurisht jo për patriotizëm, por për lehtësitë në pastrimin e tyre.

Vlerësohet se totali i të ardhurave kriminale prej tyre në vend të jetë rreth 1 miliardë euro/ vitin e fundit.

5.3. Politikanë, funksionarë të lartë, gjykatës, prokurorë.

Ryshfetet, shitja e të drejtave publike, shitja e vendimeve të gjyqit, janë disa nga shfaqjet korruptive që gjenerojnë para’ dhe rrjedhimisht shtojnë sasinë e parave për t’u pastruar në vend.

Në raportin më të fundit, KLSH vlerëson që dëmi ekonomik vjetor i qeverisë ishte 1 miliardë euro.

A janë të pastra paratë e shqiptarëve?!

■ **Është për të ardhur keq, që kapacitetet intelektuale të angazhuara dhe të specializuara nuk kanë krijuar traditën institucionale përkatëse, në mënyrë që të jenë të afta të prodhojnë ligje e rregulla adekuate. Emërimet nepotike dhe politike janë karakteristika kryesore e personelit edhe për këtë kategori.**

(vijen nga faqja 30)

Gjithsesi, shumica e parasë neto për t'u pastruar nga kjo kategori vlerësohet rreth 300 milion euro/vitin e fundit. Një specifikë e tyre është edhe që janë më pak "patriotë" se antarët e bandave, pasi kanë filluar të depozitojnë para nëpër llogari off shore në parajsë fiskale jashtë vendit.

5.4. Biznesmenë

Kontrabanda me mallrat e akcizës dhe evazioni fiskal janë 2 fusha që prodhojnë shumë para të jashtëligjshme dhe kjo për një grup shumë të vogël biznesmenësh.

Megjithatë, në saj të sistemit tejet të korruptuar fiskal, këta biznesmenë raportojnë çfarë duan në bilancet e tyre, kështu që e mbyllin brenda për brenda pastrimin e produktit kriminal të tyre.

Aq shumë e influencojnë sistemin fiskal kjo kategori biznesmenësh, sa që ndryshimet ligjore dhe rregullative dhe gjithashtu emërimet e larta bëhen vetëm me kërkesën, apo miratimin e tyre.

Së fundmi ekspertët po kristalizojnë mendimin e tyre edhe për përdorimin e kontratave me qeverinë, kryesisht ato PPP, për qëllim pastrimi parash.

Vlera e parasë që ata nxjerrin nga sistemi dhe e pastrojnë sërisht është rreth 400 milion euro/vitin e fundit.

6. LUFTA KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE NË SHQIPËRI.

6.1. Kapaciteti ligjor dhe rregullativ për luftën kundër pastrimit të parasë.

Shqipëria ka disa ligje dhe akte nënligjore, që lidhen me këtë luftë. Janë kryesisht të blera nga ekspertiza ndërkombëtare e ofruar bujarisht nga BE, por shpesh edhe nga SHBA.

Kjo ekspertizë ka ndërtuar një kornizë aspak të përshtatshme ligjore për t'u zbatuar.

Në shumicën e rasteve ekspertët kanë dhënë modele bazuar në eksperiencën e vendeve të tyre, e cila vlen pak ose aspak në rastin tonë, ndërsa në pakicën e tyre, ata kanë qenë ekspertë të midhjes dhe peshkut, jo ekspertë të luftës kundër pastrimit të parave.

Nga ana tjetër, është për të ardhur keq, që kapacitetet intelektuale të angazhuara dhe të specializuara nuk kanë krijuar traditën institucionale përkatëse, në mënyrë që të jenë të afta të prodhojnë ligje e rregulla adekuate.

Emërimet nepotike dhe politike janë karakteristika kryesore e personelit edhe për këtë kategori.

6.2. Kapaciteti i institucioneve të zbatimit të ligjit.

Teknikisht janë 5, por produkti që ofrojnë është jashtëzakonisht i dobët.

6.2.1. Banka e Shqipërisë. Ka filluar t'i bjerë larg e larg çështjes së pastrimit të parasë, por konkretisht nuk kemi asnjë konstatim të tyre në bankat e nivelit II, apo në institucionet financiare jo - bankare, të cilat i ka në objekt kontrolli.

Padyshim që nuk është vetëm çështje paaftësie, por shumë më tepër.

Përkundrazi, duket se BSH ka shumë për të bërë transparencë, pasi deri më tani nuk i ka ofruar as prokurorit, as publikut një akt auditimi serioz për skandalin e ish - Guvernatorit, që u kap duke ndërruar karta me kartëmonedha.

6.2.2. Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare. Shpresoj që të paktën ta dinë se ligji i tyre i ngarkon edhe me çështje të luftës kundër pastrimit të parave.

Në raportet e tyre, kjo gjë nuk duket.

6.2.3. Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave. Varet nga Ministri i Financave, pra nga qeveria, e cila është objekt i punës së saj dhe konflikti i interesit nuk është thjesht në dukje, por real.

Vartësia e kësaj drejtorie duhet të ndryshojë dhe të jetë tek BSH, ose Prokurori i Përgjithshëm.

Është një institucion që përdoret si çomangë nga pushteti për të vendosur gjoka të mëdha dhe nga drejtori i radhës për gjoka të vogla.

Përdoret gjithashtu për realizimin e planit të sekuestimeve, që normalisht iu kthehen të zotëve dhe për pak sa harrova, përdoret edhe për pritje - përcjelljen e ekspertëve të huaj.

Në raportin vjetor të aktivitetit gënjën çdo vit.

6.2.4. Drejtoria e Luftës Kundër Pastrimit të Parave në Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

Është një shaka institucionale. Punonjësve të kësaj drejtorie, në përgjithësi, iu vjen turp të tregojnë ku punojnë.

Një strukturë e ngritur prej më shumë se 10 vitesh dhe që nuk ka një manual sado të dobët të punës, apo një metodologji sado të shkurtër.

Për të mos përmendë çështje të ekspertizës së stafit, tek e cila lëvizjet e shpeshta të organikës e kanë këtë sektor si xhep apandesi.

6.2.5. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

E kam thënë dhe vazhdoj ta them, që pa përfshirjen e kontrollit fiskal, asgjë nuk ka prej luftës kundër pastrimit të parave dhe parandalimit të krimit të organizuar në përgjithësi.

Kjo është një temë shumë e larmishme, të cilën e trajtoj dhe në librin tim të fundit që pret botimin, por duhet theksuar patjetër, që roli i fiskut në kontrollin e parasë është i pazvëndësueshëm.

Ajo, që ndodh në të vërtetë, është hë për hë veç përmendja e pastrimit të parave në ndryshimet e ligjit të tatimit mbi të ardhurat.

6.3. Vullneti politik për luftën kundër pastrimit të parave.

Lufta kundër pastrimit të parave është një tabu për shumicën e qeverive në botë.

Ku më shumë, siç është Shqipëria, e ku më pak ligjvënësit dhe ligjzbatuesit janë edhe ata objekt i kësaj lufte, ndaj realisht është një nga punët që lënë më shumë pas dore.

Gjithsesi, në Shqipëri, vullneti i shprehur politik edhe i qeverisë, edhe i opozitës është në mbështetje të luftës kundër pastrimit të parave.

7. ÇFARË ËSHTË PËR EKONOMINË PASTRIMI I PARAVE DHE A JANË TË PASTRA PARATË E SHQIPTARËVE?

MONEYVAL, një trupë monitoruese e ngritur dhe që funksionon brenda KE, e specializuar për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, e ka Shqipërinë objekt të punës së vet.

Në raportin e tyre të fundit e klasifikojnë Shqipërinë në listën e zezë, teknikisht pra të vendeve që duhen mbajtur nën vëzhgim të rreptë.

Ata përmendin në raport të gjitha kërkesat e plotësuara dhe të paplotësuara nga Shqipëria.

Mua nuk më thotë ndonjë gjë të madhe ai raport, pasi situata e vërtetë është shumë e keqe, krahasuar me atë që përshkruan raportin.

Jam në gjendje të kuptoj qartë se ekspertët kanë qene nga ata të midhjes dhe të peshkut, megjithatë nuk kanë arritur të japin një notë kaluese.

Ky raport, pra, megjithëse i dobët, dëmin mund ta bëjë të madh në mars kur të ri - diskutohet çështja e fillimit të negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Siç e pamë më lart, ja pra një nga të këqijat e mëdha të pastrimit të parave.

Shkatërrimi i konkurrencës dhe rrjedhimisht bllokimi i investimeve serioze të drejtpërdrejta të vendit dhe të huaja.

Korruptimi i sistemit dhe shkatërrimi i kuadrit ligjor e rregullativ në favor të një grushti njerëzish.

Shkatërrimi i tregut të lirë, ku kërkesë - oferta nuk ka më kuptim dhe çmimet kontrollohen prej këtij grupi njerëzish.

Rritja e importeve, d.m.th thellim i deficitit tregtar, pasi kriminelët janë të interesuar në zbrazjen e magazinave nëpër botë në vend të investimeve për rritjen e prodhimit vendas.

Rritja e papunësisë dhe rrjedhimisht ulja e nivelit të jetesës, që shoqërohet me diferencimin e madh të shtresave shoqërore.

Rritja e varfërisë, kriminalitetit, etj, etj.

Paratë e pista, pra, janë morri i ekonomisë.

Problemi është se sapuni duket sikur po i shton morrat dhe kjo është qeveria e korruptuar, e cila po akuzohet, jo vetëm për kaq, por për bashkëpunim.

Unë nuk hyj tek ai grup njerëzish, që e fillojnë ditën me dyshime.

Aq më tepër, profesioni që kam dhe ekspertiza që ofroj më diktojnë, që të jap këshilla në vend të akuzave.

Transparencë e ka emrin këshilla ime e parë për qeverinë. Le t'i pranojmë të vërtetat, pasi vetëm ashtu mund të pretendojmë ndonjë përmirësim.

Në vitin '97 e pyetën njëfarë kryetar shteti për punën e ca kompanive rentiere, që po plaçkisnin popullin haptazi fare.

Përgjigja e tij ishte, sipas meje, më kriminalja e mundshme.

Ai tha: "Paret e shqiptarëve janë më të pastrat në botë!"

Sikur gjysmën e të vërtetës të kishte thënë atë ditë ai burrë, lëre më sikur t'i ofronte publikut transparencën e nevojshme, historia e Shqipërisë do të ishte ndryshe.

Kriminalizimi i ekonomisë, që po ndodh sot, kërkon transparencë dhe veprim, përndryshe '97 do kujtohet për mirë, krahasimisht me simotrën që babëzia e krimit po përgadit.

(Marrë nga faqja në Facebook e autorit)

Shuhet ish mësuesi, specialisti dhe drejtuesi i devotshëm dibran

Lulzim Methasani, një ikje e pamerituar



Një zile telefoni në një orë të papërshtatshme më bëri të ndihem ndryshe dhe të përjetoj dhimbjen që secili nga ne merr në raste të tilla. Njëri nga djemtë më të mirë të fisit dhe fshatit Sohodoll, Lulzim Methasani, kish ndërruar jetë. Një atak kardiak, ndaloi së rrahuri jo vetëm zemrën e tij, por edhe frenoi përfundimisht në moshën 66 vjeçare, një jetë të mbushur me shumë punë e përkushtim, duke lënë gjurmë kudo ku shkeli.

Jeta e tij kaloi përmes vuajtjesh, sepse babai Rizai e la jetim shumë të vogël dhe nënës së tij Razie, bijë e familjes Cibaku, iu desh të bëjë nënën dhe babain, për ta rritur dhe shkolluar ashtu si duhej djalin e saj. Lulzim Methasani që pas mbarimit të shkollës së lartë në Korçë në vitin 1978, nisi punën, madje jashtë fshatit të tij, pikërisht si agronom në zonën e Slllovës. Edhe pse i ri, falë pjekurisë, përkushtimit dhe punës së ndershme, bëri emrin e mirë dhe katër vitet e punës atje, stampuan një histori suksese duke u respektuar në çdo fshat e shtëpi.

Vlera të tilla e afirmojnë shpejt dhe Luli emërohet mësues specialist në shkollën e mesme "Nazmi Rushiti" në Peshkopi, ku për më shumë se një dekadë tregoi se vlente si një edukator dinjitoz që rrënjosi tek nxënësit dashurinë për lëndën që jepte.

Vlerat e tij profesionale dhe njerëzore e shtuan shumë popullaritetin e emrit që bëri, duke u bërë mësuesi prind, që vendosi marrëdhënie brilante me koleget dhe nxënësit, marrëdhënie që ruheshin edhe pas mbarimit të shkollës.

Pas viteve '90-të, Luli punoi në shumë sektorë të ndryshëm të bujqësisë, pyjeve dhe çështjeve

sociale në qytetin e Peshkopisë, madje edhe si drejtues e titullar. Në çdo kohë ai u tregua njerëzor dhe korrekt, duke fituar qytetarinë e duhur dhe respektin e njerëzve.

Lulzimi është babai i tre djemve që kanë vlerat e tyre në shoqërinë e sotme, madje njëri prej tyre Dr. Rizai, është mjek në spitalin e Peshkopisë, por edhe gjysh i tre nipërve. Me ikjen e tij të pamerituar, jo vetëm bashkëshortja Zadia dhe djemtë humbën dhe u pikëlluan për njeriun më të shtrenjtë, por edhe fisi Methasani për djalin e tij, Sohodolli për njeriun intelektual dhe Dibra për njërin prej figurave më të shquara dhe të devotshme të punës dhe jetës, për një vlerë qytetarie që gëzonte respektin e gjithë trevës.

Ka mjaftuar një postim që bëra në rrjetin social facebook, post ndarjes së tij nga jeta dhe menjëherë reagimi qytetar ka qenë tejet i madh, ashtu si dhimbja në adresë të tij.

Afro 700 komente, fjalë zemre dhe ndjenja të fuqishme në adresë të tij, veçmas ata që kishin punuar me këtë koleg e shok të mirë. Kjo tregon se njerëz të tillë si Luli vërtet ndahen nga jeta, por kurrsesi nga kujtesa dhe vlerësimi tek të tjerët, njerëzit që e njohën dhe kurrë s'e harrojnë njeriun e duhur, mikun e dashur, shokun e singqertë dhe hokatar dhe intelektualin e burrin me vlera.

Lamtumirë kushëri Lulëzim, kurrë s'do të doja të shkruaja këto radhë për mungesën tënde, por e tillë erdhi jeta, duke na pikëlluar, por duke na bërë edhe krenarë për emrin e mirë që gdhende në më shumë se katër dekada.

Defrim Methasani



HAPET SË SHPEJTI



DI ÇFARË ZGJEDH!

